Deloitte.

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri

Raporti për vitin 2013 dhe 2014

Dhjetor 2015



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 4

1. Hyrje 6

2. Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse dhe sektorit të hidro-energjisë në Shqipëri 10

2.1 Fakte kryesore 11

2.2 Sektori i naftës dhe gazit 20

2.3 Sektori minerar dhe guror 40

2.4 Sektori i hidro-energjisë 50

3. Pamje e përgjithshme e flukseve të raportuara dhe e shoqërive raportuese 73

4. Qasja, metodologjia dhe puna e kryer 79

5. Përmbledhja e rakordimit 85

6. Rezultatet e rakordimit 87

7. Komente dhe rekomandime 102

Fjalor dhe shkurtime 113

Shtojca 1.1: Rakordimi i detajuar për sektorin e naftës dhe gazit në vitin 2013
Shtojca 1.2: Rakordimi i detajuar për sektorin e naftës dhe gazit në vitin 2014
Shtojca 2.1: Rakordimi i detajuar për sektorin minerar në vitin 2013
Shtojca 2.1: Rakordimi i detajuar për sektorin minerar në vitin 2014
Shtojca 3.1: Rakordimi i detajuar për sektorin e hidro-energjisë në vitin 2013
Shtojca 3.2: Rakordimi i detajuar për sektorin e hidro-energjisë në vitin 2014
Shtojca 4: Lista e marrëveshjeve Hidrokarbure administruar nga Albpetrol në 31 Dhjetor 2014
Shtojca 5: Lista e marrëveshjeve Hidrokarbure administruar nga AKBN në 31 Dhjetor 2014
Shtojca 6: Nafta e shitur nga Albpetrol në vitin 2013 dhe 2014
Shtojca 7: Regjistri i të licensuarve në sektorin minerar në Nëntor 2015
Shtojca 8: Licensat e dhëna në sektorin minerar në vitin 2013
Shtojca 9: Licensat e dhëna në sektorin minerar në vitin 2014
Shtojca 10: Regjistri i kocensioneve në sektorin e hidro-energjisë në Nëntor 2015
Shtojca 11: Analiza e përmbajtjes së raportit sipas kërkesave të standardit EITI

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti
Gjeologji-
Miniera
Tirana, Albania

Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

VAT (NUIS) No: L41709002H

Grupi Ndërinstitucional i Punës
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Blv. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Raport mbi gjetjet faktike – mbledhja dhe rakordimi i flukseve të parasë

Ne u angazhuam për të kryer procedurat e rëna dakort me ju në lidhje me rakordimin e flukseve të parasë nga aktivitetet e sektorit të naftës dhe gazit, sektorit minerar dhe sektorit të hidro-energjisë si dhe përpilimin informacionit kontekstual si pjesë e zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose "EITI") në Shqipëri për vitin 2013 dhe 2014.

Ne e kryem punën tonë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Shërbimet e Lidhura ("SNSL" ose "ISRS") 4400 "Angazhime sipas procedurave të rëna dakord në lidhje me Informacionin Financiar", publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve ("FNK" ose "IFAC").

Procedurat tona janë listuar në kapitullin 4 të këtij raporti. Gjetjet tona janë paraqitur në kapitullin 6 të këtij raporti dhe në shtojcat e tij siç tregohet në kapitullin 6.

Për shkak se procedurat e rëna dakord nuk përbëjnë auditim apo rishikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit, ne nuk shprehim asnjë siguri mbi informacionin financiar të paraqitur në këtë raport përfshirë pagesat e raportuara nga shoqëritë e licensuara apo institucionet qeveritare. Informacioni i paraqitur në raportin tonë, ose informacioni i dhënë nga shoqëritë e licensuara apo institucionet qeveritare, nuk ka qenë objekt i procedurave të kontrollit apo verifikimit, përveçse kur në raport shprehet ndryshe. Nëse do kishim kryer procedura shtesë, auditim apo rishikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit, mund të ishin identifikuar apo raportuar çështje të tjera.

Raporti EITI për vitin 2013 dhe 2014 bashkëngjitur përbëhet nga shtatë kapituj që, ndër të tjera, paraqesin informacion mbi rregullimin dhe veprimtarinë e industrisë, procedurat për përpilimin dhe procesin e rakordimit dhe gjetjet e lidhura me të, si dhe mësimet e nxjerra nga procesi në këto dy vite dhe përmbledhjen e rekomandimeve.

Informacioni i paraqitur në kapitullin 1 dhe kapitullin 2 dhe informacioni tjetër i paraqitur në raport përtej pagesave pjesë e rakordimit dhe procedurave tona, është mbledhur kryesisht nga EITI Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në Shqipëri, shoqërinë Albpetrol, dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Ne nuk kemi kryer procedura për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në këto kapituj.

Qëllimi i këtij raporti është të përmirësojë transparencën në industrinë e naftës dhe gazit, atë minerare dhe të hidro-energjisë. Procedurat tona nuk janë hartuar për të identifikuar mashtrime ose gabime të bëra nga shoqëritë e licensuara dhe institucionet qeveritare.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

15 dhjetor 2015
Tirana, Albania

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Përmbledhje ekzekutive

Kjo përmbledhje paraqet faktet kryesore mbi industrinë nxjerrëse dhe sektorin e hidro-energjisë në Shqipëri dhe gjetjet nga procesi i rakordimit.

Shqipëria është një ndër 49 **vëndet anëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.**

Në zbatim të kësaj nisme **Qeveria Shqiptare publikon këtë raport informues** mbi aktivitetin e nxjerrjes së naftës, gazit dhe mineraleve, kontributin e kësaj industrie në Buxhetin e Shtetit dhe përdorimin e të ardhurave që vjel Shteti nga kjo industri me qëllim **promovimin e transparencës** për të parandaluar korrupsionin, si dhe **sensibilizimin e qytetarëve** për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore në vend.

Raporti EITI për vitet 2013 dhe 2014 jep një pamje të përgjithshme të aktiviteteve **të sektorit të naftës dhe gazit, sektorit minerar** dhe **sektorit të hidroenergjisë** dhe rakordimin e flukseve kryesore të paguara nga të licensuarit dhe të mbledhura nga agjensitë qeveritare në këta sektorë.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN dhe ERE, **prodhimi i gjeneruar** nga këta sektorë është **vlerësuar në 777 milionë USD për vitin 2013** dhe **815 milionë USD për vitin 2014**. Ndërsa kontributi i tij në Buxhetin e Shtetit ishte **3.9%** të ardhurave të regjistruara në **Buxhetin e Shtetit në vitin 2013** dhe **3.5% në vitin 2014**.

Kontributi i industrisë nxjerrëse **në punësimin total në vend** është pothuajse i papërfillshëm. AKBN raporton se shoqëritë e licensuara në sektorët e naftës, gazit dhe minerar, punësuan në total **më pak se 1%** të totalit të fuqisë punëtore të regjistruar në vend në vitin 2013 dhe 2014.

Nafta e papërpunuar përbën rreth **67%** të prodhimit të përgjithshëm të tre sektorëve në të dy vitet. Përafërsisht **87% e naftës së prodhuar** është nxjerrë nga **vendburimi i Patos-Marinzës**. Kapitulli 2 paraqet një përmbledhje të ligjeve dhe rregulloreve në të tre sektorët, regjimit fiskal, aktivitetit të kërkim-zbulimit dhe aktivitetit të prodhimit në të tre sektorët.

Grafiku 1 - Prodhimi ne milion USD - 2013



Grafiku 1 - Prodhimi ne milion USD - 2014



Përzgjedhja e shoqërive raportuese

Të gjitha shoqëritë që operonin një licensë në kërkim-zbulim për naftën, gazin e mineralet e tjera dhe një licensë prodhimi për naftën dhe gazin, u përzgjodhën të raportonin pagesat sipas Standardit EITI. Si rrjedhojë, **fluksi i parasë rakorduar për sektorin e naftës dhe gazit përfaqëson 100% të fluksit të parasë kontribuar** në total nga ky sektor për llojet e të ardhurave përfshirë në këtë rakordim.

Për shkak të numrit të madh të shoqërive prodhuese me shkallë të vogël aktiviteti, në sektorin minerar dhe të hidro-energjisë u aplikuan disa kritere mbi madhësinë e prodhimit vjetor me qëllim përzgjdhjen e prodhuesve më të mëdhenj. Përzgjedhja rezultoi me **81 shoqëri minerare për vitin 2013**, të cilat bazuar në të dhënat e AKBN, përbënin **85% të vlerës së prodhimit** dhe **99 shoqëri minerare për vitin 2014,** të cilat përbënin **87% të vlerës së prodhimit.**

Grafiku 3 - Pagesat e rakorduar *ne miliard Lek*



Burimi: Raportet EITI 2011 - 2014

Në sektorin e hidro-energjisë, MSG zgjodhi për raportim 10 prodhuesit më të mëdhenj dhe 5 investimet më të mëdha në hidrocentrale të cilat nuk kishin hyrë ende në fazën e prodhimit.

Deri në datën e këtij raporti, **pagesat u rakorduan në masën e 99%** të totalit të pagesave raportuar nga të licensuarit dhe Qeveria.

Kapitujt 5 dhe 6 paraqesin rakordimin në nivel të përmbledhur, ndërsa rakordimi i detajuar për çdo shoqëri paraqitet në shtojcat e këtij raporti. Grafiku 3 në të majtë paraqet trendin e rakordimit të pagesave nga viti 2011 deri në vitin 2014.

1. Hyrje

Ky është raporti i pestë i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri dhe mbulon vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2014.

1.1 Çfarë është EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose EITI") është një koalicion vullnetar ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, të tilla si nafta, gazi dhe minerale të tjera (shih gjithashtu: www.eiti.org). EITI ka për qëllim promovimin e transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t'i sigurojë qytetarëve një bazë për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave. Gjithashtu, pritet që transparenca të kontribuojë pozitivisht në rritjen e investimeve në këtë sektor.

Krahas përpjekjeve të tjera për të përmirësuar transparencën në administrimin e Buxhetit të Shtetit, EITI fillon një proces ku Shteti do të jap llogari para qytetarëve për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Burimet natyrore i përkasin qytetarëve të një vendi. Njerëzit duhet të kenë të drejtën për të parë se çfarë po merr Shteti nga këto burime. Megjithatë, në shumë vende ky informacion nuk është i disponueshëm për të gjithë qytetarët.

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse rregullohet nëpërmjet një standardi ndërkombëtar, "Standardi EITI" që siguron më shumë transparencë rreth administrimit të burimeve të naftës, gazit dhe mineraleve të tjera. Standardi EITI zëvendësoi rregullat e mëparshme EITI në korrik 2013. Standardi EITI u ndryshua më tej në janar 2015.



Standardi EITI është hartuar nga një koalicion ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë njëkohësisht edhe si mbikqyrës të zbatimit të tij. Ai bazohet në besimin se përdorimi i matur i burimeve natyrore sjell rritje ekonomike, zhvillimi të qëndrueshëm dhe reduktim të varfërisë në vendet e pasura me burime natyrore.

Sipas këtij standardi, shoqëritë publikojnë atë që paguajnë dhe shtetet publikojnë atë që arkëtojnë. Këto pagesa paraqiten në raportin vjetor të EITI-t, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe do të promovohet në mënyrë aktive që t'i lejojë qytetarët të kuptojnë se sa mbledh Shteti nga përdorimi i burimeve natyrore të vendit dhe të nxisë ata të kërkojnë një përdorim të drejtë të këtyre të ardhurave.

1.2 EITI në Shqipëri

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (AlbEITI, www.albeiti.org) u themelua në vitin 2009 nga Shteti shqiptar me qëllimin e promovimit të qeverisjes së mirë të burimeve natyrore nëpërmjet zbatimit të kritereve dhe parimeve ndërkombëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Shqipëria u bashkua si kandidate e EITI-t në maj 2009 dhe fitoi statusin e plotë të anëtarësisë në maj 2013. Raporte vjetore janë publikuar përkatësisht për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012. Ky raport mbulon vitet 2013 dhe 2014.

Procesi në Shqipëri mbikqyret nga Grupi Ndërinstitucional i Punës ("MSG" ose "Grupi Shqiptar i Punës"), rregulluar nga Urdhëri nr. 71 të Kryeministrit datë 21 korrik 2011. Grupi Shqiptar i Punës kryesohet nga Zv. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe përbëhet nga disa grupe interesi të EITI-t duke përfshirë Qeverinë, shoqëritë private, shoqërinë civile etj. Grupi Shqiptar i Punës është organi vendimmarrës dhe mbikqyrësi i zbatimit të EITI-t në Shqipëri. Sekretariati i EITI-t në Shqipëri ("AlbEITI") mbështetet Grupin Shqiptar të Punës në përmbushjen e detyrave të tij.

1.3 Grupi Shqiptar i Punës

Qeveria e Shqipërisë

- Z. Ilir Bejtja — Kryetari i MSG, Zv. Ministër i Energjisë dhe Industrisë
- Z. Dritan Spahiu — Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- Zj. Arjana Dyrmishi, — Ministria e Financave
- Zj. Ermonela Xhafa — Ministria e Drejtësisë
- Zj. Shilda Kamberi — Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Z. Nikoll Kaza — Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Z. Azbi Arapi — Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Organizatat e Shoqërisë Civile

- Z. Ilir Aliaj — Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve
- Zj. Anila Hajnaj — Qendra Shqiptare për Zhvillimin dhe Integrim
- Z. Sami Nezaj — Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë
- Z. Baki Bajraktari — Sindikata e Minatorëve në Bulqizë
- Zj. Madlina Puka — Qëndra për Kërkim Bashkëpunim dhe Zhvillim-CRCD

Grupet e interesit

- Z. Adriatik Golemi — Bankers Petroleum Albania Ltd
- Z. Saimir Boka — Albchrome
- Z. Perparim Alikaj — FIAA
- Z. Dritan Dervishaj — Antea Cement
- Zj. Migela Xhani — Beralb sh.a.

Anëtarët me kontribut të përhershëm

- Z. Sokol Mati — Beralb sh.a.
- Z. Mehmet Hasalami — Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- Z. Pandi Duro — Administrata Shqiptare Doganore
- Zj. Laura Cela — Bankers Petroleum Albania Ltd
- Zj. Erjola Sadushi — Enti Rregullator i Energjisë
- Zj. Raimonda Islamaj — Enti Rregullator i Energjisë
- Z. Fatbardh Ademi — TransAtlantic Albania Ltd
- Z. Anda Beluli — PETROMANAS Albania Gmbh

1.4 Raportimi vjetor

Sipas standardit EITI, të licensuarit dhe institucionet qeveritare do të raportojnë përkatësisht pagesat e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara çdo vit dhe të gjitha këto do të rakordohen nga një administrator i pavarur në kuadrin e zbatimit të vazhdueshëm të nismës EITI. Në këtë kontekst, MSG dhe AlbEITI u kërkuan palëve të mëposhtme të raportojnë të gjitha pagesat e kryera ndaj Shtetit shqiptar:

- të gjitha shoqëritë e licensuara që operojnë në kërkimin e naftës, gazit dhe mineraleve të tjera,
- të gjitha shoqëritë e licensuara në prodhimin e naftës dhe gazit, dhe
- prodhuesit më të mëdhenjë në sektorin minerar;
- prodhuesit më të mëdhenj në sektorin e hidro-energjisë;
- investitorët më të mëdhenj në hidro-energji që nuk kishin hyrë ende në fazën e prodhimit.

Gjithashtu, MSG dhe AlbEITI i kërkuan institucioneve qeveritare përgjegjëse të raportojnë të ardhura që kanë arkëtuar nga këto shoqëri.

Raportimi EITI në Shqipëri për sektorin minerar dhe sektorin e naftës rregullohet respektivisht nëpërmjet Ligjit nr. 10304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, datë 15 korrik 2010, të ndryshuar dhe Ligji nr 7746 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhimi) ", datë 28 korrik 1993, i ndryshuar. Këto ligje detyrojnë të gjitha shoqëritë e naftës dhe ato minerare të raportojnë sipas standardit EITI. Sektori i hidro-energjitikës ka pranuar vullnetarisht të raportojë sipas EITI-t.

Informacioni kontekstual rreth sektorit nxjerrës dhe sektorit të hidro-energjisë në Shqipëri është paraqitur në Kapitullin 2 të këtij raporti, sipas kërkesave të standardit të ri EITI. Për përpilimin e informacionit kontekstual, MSG dhe AlbEITI i kërkuan regullatorëve të industrisë, dhe agjentëve të qeverisjes fiskale t’i sigurojnë ALBEITI-t të dhëna makroekonomike, të dhëna mbi prodhimin, eksportet dhe të ardhurat e arkëtuara nga industria nxjerrëse.

Administratori i Pavarur

MSG caktoi Deloitte Audit Albania Sh.p.k. (“Deloitte”) administrator sipas kontratës datë 14 korrik 2015. Roli i Administratorit është:

- Të mbledhë raportimet nga shoqëritë e licensuara dhe institucionet qeveritare;
- Të përpilojë raportin dhe në masën që është e mundur të zgjidhë mospërputhjet;
- Të përgatisë dhe publikojë një raport që përfshin pagesat dhe të ardhurat e rakorduara, ndonjë mospërputhje dhe informacione të tjera të rëndësishme për të kuptuar pagesat dhe të ardhurat nga aktiviteti hidrokarbur dhe ai minerar;
- Të përpilojë informacionin kontekstual sipas kërkesës 3 të standardit EITI
- Të tjera informacione të kërkuara nga MSG; dhe
- Të japë rekomandime për të përmirësuar procesin.

1.5 Falenderime

Shprehim falenderimet tona të sinqerta për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Grupin Shqiptar të Punës dhe Sekretariatin EITI në Shqipëri, të cilët na kanë ndihmuar në marrjen në kohë të përgjigjeve nga Shteti dhe shoqëritë pjesëmarrëse.

2. Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse dhe sektorit të hidro-energjisë në Shqipëri

Informacioni i paraqitur në këtë kapitull është siguruar nga të dhëna publikuar në faqen e internetit të Enteve publike qeverisëse, shoqerive shtetërore, investitorët kryesorë që operojnë në sektorin nxjerrës dhe të hidro-energjisë. Gjithashtu, është kërkuar informacion i nevojshëm shtesë nga entet publike në përputhje me kërkesat 3 dhe 4 të standardit EITI.

Administratori i pavaruar nuk ka kryer procedura auditimi për të vërtetuar plotësinë dhe saktësinë e informacionit që paraqitet në këtë kapitull.

2.1 Faktet kryesore

2.1.1 Energjia dhe burimet në Shqipëri

Shqipëria është e pasur në burime të cilat mund të plotësojnë nevojat e brendshme për energji dhe në shumicën e viteve (deri në vitin 1989), ka qenë një eksportues neto i energjisë elektrike dhe nënprodukteve të naftës.

Shqipëria është e pasur në burime si naftë, gaz, qymyr, dru, bitum dhe ka potencial të lartë hidro-energjitik etj. të cilat kontribuojnë në mënyra të ndryshme për të plotësuar kërkesat për energji në vend.

Grafiku 4 – Kontributi i energjisë dhe burimeve në *PBB (me cmimet aktuale)*



Burimi: INSTAT- Llogarite Kombetare Vjetore (metoda e prodhimit)

Sektori i energjisë dhe burimeve në Shqipëri dominohet nga:

- ***sektori i naftës,***
- ***sektori i hidro-energjisë dhe***
- ***sektori i minierave dhe guroreve***.

Bazuar në rezultatet paraprake të publikuara nga INSTAT[1], sektori i energjisë dhe burimeve përbënte 7% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në vitin 2013 dhe 2014. Sektori i naftës dhe ai minerar së bashku përbënin 5% të PBB-së, ndërkohë që sektori i energjisë elektrike kontriboi me rreth 2% të PBB-së në të dy vitet.

Nafta e papërpunuar përbënte burimin kryesor të energjisë së prodhuar në Shqipëri duke përfaqësuar 67.7% të burimeve parësore të energjisë së prodhuar në vitin 2014 (2013: 59.1%) ndjekur nga sektori i energjisë elektrike me rreth 20% të burimeve parësore të energjisë së prodhuar në vitin 2014 (2013: 29.3%).

Grafiku 5 - Energjia prodhuar nga burimet primare 2014



Grafiku 6 - Energjia prodhuar nga burimet primare 2013



Burimi: INSTAT – Pavarësia energjetike kombëtare

Statistikat e Qeverisë nuk mundësojnë shifra të sakta të të ardhurave totale që Qeveria gjeneron nga sektori nxjerrës. Megjithatë, po të kemi parasysh të ardhurat e gjeneruara nga flukset kryesore të të ardhurave (renta minerare, tatimi mbi fitimin, ndarja e prodhimit të naftës, bonuset e nënshkrimit, dhe pagesat e tjera të industrisë), industria nxjerrëse dhe sektori hidro-energjitik kanë kontribuar **jo më pak se 12.9 bilion Lek ose 3.9 % e të ardhurave totale në Buxhetin e Shtetit në vitin 2013. Në vitin 2014**, sektori nxjerrës dhe sektori i hidro-energjisë ka kontribuar **jo më pak se 12.7 bilion Lek** ose **3.5% të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit** (referoju tabelës 1 më poshtë).

[1] Llogaritë Vjetore Kombëtare (metoda e prodhimit) në vitet 2008-2014 publikuar në www.instat.gov.al.

Tabela 1 – Të ardhurat e Shtetit nga sektori nxjerrës dhe hidro-energjia

Ne milion Lek

	2013						2014					
Llojet e pagesave (*)	**Albpetrol**	**AKBN**	**ERE**	**KESH**	**Buxheti i Shtetit**	**Total**	**Albpetrol**	**AKBN**	**ERE**	**KESH**	**Buxheti i Shtetit**	**Total**
Ndarja e prodhimit të naftës	4,968	-	-	-	-	**4,968**	4,354	-	-	-	-	**4,354**
Bonuset	11	47	-	-	-	**58**	12	23	-	-	-	**35**
Tarifa kocensionare	-	-	-	133	-	**133**	-	-		190	-	**190**
Pagesat rregullatore	-	-	23	-	-	**23**	-	-	72	-	-	**72**
Të tjera	-	-	-	-	-	**-**	-	633	-	-	-	**633**
Renta minerare	-	-	-	-	10,037	**10,037**	-	-	-	-	9,730	**9,730**
Tatimi mbi fitimin	-	-	-	-	2,885	**2,885**	-	-	-	-	2,224	**2,224**
Dividendët	-	-	-	-	-	**-**	-	-	-	-	757	**757**
	4,979	**47**	**23**	**133**	**12,922**	**18,104**	**4,366**	**656**	**72**	**190**	**12,711**	**17,995**
Nafta dhe gazi	4,979	47	-	-	9,970	**14,996**	4,979	656	-	-	9,904	**15,539**
Minerar	-	-	-	-	2,433	**2,433**	-	-	-	-	2,554	**2,554**
Hidro-energjia	-	-	23	133	520	**676**	-	-	72	190	253	**515**

(*) Pagesat listuar më sipër përfaqësojnë pagesat më të rëndësishme kryer nga shoqëritë e licensuara Buxhetit të Shtetit, AKBN-së, ERE-s, KESH-it dhe shoqërisë Albpetrol dhe të përzgjedhura për rakordim në këtë raport. Kjo listë nuk përmbledh të gjitha pagesat e zbatueshme. Sistemet e informacionit të Qeverisë nuk e mundësojnë paraqitjen e totalit të të ardhurave arkëtuar nga tre sektorët. Duke përjashtuar rentën minerare, e cila është paraqitur e plotë nga agjentët mbledhës, respektivisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Doganore Shqiptare, pagesat e tjera përmbledhin shumat deri në nivelin e raportuar nga të lincensuarit dhe institucionet publike mbledhëse për qëllime rakordimi në këtë raport. Për këtë arsye, me përjashtim të rentës minerare, shumat e treguara më sipër nuk japin totalin e të ardhurave të qeverisë në sektorin e naftës, minerar, dhe hidro-energjisë.

Renta minerare përbën fluksin kryesor të të ardhurave nga sektori nxjerrës i naftës, gazit dhe minerar në Buxhetin e Shtetit. Renta e mbledhur në vitin 2014 ishte 3% më pak se në vitin 2013. Renta minerare pësoi ulje, pavarësisht rritjes së prodhimit të naftës dhe atij minerar. Ky trend është pasojë e rënies së çmimeve të naftës dhe mineraleve në tregun ndërkombëtar. **Ndarja e prodhimit të naftës** përbën grupin e dytë më të madh të të ardhurave të mbledhura nga sektori i naftës. Shoqëritë private të naftës paguan në natyrë gjithë sasitë e prodhimit të naftës prej 75,825 ton në vitin 2013 dhe 94,304 ton në vitin 2014. Vlerat e treguara më sipër për të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës janë vlerësuar me çmimin mesatar të shitjeve vjetore zbatuar nga Albetrol prej 441 $/ton në vitin 2013 dhe 396 $/ton në vitin 2014. Shumat në dollar janë përkthyer në Lek me normën mesatare vjetor sipas Bankës së Shqipërisë, respektivisht 1 dollar i barabartë me 105,7 Lek në vitin 2013 dhe 1 dollar i barabartë me 105.5 Lek në vitin 2014.

Në vitin 2013 Buxheti i Shtetit arkëtoi të ardhura prej 15,439 miliard Lek nga privatizimi i hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit dhe Bistricës 1 dhe 2, të cilat vepronin nën administrimin e KESH deri në mes të vitit 2013. Për shkak të natyrës që ka kjo e ardhur nuk është përfshirë në tabelën më sipër. Nëse kjo shumë do të përfshihej në të ardhurat e përmbledhura më sipër, kontributi në Buxhetin e Shtetit do të rritej nga 3.9% deri në 8.7%.

Grafiku 7 – Eksportet nga industria nxjerrëse ndaj totalit te eksporteve



Burimi – Administrata Doganore Shqiptare[2]

Eksportet nga sektori nxjerrës janë rritur ndjeshëm me mbi 100% në katër vitet e fundit.

Në vitin 2013 eksportet nga sektori nxjerrës arritën në 96.7 miliard Lek ose 39% të totalit të eksporteve. Në vitin 2014, eksportet ranë në 82.2 milliard Lek ose 32% të totalit të eksporteve.

Siç tregohet në grafikun 4, kjo rënie i atribuohet rënies së eksporteve të naftës së papërpunuar të cilat zinin peshën më të lartë të eksporteve nga sektori nxjerrës në katër vitet e fundit me rreth 64% deri në 75%.

Grafiku 8 – Eksportet nga industria nxjerrese sipas mineraleve



Burimi – Administrata Doganore Shqiptare[2]

Nafta e papërpunuar u eksportua kryesisht në Itali, Spanjë dhe Maltë. Ndërsa Kina ishte importuesi kryesor i mineralve të kromit dhe bakrit prodhuar në vend.

Figura 1 – Destinacionet kryesore për eksport të naftës së papërpunuar, kromit dhe bakrit:



Burimi – Administrata Doganore Shqiptare[2]

[2] Adminsitrata Doganore Shqiptare e raportoji zyrtarisht këtë informacion për përpilimin e këtij raporti.

Nafta dhe Gazi

Në vitin 2013 dhe 2014, sektori i naftës dhe gazit numëroi **pesë shoqëri në prodhimin e naftës dhe gazit** në pjesën jugore të Shqipërisë dhe **gjashtë shoqëri** të angazhuara në **kërkimin e naftës**. Shteti u përfshi në sektor përmes zotërimit direkt të shoqërisë Albpetrol, e angazhuar në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit. Albpetrol ka të drejta prodhimi, si i licensuar parësor, në të gjitha fushat ekzistuese të naftës. Me qëllim përmirësimin e efikasitetit në prodhim, Albpetrol i ka deleguar të drejtat e tij tek shoqëritë private të naftës nëpërmjet marrëveshjeve hidrokarbure.

Prodhimi i naftës së papërpunuar është rritur më shumë se dyfish që prej vitit 2003, kur Shoqëritë private të naftës filluan punën në sektor. Në vitin 2013, AKBN raportoi prodhim të naftës së papërpunuar prej **1,203,637 ton** vlerësuar me **530 milionë USD**. Prodhimi në vitin 2014 u rrit në **1,386,124 ton** me një vlerë të përllogaritur në **549 milion USD**. **Bankers Petroleum që operon fushën naftë-mbajtëse të Patos-Marinzës**, gjeneroi **mbi 87% të totalit të prodhimit të naftës së papërpunuar** në vitin 2013 dhe 2014. Prodhimi i Albpetrol përbënte rreth 3% të prodhimit total të naftës në të dy vitet. **Kontributi i sektorit të naftës dhe gazit në Buxhetin e Shtetit** përllogaritet jo më pak se **3%** në vitin **2013** dhe jo më pak se **2.7%** në vitin **2014**. Panvarsisht rritjes së prodhimit të naftës në vend, të ardhurat nga renta minerare u ulën me rreth 6% në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013. Kjo rënie i atribuohet kryesisht rënies së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, që çoi në rënien e të ardhurave nga renta minerare, e cila përfaqëson zërin kryesor të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nga nafta.

Pavarësisht rritjes së prodhimit, **numri punonjësve** në këtë sektor u zvogëlua me 23% në katër vitet e fundit. Kjo rënie erdhi si rezultat i transferimit të operacioneve të prodhimit nga Albpetrol tek shoqëritë private të naftës. Sektori privat nuk mundi të tërheqë fuqinë punëtore që u larguar nga Albpetrol për shkak të transferimit të operacioneve. Në vitin 2014, sektori nxjerrës i naftës dhe gazit punësoi rreth 3,109 punonjës duke kontribuar me **rreth 0.3%** në forcën punëtore të përgjithshme të regjistruar sipas INSTAT në vitin 2014. **Albpetrol** mbetet punëdhënësi më i madh në këtë sektor në vitin 2014, me rreth 2,062 të punësuar, ose **66% të punësimit total në sektorin nxjerrës të naftës dhe gazit**.

Në vitin 2013, **nafta bruto e prodhuar përbënte 98% të kërkesës së brendshme për konsum matur në naftë bruto**. Në vitin 2014, ky raport u rrit në **108%, duke tejkauar më 8% kërkesën e brendshme për konsum matur në naftë bruto**. Bazuar në këto të dhëna, mund të supozohet se në qoftë se prodhimi vendas i naftës së papërpunuar do të përpunohej në Shqipëri, prodhimi vendas do të ishte shumë pranë përmbushjes së kërkesës së brendshme për konsum.

Nafta e prodhuar në vend kryesisht është eksportuar për t'u përpunuar jashtë vendit. Konsumi i brendshëm për nënproduktet e naftës përmbushet përmes importit. Bazuar në të dhënat e raportuara nga Administrata Doganore Shqiptare, **eksportet e naftës së papërpunuar ishin rreth 104% të naftës së prodhuar në vitin 2013**. Ky raport ra në **77% të naftës së prodhuar në vitin 2014**, kur **nafta bruto e përpunuar përmes rafinerive vendase arriti në 22%.**

Sektori minerar

Si një vend tradicional minerar, Shqipëria ka një numër në rritje të shoqërive të vogla dhe të mesme në këtë sektor, si dhe numëron vetëm disa shoqëri të mëdha industriale. Në nëntor 2015, AKBN raportoi **600 licensa minerare**, ku **112** licensa **prodhonin krom në minierat e Bulqizës**.

Prodhimi minerar u vlerësua me rreth **140.9 milion USD në vitin 2013** dhe **175.5 milion USD në 2014**.

Prodhimi i kromit zinte pjesën më të madhe të prodhimit minerar vendas me rreth **72% në vitin 2013 dhe 76% në vitin 2014. Guri gëlqeror dhe mineralet e tjera të ndërtimit** përfaqësonin grupin e dytë më të madh të mineraleve pas kromit. Pesha e tyre në prodhimin minerar vendas ishte rreth **14% në vitin 2013** dhe **12% në vitin 2014**.

Sektori minerar punësoi rreth 3,800 punonjës në vitin 2013 (**0.3%** të fuqisë punëtore të regjistruar në vend) dhe 4,300 punonjës në vitin 2014 (**0.4%** të fuqisë punëtore të regjistruar në vend). Punësimi në sektorin e kromit, në veçanti, zinte rreth **59% të totalit të fuqisë punëtore punësuar në sektorin minerar në vitin 2013** dhe **69% në vitin 2014**. Kontributi i sektorit minerar përllogaritet të jetë jo më pak se **0.7% e të ardhurave totale në Buxhetin e Shtetit** në të dy vitet.

Sektori i hidro-energjisë

Prodhimi hidro-energjitik në Shqipëri dominohet nga sektori publik. Në fund të vitit 2014, Shteti Shqiptar zotëronte dhe administronte Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

KESH është prodhuesi më i madh në vend. Me një kapacitet të instaluar prej **1,448 MW ose 80% të fuqisë totale të instaluar** në vend, ndërtuar në kaskadën e lumit Drin në veri, KESH gjeneroi rreth **87% të prodhimit të energjisë në vitin 2013**. Kjo peshë ra në **72% në vitin 2014**, për shkak të rritjes së aktivitetit të HEC-eve private dhe HEC-ve me kocension në këtë sektor.

ERE raportoi një prodhim vendas hidro-energjitik prej **6,956 GWh në vitin 2013** dhe **4,726 GWh** në vitin 2014. Nëse prodhimi vendas do të vlerësohej me çmimet mesatare zbatuar në eksportet e energjisë, vlera e prodhimit vendas do të ishte rreth 25.5 miliard Lek (ekuivalente me 243 milionë USD) në vitin 2013 dhe 24.1 miliard Lek (ekuivalente me 229 milionë USD) në vitin 2014. Megjithatë, për shkak se KESH e shet prodhimin e tij me çmim të rregulluar prej 1 Lek për KWh (ekuivalente me 0.01 USD për KWh) **shitjet nga sektori nuk i kalojnë 11 miliard Lek (ekuivalente me 106 milionë USD) në vitin 2013 dhe në 9.6 miliard Lek (ekuivalente me 91 USD) në vitin 2014.**

Shteti shqiptar subvencionon sektorin e energjisë përmes rregullimit të çmimeve të prodhimit të energjisë, transmetimit dhe shpërndarjes. Ky fakt shpjegon **kontributin** relativisht të ulët të sektorit **në PBB-në**, rreth **2%.**

Në **vitin 2013, humbjet** në sistemin e shpërndarjes për shkak të kushteve të dobta teknike dhe lidhjeve informale në sistem **ishin rreth 45% e energjisë së transmetuar**. Në vitin **2014,** humbjet ranë në **37.81%** energjisë së transmetuar[3] si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Qeverisë Shqiptare dhe OSHEE. **Kontributi i munguar i humbjeve të energjisë** matur me çmimet mesatare të eksportit vlerësohet të jetë rreth **22.3 miliard Lek në vitin 2013** (ekuivalente me 212 milionë USD) dhe **19.9 miliard Lek në vitin 2014** (ekuivalente me **190 milionë USD**).

Struktura e kostos së prodhimit të brendshëm të energjisë ka ndryshime në 5 vitet e fundit, me rritjen e prodhimit nga HEC-t private dhe me kocension dhe pritet të ndryshojë edhe më tej në të ardhmen, kur një numër i madh HEC-sh të mesme dhe të vogla me kocension do të hyjnë në fazën e prodhimit.

Kontributi i sektorit përllogaritet jo më pak se **0.2%** të të **ardhurave totale të Buxhetin e Shtetit në vitin 2013** dhe **0.1% në vitin 2014**. Përkrah fluksit normal të të ardhurave ne vitin 2013, Qeveria Shqiptare arkëtoi rreth 15,439 miliard Lek nga privatizimi i hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit dhe Bistrica 1 dhe 2, të cilat ishin nën administrimin e KESH deri në mesin e vitit 2013. Nëse do të shtonim edhe këto të ardhura, kontributi në Buxhetin e Shtetit në vitin 2013 do të rritej në 4.9%.

Të dhënat e raportuara nga AKBN tregojnë se një numër i madh HEC-sh dhënë me kocension nuk kanë filluar ende ndërtimin ose janë ende në ndërtim e sipër në datën e këtij raporti, duke shfaqur vonesa me dy ose më shumë vite. Më konkretisht, nga 502 HEC-e dhënë me kocension, 308 HEC-e me fuqi të instaluar prej 1,152 MW dhe energji të parashikuar prej 5,359 GWh nuk kanë filluar ende ndërtimin. Ndërsa 84 HEC-e janë në fazën e ndërtimit. Nëse të gjitha HEC-et do të kishin përfunduar ndërtimin brenda dy vjetëve nga data e kocensionit dhe do të prodhonin energjinë e parashikuar në kontratën e kocensionit, tarifa e kocensionit do të ishte rreth 1.78 miliard Lek në vitin 2013 dhe rreth 1.9 miliard Lek në vitin 2014. Këto vlera janë mbi 10 herë më shumë se të ardhurat nga tarifa e kocensionit e mbledhur në të dy vitet.

Infrastruktura e gazit

Shqipëria pritet të të ketë akses në furnizimin me gaz pas pesë vitesh, përmes lidhjes me Trans-Adriatic Pipeline që do të përshkojë për rreth 215 kilometra pjesën jugore të vedit. Qeveria Shqiptare miratoi ligjin për sektorin e gazit natyror Nr.102 / 2015 në mars të vitit 2015. Ky ligj do të qeverisë zhvillimin e infrastrukturës për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit në Shqipëri.

[3] Energjia e transmetuar përfshin njëkohësisht konsumin e brendshëm të energjisë dhe humbjet.

2.1.2 Institucionet publike dhe entet që qeverisin sektorin

Figura 2- Institucionet kryesore publike dhe linjat e raportimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISË

Ministria e Energjisë dhe Industrisë[4] ("MEI" ose "Ministria") është Ministria përgjegjëse për hartimin e politikave publike dhe mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit në sektorin e energjisë dhe të burimeve natyrore. Ajo operon nëpërmjet drejtorive përgjegjëse për zhvillimin e politikave publike në sektorin naftës, minerar, elektro-energjisë, burimeve të ripërtëritshme dhe efiçencës së energjisë dhe drejtorinë e zhvillimit të industrisë dhe standarde teknike.

MEI është përgjegjëse për dhënien e liçencave për kërkim dhe prodhim në sektorin minerar, për vlerësimin e aplikimeve për marrëveshjet hidrokarbure dhe të drejtat kocensionare për ndërtimin e hidrocentraleve në Shqipëri. **Marrëveshjet hidrokarbure dhe kocensionet e hidro-energjisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.**

Misioni i Ministrisë në sektorin e energjisë është promovimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik përmes:

- nxitjes së investimeve private, vendase ose të huaja, në sektorin e energjisë duke promovuar një klimë ligjore tërheqëse për këto investime, dhe
- zhvillimit të reformave të tregut në sektorin energjitik për të arritur objektivat kombëtare për integrimin në Bashkimin Evropian dhe zhvillimin e një Tregu Rajonal të Energjisë Elektrike.

MEI financohet kryesisht nga Buxheti i Shtetit në përputhje me ligjin e buxhetit. Të ardhurat e mbledhura nga sektori i energjisë përfshijnë tarifat e shërbimit dhe pagesat nga licensat. Ministria operon përmes Sistemit të Thesarit te Shtetit, ku të ardhurat e mbledhura dhe disbursimet për shpenzime grumbullohen në llogaritë bankare të përbashkëta të Shtetit. MEI publikon informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit: http://www.energjia.gov.al/al/publikime/trasparence-per-publikun/te-dhena-financiare-te-mei.

Llogaritë vjetore të MEI auditohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si pjesë e aktivitetit të tij.

Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe **Shërbimi Gjeologjik Shqiptar** mbështesin Ministrinë në arritjen e objektivave kryesore në sektorin e energjisë dhe burimeve.

[4] Faqja e internetit: www.energjia.gov.al

Shoqëritë në pronësi të Shtetit (SOE-të) në sektorin e energjisë dhe burimeve

Përfaqësuesit e MEI-t kryesojnë Bordin e Drejtorëve të shoqërive në pronësi shtetërore në sektorin e energjisë dhe burimeve. **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes** përgjegjese për politikat ekonomike, zotëron aksione në këtë sektor përmes zotërimit të:

- **Albpetrol Sh.a** (100% të aksioneve) – kërkim, zhvillim dhe prodhim i naftës dhe gazit
- **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a ("KESH")** (100% të aksioneve) – prodhim i energjisë elektrike
- **Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a. ("OST")** (100% të aksioneve) – transmetim i energjisë elektrike
- **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a. ("OSHEE")** (100% të aksioneve) – shpërndarja e energjisë elektrike

Gjithashtu, Shteti zotëron 15% të aksioneve në shoqërinë **ARMO Sh.a.** angazhuar në përpunimin e naftës. **Roli i shoqërive Albpetrol dhe ARMO shpjegohet në seksionin 2.2 Sektori i naftës dhe i gazit. Roli i KESH, OST dhe OSHEE shpjegohet në seksionin 2.4 Sektori i Hidro-energjisë.**



Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBR) është themeluar si një entitet publik i veçantë që raporton tek Ministria përgjegjëse për Energjinë në përputhje me VKM Nr. 547 datë 9 Gusht 2006, të ndryshuar.

Qëllimi kryesor i AKBN është zhvillimi dhe mbikqyrja e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore në sektorin minerar, naftës dhe mbarë sektorin e energjisë bazuar në politikat qeverisëse në fuqi.

Për arritjen e misionit të saj, AKBN kryen funksionet të mëposhtme në sektorin e naftës, minerar, dhe energjisë:

- Merr pjesë në zhvillimin e strategjive dhe politikave qeverisëse;
- Kryen oponencën teknike shtetërore për studimet dhe projektet e zbatuara në këto sektorë;
- Promovon burimet vendase të naftës, gazit dhe minerare si dhe mundësitë për energjinë e ripërtëritshme;
- Negocion dhe mbikqyr zbatimin e marrëveshjeve të hidrokarbure dhe minerare;
- Mbikqyr zbatimin e marrëveshjeve kocensionare në sektorin e hidro-energjisë;
- Administron të dhënat e prodhuara nga sektorët dhe harton bilancin kombëtar dhe rajonal të energjisë sipas kerkesave të EUROSTAT [5] dhe Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë [6] etj..

AKBN drejtohet nga Këshilli Drejtues i përbërë prej shtatë anëtarësh duke përfshirë Kryetarin dhe Drejtorin Ekzekutiv. Të gjithë anëtarët emërohen nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë. AKBN kryen funksionet e tij publike përmes drejtorive të naftës, minierave, hidro-energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme përgjegjëse për secilin sektor.

[5] http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/energy/data/energy-balances
[6] http://www.iea.org/

AKBN financohet kryesisht nga:

- Buxheti i Shtetit për projekte të veçanta të zbatuara në sektorët e naftës, minierave, hidro-energjisë dhe të energjisë së ripërtëritshme;
- Tarifat për shërbimet e kryera gjatë procesit të licensimit dhe projekteve ndër-institucionale;
- Shpërblimet (Bonuset) që rrjedhin nga nënshkrimi i marrëveshjeve të naftës;
- Ekzekutimi i garancive të performancës që rrjedhin nga mos-zbatimi i kushteve të licensë-marrëveshjeve në sektorin e naftës dhe atë minerar;
- Shitja e interesave shtetërore në marrëveshjet hidrokarbure;
- Interesat bankare;
- Donacionet etj.

AKBN nuk derdh në Buxhetin e Shtetit tepricën e të ardhurave mbi shpenzimet vjetore, por i mbart ato në vitet e ardhshme fiskale. AKBN administron llogaritë e veta bankare ku depoziton tepricën e fondeve. **Llogaritë vjetore AKBN auditohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si pjesë të aktivitetit të tij, megjithatë këto llogari nuk ishin publike në datën e këtij raporti.**

Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar (SHGJSH) përfaqëson institucionin më të vjetër publik i cili vepron si këshilltar shkencor në përputhje me Ligjin Nr. 8366, datë 2 korrik 1998 "Për Shërbimin Gjeologjik", ndryshuar nga ligji Nr. 9221, datë 15 prill 2004 dhe ligji Nr. 10227, datë 4 shkurt 2010. Në vitin 2015 Parlamenti Shqiptar miratoi një ligj të ri Nr. 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", i cili shfuqizoi ligjin e parë. SHGJSH është përgjegjës për shume studime shkencore në fushën e hidrokarbureve, mineraleve, hidro-energjisë, etj. SHGJSH publikon në faqen e internetit www.gsa.gov.al projektet e zbatuara ose në zbatime. Projektet kryesore të ndërmarra në sektorin e energjisë dhe burimeve përfshijnë:

- Përpilimi i hartave dixhitale për sektorët minerar dhe hidro-energjisë;
- Vlerësimi i mundësive minerare në zonën e Qafë Mali – Perlat;
- Vlerësimi i mundësive të naftës në rajonin e Shtepëz në Veri të Delvinës;
- Monitorimi i përdorimit dhe administrimit të ujërave nëntokësore, lumenjve dhe baseneve etj.

Përveç të tjerave, SHGJSH është përgjegjës për promovimin dhe negocimin e licensave për kërkim në sektorin minerar dhe gjithashtu monitorimin e zbatimit të projektit për çdo licensë të dhënë.

SHGJSH financohet nga Buxheti i Shtetit, tarifat e shërbimit dhe tarifat për oponencën teknike shtetërore dhe studimet gjeologjike.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është një institucion i pavarur publik, përgjegjës për rregullimin e aktivitetit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, organizuar në përputhje me ligjin Nr. 9072, datë 22 maj 2013 "Për sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, dhe ligjin Nr. 9946 datë 30 qershor 2008 "Për sektorin e gazit". Në vitin 2015 Parlamenti Shqiptar aprovoi ligjin e ri Nr. 102/2015 datë 23 Shtator 2015 "Për Sektorin e gazit natyror", i cili shfuqizoi ligjin e parë. ERE është autoriteti përgjegjës për licensim në prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim dhe tregtim të energjisë elektrike. ERE drejtohet nga Bordi i Komisionerëve përzgjedhur nga Parlamenti Shqiptar.

ERE është përgjegjëse për:

- Vendosjen e rregullave dhe kërkesave për licensimin, transferimin dhe heqjen e licensave në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike dhe gazit;
- Përcaktimin e tarifave të shitjes me shumicë dhe pakicë, si dhe termat dhe kushtet për shërbimet e energjisë;
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve të energjisë;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes të licensuarve dhe konsumatorëve dhe ndërmjet të licensuarve;
- Ruajtja e balancës së interesave mes të licensuarve, konsumatorëve, Shtetit dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë;
- Promovimi i konkurencës në sektorin e energjisë;
- Krijimi i rregullave të tregut, dhe kodeve që rregullojnë aktivitetet e pjesmarrësve në sektorin e energjisë;
- Përcaktimi i tarifave për të gjitha Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) në përgjithësi, dhe energjisë elektrike në veçanti.

ERE financohet nga tarifat për licensat dhe tarifat rregullatore të paguara nga të licensuarit në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, tregtimin e energjisë elektrike dhe të licensuarit në transmetimin dhe shperndarjen e gazit etj.

ERE i raporton çdo vit Parlamentit Shqiptar “Për Situatën e Sektorit të Energjisë dhe Aktivitetin e ERE”. Raporti i aprovuar nga Parlamenti publikohet në faqen e internetit të ERE: www.ere.gov.al brenda tre muajsh nga mbyllja e periudhës në raportim. Pasqyrat Financiare vjetore të ERE publikohen në raportin vjetor të ERE. **Llogaritë vjetore të ERE auditohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si pjesë e aktivitetit të tij**

2.1.3 Anëtarësimi në nismat Rajonale të Energjisë

Shqipëria është anëtare e Komunitetit Rajonal të Energjisë që nga viti 2006, pjesë e iniciativave të Bashkimit Evropian për krijimin e tregut Evropian të energjisë.

Komuniteti i Energjisë, si një organizatë ndërkombëtare, ka si qëllim bazë zhvillimin e një politike të përbashkët të energjisë në rajonin e Evropës Juglindore dhe integrimin e saj në tregun e energjisë të Bashkimit Evropian (BE), përmes krijimit të një tregu të integruar të energjisë për të lejuar tregtimin ndër-kufitar të energjisë dhe integrimin me tregun e BE-së.

Me nënshkrimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria është angazhuar për zbatimin e legjislacionit të tregut të përbashkët bazuar në *acquis communautaire* duke zhvilluar një rregullore të përshtatshme dhe duke liberalizuar tregun e energjisë në përputhje me *acquis*. Detajet mbi qëllimet dhe aktivitetet e komunitetit mund të gjenden në: https://www.energy-community.org/.

2.2 Sektori i naftës dhe gazit

2.2.1. Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i naftës dhe gazit [7]

Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918. Që nga ajo kohë, u zbuluan fusha naftë-mbajtëse në zona tokësore dhe detare siç tregohet në figurën 3.

Vendburimet e naftës në Shqipëri shtrihen në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore të vendit, dhe janë kryesisht në dy struktura: vendburime ranore dhe vendburime gëlqerore. Aktualisht këto vendburime kanë rezerva të konsiderueshme por shfrytëzimi i plotë i tyre kërkon metoda të avancuara dytësore për nxjerrjen e naftës.

Tabela 2 më poshtë përmbledh rezervat e vlerësuara përmes studimeve të kryera nga shoqëritë e huaja dhe Albpetrol[8] nga viti 1985 deri në vitin 1990. Sipas këtyre studimeve rezervat e naftës në vendburimet ekzistuese në Shqipëri arrijnë rreth 437.6 milion ton, megjithatë rezervat e rikuperueshme vlerësuar dhe bazuar në metodat e zbatuara në ato vite, arrijnë në 81 milion ton. Rezervat gjeologjike të vlerësuara në strukturat ranore përbënin 77.4% të rezervave totale, megjithatë rikuperimi i tyre është vlerësuar në masën 13%. Rikuperimi i rezervave gjeologjike nga strukturat gëlqerore varion nga 24% në 53%. Albpetrol raporton se prodhimi kumulativ i naftës së papërpunuar nga strukturat ranore dhe gëlqerore deri në 31 dhjetor 2014 përllogaritet në 58 milion ton[7].

Rezervat e gazit natyror në vend përllogariten në 18,164 milionë Nm^3 dhe shtrihen kryesisht në zonën e Kuçovës dhe Patosit. Albpetrol raporton se prodhimi kumulativ i gazit deri në fund të vitit 2012 përllogaritet në 12,504 milion Nm^3[8].

Figura 3 – Vendburimet e naftës dhe gazit në Shqipëri [7]



Tabela 2 – Rezervat gjeologjike dhe të rikuperueshme të naftës bazuar në studime të viteve 1985-1990 dhe prodhimi kumulativ i naftës deri në 2014[8]

Vendburimet	Strukturat	Rezervat në *'000 ton*		Norma e rikuperimit	Prodhimi kumulativ deri në 2014 *në '000 ton*	Rezervat e rikuperueshme më 31 dhjetor 2014 *në '000 ton*
		Gjeologjike	Të rikupe-rueshme			
Cakran –Mollaj		16,128	8,144	50%	4,269	3,875
Ballsh-Hekal		19,269	6,360	33%	5,054	1,305
Gorisht –Kocul		30,500	14,674	48%	11,988	2,686
Amonice	**Gëlqerore**	411	136	33%	94	42
Visoke		2,836	1,503	53%	703	800
Delvine		28,362	6,807	24%	6,214	593
Finiq –Krane		335	134	40%	19	115
Drashovica	**Flysch**	1,027	154	15%	10	144
Total gëlqeror		**98,869**	**37,912**	**38%**	**28,351**	**9,561**
Patos-Marineza		258,394	31,120	12%	25,436	5,684
Kucove	**Ranore**	78,332	11,772	15%	4,260	7,513
Rase-Pekisht		1,970	197	10%	17	180
Total ranor		**338,696**	**43,090**	**13%**	**29,713**	**13,377**
Total		**437,565**	**81,002**	**19%**	**58,064**	**22,938**

[7] Burimi: *+Invest in Albanian Natural Resources – Mineral Resources*", publikuar në gusht 2010, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) adresa e internetit – www.akbn.gov.al

[8] Informacioni për rezervat dhe prodhimin kumulativ u raportua nga Albpetrol për përpilimin e këtij raporti. Të dhëna të përmbledhura në rang vendi paraqiten në adresën e internetit: http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/

Strukturat ranore përfshijnë vendburimin më të madh të naftës në vend, **Patos-Marinzën**, me rezerva gjeologjike vlerësuar në 258.4 milion ton. Patos-Marinza përbën 60% të rezervave gjeologjike, megjithatë për shkak të formimit, përqindja e rikuperimit përmjes metodave parësore të nxjerrjes së naftës është vlerësuar në masën 12%.

Të dhënat e Albpetrol më 31 dhjetor 2014, paraqitur në tabelën 2, tregojnë rezerva të rikuperueshme në Patos-Marinzë prej 5.7 milion ton naftë bruto.

Grafiku 9: Rezervat e Banker's ne vitin 2014

Ne milion barela



Megjithatë, Bankers Petroleum Ltd ("Bankers Petroleum") që operon vendburimin e Patos-Marinzës përmes metodës së shpimit horizontal raportoi rezerva më të mëdha matur në këtë vendburim.

Sipas deklarates për shtyp të Bankers Petroleum, rezervat e provuara në fund të vitit 2014 në vendburimin e Patos-Marinzës ishin rreth 122.3 milion fuçi ekuivalente me 18.5 milion ton[9] të naftës së papërpunuar. Rezervat e provuara plus ato të mundshme u përllogaritën në 191.4 milion fuçi ekuivalente me 41.4 milion ton naftë bruto.

Burimi: http://www.bankerspetroleum.com/operations/reserves

Gjeologjia e naftës

AKBN paraqet informacion të detajuar për formimin gjeologjik në territorin e Shqipërisë, përfshirë këtu informacion për mundësitë në tokë dhe në det në publikimin "Mundësitë e kërkimit dhe prodhimit të naftës në Shqipëri". Ky publikim mund të gjendet në faqen e internetit të AKBN: www.akbn.gov.al. Një përmbledhje e historisë së kërkimit dhe karakteristikave të naftës në vendburimet në Shqipëri është dhënë në tabelën 3 më poshtë:

Tabela 3 – Përmbledhje e aktivitetit të kërkimit në Shqipëri

Vendburimet	Viti i zbulimit	Tipi i rezervuarit	Thellësia e rezervuarit (m)	Graviteti (API)	Përmbajtja e Squfurit (%)
Drashovica	1918	Oligoc-flysch	100-200	Oil < 10 °	N/a
Patos	1927	Mess-clastics	Surface to 1200	Oil (12-24° API)	2.5-6
Kuçova	1928	Mess-clastics	Surface to 1500	Oil (13-16° API)	4
Marinza	1957	Mess-clastics	1200-1800	Oil (12-35° API)	4-6
Visoka	1963	Cret/Eoc.Carb	800-1000	Oil (5-16° API)	5-6
Gorisht- Kocul	1965	Cret/Eoc.Carb	1000-2500	Oil (17° API)	6
Ballsh-Hekal	1966	Cret/Eoc.Carb	1000-3000	Oil (12-24° API)	5.7-8.4
Cakran-Mollaj	1977	Cret/Eoc.Carb	3000-4500	Oil 14-37 ° API) Cond., 52 ° API	0.9
Finiq- Krane	1973	Cret/Eoc.Carb	800-2000	Oil (<10° API)	3.7-4.3
Delvina	1989	Cret/Eoc.Carb	2800-3400	Oil (31° API) Cond., 53 ° API	0.7
Divjaka	1963	Tort/clastics	2400-3000	Gas & Condensate	N.a
Ballaj-Kryevidh	1983	Piloc/clastics	300-1700	Gas	N/a
Frakulla	1965	Mess-clastics	300-2500	Gas	N/a
Povelca	1987	Mess-clastics	1800-3500	Gas & Condensate	N/a
Panaja	1988	Mess-clastics	2500	Gas	N/a
Adriatik-4 (offshore)	1994	Mess-clastics	2500-3100	Biogenic Gas & Cond, 54.3° API	N/a
Sqepuri	2001	Cret/Eoc.Carb	4950	Oil (37° API)	2.3

N/d – nuk disponohet

Burimi: "Petroleum exploration dhe production opportunities in Albania", publikuar nga AKBN – www.akbn.gov.al

[9]1 Metric Ton naftë brut konvertohet në 6.5939 barela sipas Informacionit të administruar nga US Energy për Shqipërinë: http://www.eia.gov/cfapps/ipdbproject/iedindex3.cfm?tid=94&pid=57&aid=32&cid=AL,&syid=2010&eyid=2014&unit=BCOPMT

Ligji për Naftën

Kërkimi, zhvillimi, dhe prodhimi i naftës dhe gazit në Shqipëri janë të rregulluara me ligjin nr.7746 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)", datë 28 korrik 1993 i indryshuarr si ("Ligji për hidrokarburet ")[11].

Në Ligjin e Naftës shprehet qartë se të gjitha depozitat ekzistuese të naftës në kushtet e tyre natyrore në shtresat tokësore brenda juridiksionit të Shqipërisë janë pronë ekskluzive e Shtetit Shqiptar. Ligji ngarkon Ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë të nënshkruajë marrëveshje për hidrokarburet, ku një Shoqërie nafte t'i japen të drejta ekskluzive për të shqyrtuar dhe për të prodhuar naftë dhe gaz për një periudhë të kufizuar. Aplikantët duhet të vertetojnë që kanë kompetenca teknike dhe aftësi financiare për të kërkuar dhe zhvilluar blloqet dhe vendburimet e naftës.

Ligji për Naftën i jep shoqërive private të naftës që operojnë sipas marrëveshjeve hidrokarbure, të drejtën të eksportojnë dhe të mbajnë pjesën e tyre nga ndarja e prodhimit të naftë në në Shqipëri, nëse nuk ka nevojë urgjente për furnizimin e tregut vendas me naftës së papërpunuar[12]. Gjithashtu, investitorët e huaj palë në marrëveshjet së naftës mund të negociojnë kushtet fiskale për të parandaluar ndryshimet e ardhshme në dëm të shoqërisë. **Në dhjetor 2015, MEI njoftoi se kushtet e stabilitetit fiskal mund të aplikohen për një periudhë jo më shumë se 12 vjet [13].**

Ndryshimet në Ligjin për sektorin Minerar [14]

Në mars 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet e Ligjit për Hidrokarburet. Këto ndryshime shprehin se AlbEITI ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion mbi pagesat e taksave nga subjektet që kanë një Marrëveshjeve Hidrokarbure, organet tatimore dhe doganore dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe t'i publikojë këto të dhëna në raportin EITI.

Marrëveshjet Hidrokarbure

Marrëveshjet hidrokarbure janë hartuar si Marrëveshje me Ndarje të Prodhimit ("MNP" ose "PSA"), ose në një tjetër formë të rënë dakord mes palëve.

Të gjitha marrëveshjet e nënshkruara për operacione hidrokarbure në Shqipëri janë hartuar si marrëveshje me ndarje prodhimi, nënshkruar nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) si përfaqësuese e Qeverisë Shqipëtare.

Siç përshkruhet në Ligjin e Hidrokarbureve, MNP-të për vendburimet ekzistuese, janë dhënë për një periudhë fillestare prodhimi jo më shumë se 25 vjet, afat që mund të zgjatet në përputhje me ligjin për hidrokarburet. Ligji për hidrokarburet[15] përkufizon MNP-të si marrëveshje ku përcakton:

- Shoqëria e licensuar mund të rikuperojë kostot nga prodhimi i hidrokarbureve në zonën e kontratës ose në një pjesë proporcionale të saj ***"kostoja e naftës"***, dhe
- Sasia e hidrokarbureve gjëndje pas mbulimit të kostove të kontratës ***"fitimet nga nafta"***, ndahen ndërmjet Shtetit dhe Kontraktorit, në përputhje me një formulë të përcaktuar në Marrëveshjen Hidrokarbure.

Në dhjetor 2015[13], MEI njoftoi se modeli për mbulimin e kostove do të ndryshojë në mënyrë të tillë që Shoqëritë e naftës të paguajnë tatim mbi fitimin që në fillim të fazës së prodhimit. Sipas modelit të ri 90% e të ardhurave do të mund të përdoren për mbulimin e kostove, ndërsa 10% e të ardhurave do të klasifikohen si fitim neto dhe do tatohen në përputhje me ligjin për tatimin mbi fitimin e operacioneve hidrokarbure.

[11] Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve – www,energjia.gov.al.
[12] Ligji nr. 7746 për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim), Neni 5/c
[13] Adresa e internetit: http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=315023&ref=ngj. Informacioni i konfirmuar nga Drejtori i Drejtorisë së Politikave të hidrokarbureve, Z. Dritan Spahiu.
[14] Kuvendi i Shqipërisë publikon projektligjet dhe ndryshimet në faqen zyrtare të internetit: www.parlament.al.
[15] Ligji nr. 7746 për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim), Neni 2

Kushtet e hollësishme të Marrëveshjeve Hidrokarbure janë konfidenciale dhe nuk publikohen për të gjithë. Termat kryesore dhe detajet e këtyre marrëveshjeve [16] janë paraqitur si më poshtë:

1. **Kohëzgjatja e periudhës së kërkimit**

   Kohëzgjatja e periudhës së kërkimit është 5 vjet dhe mund të zgjatet deri në 7 vjet në përputhje me Ligjin për Hidrokarburet. Periudha e kërkimit është ndarë në tri faza, ku secila ka detyrimet për punime dhe angazhime financiare më vete. Kohëzgjatja e çdo faze të periudhës së kërkimit është subjekt negocimi.

2. **Kohëzgjatja e periudhës së zhvillimit dhe prodhimit**

   Në rast zbulimi, periudha për zhvillim dhe prodhim në zonën e përcaktuar do të jetë njëzet e pesë vjet dhe mund të zgjatet më tej siç parashikohet në Ligjin për Hidrokarburet.

3. **Detyrimet minimale të punës dhe angazhimet financiare**

   Këto detyrime propozohen nga Kontraktori në aplikimin e tij dhe mund të negociohen para se të përfshihen në marrëveshje.

4. **Fondi i administrimit dhe trajnimit**

   Shuma do të specifikohet nga Kontraktori në aplikimin e tij dhe do të jetë subjekt i negociatave.

5. **Mbulimi i kostove dhe ndarja e prodhimit**

   Kushtet për mbulimin e kostove dhe ndarjen e prodhimit të naftës do të përcaktohen nga kontraktori në aplikimin e tij dhe do të jenë subjekt negocimi para se të përfshihen në marrëveshje.

   Kontraktori do të ketë të drejtë të mbledhë dhe të mbajë jashtë vendit të ardhurat nga shitjet në eksport në masën që ato nuk janë të nevojshme për të përmbushur në mënyrë të vazhdueshme kostot lokale në Lek në Shqipëri.

6. **Bonusi**

   Bonusi është i pagueshëm në faza të ndryshme të marrëveshjes PSA (përfshirë bonusin e nënshkrimit). Bonusi i prodhimit dhe bonusi i nënshkrimit janë subjekt negocimi.

[16] "Petroleum exploration and production opportunities in Albania", publikuar nga AKBN – www.akbn.gov.al

2.2.2. Aktiviteti dhe qeverisja e Albpetrol

Shteti merr pjesë në industrinë e naftës dhe të gazit përmes Albpetrol Sh.A., Shoqërisë shtetërore të naftës që vepron në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit.

Albpetrol Sh.A. u themelua më 20 Mars 1993. Para themelimit të saj, Albpetrol ishte pjesë e strukturës qeverisëse përgjegjëse për të gjithë operacionet e naftës dhe gazit në vend.

Që prej krijimit, Shteti i dha Albpetrol sh.a **të gjitha vendburimet ekzistuese të naftës në Shqipëri, si dhe disa blloqe të kërkimit të naftës.** Shtrirja e të drejtave të Albpetrol për kërkimin dhe prodhimin e naftës janë përcaktuar në një marrëveshje të veçantë të miratuar më 26 Korrik 1993 (“Marrëveshja e Albpetrol”).

Aktiviteti fillestar i Alpertol përfshinte kërkimin, prodhimin, përpunimin, marketingun dhe shitjen, si dhe shërbimet e naftës dhe gazit. Në vitin 1999, si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit, Albpetrol u nda në tre Shoqëri shtetërore si më poshtë:

- Albpetrol Sh.a. ("Albpetrol"), që mbajti aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit, dhe gjithashtu trashëgoi administrimin e të gjitha licensave të dhëna para kësaj date;
- ARMO Sh.a. që mbajti përpunimin, marketingun dhe shitjet e naftës; dhe
- Servcom, që mbajti shërbimet e naftës.

Në mënyrë që të arrihet një efiçensë më e mirë në përdorimin e burimeve dhe prodhimin e naftës, ligji i lejon Albpetrolit t’i transferojë të drejtat e tij në kërkim dhe prodhim, me anë të marrëveshjeve hidrokarbure, shoqërive private të naftës dhe gazit, pas miratimit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë. Albpetrol, është palë në këto marrëveshje kur PSA-të i referohen të drejtave dhe zonave të naftës nën administrimin e tij.

Në 31 dhjetor 2014 Albpetrol ka marrëveshje hidrokarbure në fuqi me 5 shoqëri që operojnë në prodhimin e naftës dhe gazit (shiko seksionin 2.2.5), dhe operon disa puse në administrim në Ballsh, Patos dhe Kuçovë. Lista e marrëveshjeve hidrokarbure për operacionet e naftës nën administrimin e Albpetrol paraqitet në Shtojcën 4.

Qeverisja e Albpetrol

Asambleja e Përgjithshme (“Asambleja”) është organi më i lartë qeverisës i Albpetrol. Asambleja emëron anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (“Këshilli”) i cili mbikqyr aktivitetet operative dhe financiare si dhe kontrollet e brendshme të Shoqërisë. Asambleja emëron administratorin e Shoqërisë me një mandat tre-vjeçar, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Këshilli Mbikqyrës. Në përputhje me statutin e Albpetrol, administrimi dhe mbikqyrja e Shoqërisë janë dy funksione të veçanta, ku administratori raporton tek Këshilli Mbikqyrës dhe nuk mund të jetë pjesë e tij. Përveç të tjerash, Këshilli Mbikqyrës përcakton kompensimin e administratorit.

Këshilli Mbikqyrës përbehet nga anëtarë me profesione të ndryshme që përfaqësojnë Qeverinë. Aktualisht, Këshilli Mbikqyrës drejtohet nga **Z. Koli Bele,** Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Të ardhurat e gjeneruara nga Albpetrol

Të ardhurat kryesore që Albpetrol gjeneron nga PSA-të përfshijnë:

- Ndarja e prodhimit të naftës që i shkon Albpetrol-it, dhe
- Bonuset e trajnimit dhe të nënshkrimit.

Ndarja e prodhimit të naftës

Grafiku10: Ndarja e naftes nga PSA-te 2011 - 2014

In thousand tons



Albpetrol zotëron pjesë të naftës së prodhuar nga Shoqëritë private që operojnë në zonat nën administrimin e tij.

Si i tillë ka të drejtë të zotërojë një pjesë të prodhimit, e cila është e përcaktuar me kontratë, në bazë të prodhimit para-ekzistuese ose gjendje në momentin e transferimit të puseve – ("PPE" ose "PEP") dhe prodhimit shtesë (prodhimi i nxjerrë nga investimi i kontraktorit). Pjesa e prodhimit që i takon Albpetrol mund të paguhen në para ose në natyrë.

Në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure, shoqëritë duhet të transferojnë tek Albpetrol pjesë nga prodhimi para-ekzistues dhe prodhimi shtesë në varësi të sasisë së prodhuar dhe shkallës së mbulimit të kostove matur nga faktori R.

Burimi: Të dhëna raportuar nga AKBN[17]

Në vitin 2014 shoqëritë i detyroheshin Albpetrol-it 91,039 ton naftë bruto PPE (2013: 95,270 ton) dhe pjesë nga prodhimi shtesë i naftës së papërpunuar prej 13,140 ton (2013: 11.441 ton).

Në fund të vitit 2014, Albpetrol njoftoi se deri në përfundim të periudhës së marrëveshjeve në fuqi pret të mbledh si PPE, rreth 570,834 ton naftë bruto dhe 13.4 milion Nm^3 gaz të marrëveshjeve.

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit janë pagesa tipike të marrëveshjeve hidrokarbure. Ato përcaktohen brenda termave dhe kushteve specifike të kontratës (sipas negociatave të marrëveshjes) në momentin e dhënies së lejes së kërkimit ose prodhimit të naftës dhe gazit.

Shitjet e naftës të Albpetrol

Albpetrol shet naftën e mbledhur nga PSA-të dhe naftën e nxjerrë nga operacionet e veta, nëpërmjet ankandeve publike[18] në përputhje me ligjet dhe rregulloret për ankandin publik dhe rregullat e procedurat e vendosura në Urdhrin e Ministrit përgjegjës për sektorin e energjisë, nr. 83 datë 10 tetor 2012, të ndryshuar.

Në përputhje me këto rregullore, Albpetrol organizon ankande të hapura për të kontraktuar shitjen vjetore të naftës. Sasia e naftës së shitur bazohet në parashikimet vjetore të prodhimit të naftës dhe pjesës së naftës përftuar nga PSA-të. Albpetrol e shet naftën dhe arkëton pagesat e përcaktuara në kontratë, sipas një kalendari të caktuar përgjatë vitit.

Komisioni që administron ankandin përbëhet nga 7 anëtarë, përfshirë 3 përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, 2 përfaqësues të Albpetrol, 1 përfaqësues nga Inspektoriati Shtetror Teknik dhe Industrial ("ISHTI") dhe 1 përfaqësues nga AKBN. Komisioni është kryesisht përgjegjës për hartimin e kushteve të ofertave, mbikqyrjen e procesit dhe vlerësimin e ofertave.

Çmimi fillestar i ankandit vendoset bazuar në çmimin e naftës Brent përmes një formule që merr në konsideratë cilësinë e naftës që do të shitet, aksesin në tregun ndërkombëtar etj. Çmimi përfshin rregullimet për kostot e transportit në raport me pikën e mbërritjes. Çmimi vendoset nga një grup ekspertësh nga Albpetrol, AKBN, MEI dhe ISHTI.

[17] Ky informacion u raportua nga AKBN për përpilimin e këtij raporti.
[18] Ligji nr. 9874, datë 14 shkurt 2998 "Për ankandin publik" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17 dhjetor 2008 "Për aprovimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar.

Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat e ankandeve të organizuara në vitin 2013 dhe 2015.

Table 4 – Përmbledhje e ankandeve të organizuara në vitet 2013 dhe 2015

Viti i ankandit	Sasia në ton	Çmimi fillestar i ankandit	Oferta fituese	Aplikantët jo fitues	Aksesi në procedurë
2013	200,000	Brent/1.65 $bbl + K	Bashkim i operatorëve "TPD-Trading Petrol & Drilling (NIPT L21807013N)" dhe "Interpetrol Ltd (NIPT L52013058A)"me K = 0.12 $/bbl	Evropetrol Durres Ltd	Ruajtur në arkivën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë
2013	30,000	Brent/1.65 $bbl + K ekuivalen me Brent x 60.61% $bbl + K	Liona Sh.a. (NUIS L31731005C) me K = 0.1 $/bbl	Nuk ka aplikantë të tjerë	Ruajtur në arkivën e Albpetrol
2015	100,000	Brent x 72.52% - 5.55 $/bbl + K	TPD-Trading Petrol & Drilling (NIPT L21807013N) me K = 0.1 $/bbl	Nuk ka aplikantë të tjerë	http://www.albpetrol.al/njoftim-ankandi-per-shitjen-e-naftes-brut-sasia-100-000-ton/

Albpetrol organizoi dy ankande në vitin 2013 për sasitë 200,000 ton dhe 30,000 ton për shitjen e natës bruto për vitin 2013 dhe 2014. Në zbatim të kontratave të naftës alokuar në vitin 2013 dhe mbartjes nga vitet e kaluara, Albpetrol raportoi shitjen e:

- 127,741 ton naftë bruto në vitin 2013 me 56.3 milion USD, me një çmim mesatar shitje prej 441 USD për ton, dhe
- 127,659 ton naftë bruto në vitin 2014 me 50.6 milion USD, me një çmim mesatar shitje prej 396 USD për ton.

Çmimet mesatare vjetore të shitjeve zbatuar nga Bankers Petroleum[19] për vitet 2013 dhe 2014 ishin respektivisht 13% dhe 20% më të larta se çmimet mesatare vjetore të Albpetrol për këto vite.

Grafiku 11 - Shitjet e naftës nga Albpetrol për vitet 2013-2014



Burimi: Raportuar nga Albpetrol

TPD Trading Petrol & Drilling Sh.a. (TPD) ishte blerësi kryesor i naftës së papërpunuar të Albpetrol. TPD operon përmes një marrëveshje bashkëpunimi me ARMOn për rafinerinë e naftës në Fier zotëruar nga ARMO (shiko seksionin 2.2.8).

Detajet e sasive dhe vlerave mujore të shitjes për çdo blerës të kontratuar në vitin 2013 dhe 2014 paraqiten në Shtojcën 6.

[19] Çmimi mesatar i zbatuar nga Bankers Petroleum për vitet 2013 dhe 2014 u përftua nga pjestimi i të ardhurave nga pasqyrat financiare të Shoqërisë në adresën e saj www.bankerspetroleum.com, me sasinë e shitur të raportua nga AKBN për përpilimin e këtij raporti.

Treguesit kryesorë të performancës së Albpetrol (2011-2014)[20]

Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat e përftuara nga pasqyrat financiare vjetore të Albpetrol dhe pagesat në Lek për buxhetin e Shtetit raportuar nga Albpetrol për rakordimin EITI për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

Tabla 9 – Të dhënat kryesore financiare të Albpetrol

	2011	2012	2013	2014
Treguesit kryesorë të performancës				
Të ardhurat operative neto *në milion Lek*	9,385	8,035	10,405	8,371
Fitimi para tatimit (FPT) *në milion Lek*	3,906	1,430	1,457	1,423
Marzhi i FPT	41.6%	17.8%	14.0%	17.0%
Kthimi mbi kapitalin (FPT/Kapital)	6.3%	2.4%	2.5%	2.4%
Kthimi mbi mjetet (FPT/Totali i mjeteve)	5.4%	2.0%	2.0%	2.0%
Nafta e disponueshme në '000 ton	**176.6**	**156.9**	**144.0**	**149.6**
Prodhimi vendas	34%	29%	26%	30%
PPE e mbledhur në natyrë	62%	65%	66%	61%
ASP e mbledhur në natyrë	4%	6%	8%	9%
Pagesat për Buxhetin e Shtetit në milion Lek	**809.0**	**1,892.1**	**1,562.0**	**2,072.9**
Renta minerare	415.4	977.6	621.0	829.3
Tatimi mbi fitimin dhe gjobat e lidhura	230.6	561.2	850.1	445.0
Divident i paguar (përfshirë tatimin mbi burim)	163.1	353.2	90.9	798.7
Pagesat në Lek në % ndaj të ardhurave neto	**9%**	**24%**	**15%**	**25%**
Të dhënat e punonjësve				
Kosto e personelit *në milionë Lek*	2,558	2,232	2,197	2,064
Numri i punonjësve	4,010	3,072	2,936	2,062

Burimi: Raportuar nga Albpetrol[20]

Të dhënat financiare të Albpetrol tregojnë një marzh të kënaqshëm fitimi. Të ardhurat operative neto gjatë katër viteve të fundit variojnë nga 8 në 10 miliardë Lek. Këto të ardhura vijnë kryesisht nga shitjet e naftës së disponueshme. Albpetrol nxjerr naftë nga puset e veta si dhe përfton naftë nga PSA-të për zonat që janë pjesë e Marrëveshjes Albpetrol. Prodhimi i Albpertol përbën rreth 26-34% të totalit të naftës në dispozicion të Shoqërisë. Albpetrol e përfton naftën kryesisht përmes pjesës nga prodhimi i naftës nga PSA-të.

Shpenzimet e personelit përbëjnë komponentin kryesor të kostove. Gjatë periudhës 2011-2014 kostot e personelit u zvogëluan me -19%, me normë të përbërë vjetore prej -5%. Në të njëjtën periudhë, numri i punonjësve u zvogëlua me -49%, me normë të përbërë vjetore prej -15%.

Këto ndryshime rrjedhin kryesisht nga procesi i ristrukturimit të Albpetrol dhe nën-licensimi i operacioneve naftë-nxjerrëse të Albpetrol. Albpetrol i ka kaluar përafërsisht 1,400 puse aktive shoqërive private që kanë marrëveshje hidrokarbure me të. Sipas praktikës së Albpetrol, punonjësit që mirëmbajnë dhe operojnë puset largohen kur këto i kalohen shoqërive private të naftës sipas PSA-ve në fuqi. Kushtet e PSA-ve kërkojnë që operatori të mbajë dhe kompesojë punonjësit e çdo pusi të marrë për një periudhë minimale prej gjashtë muajsh. Në përfundim të kësaj periudhe operatori mund të punësojë personel aq sa të jetë e nevojshme. PSA-të sygjerojnë por nuk detyrojnë operatorët të punësojnë personel që ka eksperiencë të mëparshme pune në puset e transferuara nga Albpetrol.

Albpetrol nuk mundi të sigurojë statistika në lidhje me numrin e punonjësve të larguar nga Albpetrol si pjesë e ristrukturimit dhe dorëzimit të puseve, punësuar nga operatorët PSA.

[20] Informacioni financiar rrjedh nga pasqyrat financiare vjetore të audituara të Albpetrol për vitet fiskale 2012, 2013 dhe 2014. Këto pasqyra financiare nuk janë në dispozicion për përdorim nga palët e treta. Albpetrol e ka ndarë këtë informacion me ne për qëllim të këtij raporti.

Tabela 6- Puset e naftës adminstruar nga Albpetrol në 31 dhjetor 2014

	Puset aktive	Puset jo-aktive
Patos	24	4
Kucove	890	170
Ballsh	78	2
Karbunare	1	168
Total	**993**	**344**

Në fund të vitit 2014 Albpetrol kishte nën administrim rreth 993 puse aktive dhe 344 puse jo aktive, të vendosura kryesisht në zonat e naftës në Kuçovë *(890 aktive dhe 170 jo aktive)*, Karbunarë, Ballsh dhe Patos, siç paraqitet në tabelën 6. Albpetrol raportoi se nuk ka nën-licensuar puse gjatë vitit 2015. **Pagesat në Lek për rentën minerare, tatimin mbi fitimin dhe dividentët** derdhur në Buxhetin e Shtetit variojnë nga 9% deri në 25% të të ardhurave operative neto paguar nga nafta.

Burimi: Raportuar nga Albpetrol

Privatizimi i pritshëm i Albpetrol

Me anë të ligjit nr. 10490, datë 15 dhjetor 2011, Kuvendi i Shqipërisë vendosi për privatizimin e Albpetrol. Ky ligj vendosi që të drejtat e kërkimit dhe prodhimit dhënë Albpetrol Sh.a. si i licensuar parësor të bëhen subjekt i kushteve të përcaktuara nga Ligji për hidrokarburet, për operatorët ekonomikë të naftës dhe të gazit dhe do të hyjnë në fuqi që prej datës së privatizimit.

Në vijim të këtij vendimi në prill të vitit 2012, Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë i kaloji Albpetrol-it bloqet e reja të kërkimit në zonën e Delvinës, Panajës, Velçës, Dumresë, 1, 4, 5, 6, 7 dhe 8 si edhe në bllokun e Adriatik 2, 3 dhe 4, dhe bllokun e Rodonit të Veriut)[21] (paraqitur në figurën 4). Në Prill 2014, Këshilli i Ministrave vendosi[22] t'ja kalojë përsëri Ministrisë bloqet e lira të kërkimit të Dumresë, Panajasë, 1, 4, 5, 6, 8 dhe bllokun C, të zotëruara nga Albpetrol deri në atë datë.

Shtrirja e të drejtave dhe mjetet e zotëruara nga Albpetrol që do të jenë pjesë e privatizimit nuk janë përcaktuar ende në datën e këtij raporti.

2.2.3 Të ardhurat e gjeneruara nga AKBN në sektorin e naftës dhe gazit

AKBN punëson dhe zhvillon ekspertizë teknike në sektorin e naftës dhe gazit në mbështetje të rolit të saj për negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure, oponencën teknike të projekteve të hidrokarbureve dhe monitorimin e zbatimit të këtyre projekteve etj. (shiko gjithashtu seksionin 2.1.2). AKBN përfaqëson Shtetin në të gjitha marrëveshjet hidrokarbureve për bllokët dhe venburimet e tjera dhe përfton bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit që rrjedhin nga PSA-të. Kur këto PSA do të hyjnë në fazën e prodhimit, AKBN do të përfitojë gjithashtu pjesë nga ndarja e prodhimit të naftës sipas PSA-ve. Të ardhurat e gjeneruara nga AKBN gjatë viteve 2011-2014 nëpërmjet PSA-ve paraqiten në Grafikun 12.

Gjatë periudhës 2011-2013, AKBN përftoi të ardhura nga PSA-të kryesisht nëpërmjet mbledhjes së bonuseve. Të ardhura të tjera në vitin 2014, kanë të bëjnë me ekzekutimin e garancisë prej përfundimit të PSA-ve në zonat A, B, D dhe E (shih gjithashtu 2.2.5). Asnjë nga PSA-të dhënë për zonat e administruara nga AKBN nuk ka hyrë në fazën e prodhimit, prandaj AKBN nuk ka përftuar të ardhura nga nxjerrja e naftës në këtë periudhë. Lista e PSA-ve të nënshkruara për bllokët e naftës nën administrimin e AKBN-së është paraqitur në Shtojcën 5.

Grafiku 12 - Të ardhurat e AKBN-së nga PSA-të (2011-2014)



Burimi: Raportuar nga AKBN për rakordimin EITI 2011-2014

[21] Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) 279, datë 12 prill 2012 "Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, bashkësisë ekonomike të naftës dhe gazit (sot shoqëria "Albpetrol", sh.a.)"

[22] VKM nr. 335, date 22 Prill 2015 - Për disa ndryshime në vendimin nr. 279, datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave,

2.2.4 Procesi i dhënies së licensave

Industria e hidrokarbureve njeh dy sisteme kryesore për dhënien e kontratave: **oferta konkuruese**, ku shoqëritë konkurojnë me njëra-tjetrën për të ofruar kushtet më të mira në lidhje me një ose më shumë variabla të caktuara, dhe **negociatat ad hoc**, ku investitorët vijnë me një projekt-propozim të pakërkuar dhe negociojnë kushtet. Sistemi i përdorur varet nga gjendja e sektorit të hidrokarbureve. Negociatat ad hoc, përgjithësisht zbatohen në rastet kur të dhënat gjeologjike mungojnë, fushat e naftës nuk janë zbuluar apo në rastin e zonave të vështira për tu arritur.

Marrëveshjet e hidrokarbureve në Shqipëri janë negociuar në përputhje me "Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licensë-marrëveshjeve dhe afatet përkatëse", miratuar nga Ministri përgjegjës për energjinë në vitin 2006 ("Rregullorja për miratimin e hidrokarbureve dhe licensë-marrëveshjeve"). Albpetrol përmbledh kushtet kryesore të kësaj marrëveshjeje në faqen e saj, në adresën e mëposhtme: http://www.albpetrol.al/en/legal-basis/. Kjo rregullore përmban hapat e parashikuara dhe afatin kohor për vlerësimin e propozimeve të pakërkuara megjithatë nuk parashikon raste të ofertave konkurruese deri në ndryshimet e fundit që hynë në fuqi në Maj 2015.

Bazuar në rregulloren në fuqi deri në 2014 MEI, AKBN dhe Albpetrol paraqitën zonat të lira të naftës dhe gazit në faqet e tyre të internetit.

Procesi i vlerësimit të propozimeve të pakërkuara bazuar në rregulloren në fuqi deri në fund të vitit 2014

Hapi 1 - Paraqitja e aplikimeve

Shoqëritë private të naftës paraqesin aplikimet dhe letrat e tyre të interesit përkatësisht tek AKBN për zonat e administruara nga AKBN dhe tek Albpetrol për zonat e administruara nga Albpetrol. AKBN dhe Albpetrol paraqesin praktikën e punës pranë MEI-t për të marrë miratimin për fillimin e negociatave.

Hapi 2 – Fillimi i negociatave

Pas miratimit të MEI-t, AKBN dhe Albpetrol fillojnë negocimin e termave kryesorë dhe kushteve të marrëveshjes me Shoqëritë e interesuara të naftës. Kushtet e negociuara të nënshkruara nga të gjithë palët e interesuara paraqiten për miratim tek MEI.

Hapi 3 – Aprovimi i termave dhe kushteve kryesore të PSA-ve

Pas miratimit të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes, AKBN dhe Albpetrol fillojnë negociatat me shoqëritë e interesuara të naftës dhe përgatisin draftin e Marrëveshjes Hidrokarbure. Draft marrëveshja e nënshkruar dhe e konfirmuar nga të gjitha palët dërgohet për miratim në MEI.

Hapi 4 – Oponenca teknike

MEI mund të kërkojë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë të kryhet një rishikim teknik i termave kur konsiderohet e nevojshme. Ndryshimet e sugjeruara nga rishikimi teknik përfshihen si pjesë e negociatave përfundimtare.

Hapi 5 – Nënshkrimi i PSA-ve

Për rastet e zonave të administruara nga AKBN draft-marrëveshja e ri-negociuar miratohet dhe nënshkruhet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe përfaqësues të shoqërisë së naftës. Për rastet e zonave të administruara nga Albpetrol draft-marrëveshja e ri-negociuar miratohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe nënshkruhet nga Albpetrol dhe përfaqësuesit e Shoqërisë së naftës.

Hapi 6 – PSA miratohet nga Këshilli i Ministrave

Marrëveshja e firmosur miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëveshja e licensimit të Albpetrol

Albpetrol dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë firmosin një Licensë-Marrëveshje ku reflektohen termat dhe kushtet e Marrëveshjes së miratuar për hidrokarburet për zonat e administruara nga Albpetrol. Marrëveshja e licensimit negociohet njëkohësisht me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe firmoset brenda 10 ditëve pas miratimit perfundimtar të Marrëveshjes së Hidrokarbureve.

Rregullorja e vjetër thjesht përcakton hapat dhe palët e përfshira, gjithsesi nuk ofron udhëzime për kushtet që do të negociohen dhe se si të procedohet kur dy ose më shumë aplikantë paraqesin propozimet e tyre të pakërkuara për të njëjtën zonë.

Ndryshimet në rregullore në Maj 2015

Në Maj 2015 Ministri i Energjisë dhe Industrisë miratoi disa ndryshime në Rregulloren për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure dhe licensë-marrëveshjes[23]. Në bazë të këtyre ndryshimeve MEI dhe AKBN publikojnë në faqet e internetit hartën e zonave të lira të naftës dhe gazit dhe përcaktojnë një afat kohor për dorëzimin e aplikimeve.

Ndryshime të mëtejshme sqarojnë procedurat që duhet të ndiqen në rastin e një aplikanti të vetëm dhe kur dy ose më shumë subjekte dorëzojnë aplikimet e tyre të ndara nga njëri-tjetri.

Në rastin e një aplikimi të vetëm, AKBN ose Albpetrol do të vazhdojë me hapat e rregullores siç është përshkruar më herët në këtë seksion. Kur dy ose më shumë subjekte paraqesin kërkesat e tyre për të njëjtën zonë nafte, AKBN apo Albpetrol i dërgon MEI-t dokumentat e shoqërive që aplikojnë, vlerësimin në bazë të kapacitetit teknik dhe financiar dhe termat dhe kushtet kryesore të të hidrokarbure. Nëse propozimi miratohet nga MEI, AKBN apo Albpetrol mund të fillojnë negociatat me shoqërinë e përzgjedhur. Me urdhër të Ministrit, përfaqësues të MEI dhe jashtë saj do të emërohen pjesë e grupit negociues. Procesverbalet e mbledhjeve do të mbahen gjatë procesit të negociatave.

Ndryshime të tjera të rëndësishme për alokimin e marrëveshjeve hidrokarbure

MEI ka hartuar një rregullore të re për kërkimin dhe nxjerrjen e hidrokarbureve në Shqipëri, e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave në fund të vitit 2015. Kjo rregullore e re do të sjellë përmirësime të dukshme në drejtim të transparencës për alokimin e zonave të kërkimit dhe fushave të naftës.

Në vijim MEI, AKBN apo Albpetrol do të publikojnë në faqen e tyre dhe në gazeta ekonomike ndërkombëtare të gjitha procedurat e aplikimit për zona e reja të kërkimit dhe fushat e naftës. Procedurat e aplikimit duhet të përfshijnë detaje si:

- Hapat dhe forma e aplikimit
- Kriteret e vlerësimit
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit aplikant
- Periudha e aplikimit (në çdo rast jo më pak se 90 ditë nga shpallja e procedurës); etj

Kriteri kryesor për vlerësimin e aplikimeve do të jetë **kapaciteti teknik**, duke përfshirë njohuritë e disponueshme, teknologjinë, personelin, dhe përvojat e mëparshme, **kapaciteti financiar** dhe burimet e financimit në dispozicion, **termat financiarë dhe planin e propozuar të punës** dhe çdo **aspekt tjetër në interes të publikut**. Aplikimet do të refuzohen nëse, planet për kërkimin dhe prodhimin nuk do të garantojnë një veprimtari efiçente dhe sistematike të kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve.

MEI është në proces përpilimi të një kontrate model PSA, e cila do të shërbejë si bazë për ofertat dhe skualifikimet duke filluar nga viti 2016.

[23] Urdhri nr. 121, datë 8 Maj 2015 i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për miratimin e procedurave të marrëveshjeve të hidrokarbureve dhe marreveshjeve të licensimit dhe afatet përkatëse”

2.2.5 Situata e licensimit në vitin 2013 dhe 2014

Marreveshjet e mëposhtme të hidrokarbureve ishin në **fazën e prodhimit** gjatë vitit 2013 dhe 2014:

Tabela 7 – Të licensuarit në fazën e prodhimit [24]

Aksionarët	Shoqëria e licensuar	Data e marrëveshjes hidrokarbure	Zona e operimit (tokësore)	Faqja e internetit
Bankers Petroleum Ltd.	Bankers Petroleum Albania Ltd	Korrik 2004	▪ Patos-Marinza,	www.bankerspetroleum.com
	Sherwood International Petroleum Ltd	Shtator 2007	▪ Kuçova	www.bankerspetroleum.com
Stream Oil & Gas Ltd.	Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd ***(Now Transatlantic Petroleum Ltd)***	Gusht 2007	▪ Gorisht-Kocul, ▪ Cakran-Mollaj, ▪ Ballsh-Hekal ▪ Delvina	www.streamoilandgas.com; www.transatlanticpetroleum.com
Transoilgroup AG	Transoil Group -Dega ne Shqipëri	Shkurt 2012	▪ Visoka	www.transoilgroup.com
Isuf Berberi – 55% Naim Kasa – 25% Frank Jurgen Weise - 20%	PHOENIX PETROLEUM GAS Sh.a	Gusht 2013	▪ Amonice, ▪ Pekish-Murriz, ▪ Frakulle Gaz, ▪ Panaja, ▪ Povelce, ▪ Divjake, ▪ Ballaj-Kryevidh, ▪ Finiq-Karne, and ▪ Drashovice	n/a

Të gjitha marrëveshjet hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit të paraqitura më lart, administrohen nga Albpetrol, në cilësinë të licensuarit parësor në këto zona. Prandaj, Albpetrol ka përftuar pjesë nga prodhimi i naftës sipas këtyre marrëveshjeve. Deri në fund të vitit 2013**, Albpetrol ka nën-licensuar aktivitetet për zhvillimin dhe prodhimin e naftës në të gjitha vendburimet e zbuluara të naftës**.

Në shtator të vitit 2014 Transatlantik Petroleum Ltd bleu operacionet e Stream Oil & Gas në Shqipëri për një vlerë prej 41.2 milion USD (www.transatlanticpetroleum.com). MEI miratoi transaksionin dhe lejoi Transatlantic Petroleum të vazhdojë me operimin e PSA-së së dhënë më herët për Stream Oil & Gas.

Marrëveshjet hidrokarbure si më poshtë ishin në **fazën e kërkimit** gjatë vitit 2013 dhe 2014:

Tabela 8 – Të liçencuarit në fazën e kërkimit[21]

Aksionarët	Shoqëria e licensuar	Data e marrëveshjes hidrokarbure	Zona e operimit	Faqja e internetit
Bankers Petroleum Ltd.	Bankers Petroleum Albania Ltd	Nëntor 2010	▪ Block F onshore	www.bankerspetroleum.com
Petromanas Energy Inc.	Petromanas Albania GmbH.	December 2007	▪ Blocks A, B, D, E, onshore;	www.petromanas.com
Royal Dutch Shell plc & Petromanas Energy Inc.	Royal Dutch Shell plc & Petromanas Albania GmbH.	July 2009	▪ Blocks, 2, 3, onshore	www.royaldutchshellplc.com www.petromanas.com
San Leon Energy plc	San Leon Durresi B.V.	Aug-2007	▪ Durres block, offshore,	www.sanleonenergy.com
Cairn Energy PLC	Capricorn Albania Limited	September 2007	▪ Joni 5 block offshore	www.cairnenergy.com
The Israel Land Development Shoqëria Ltd	Emanuelle Adriatic Energy Ltd	Gusht 2004	▪ Offshore blocks Adriatic 2, 3 dhe 4	http://en.ildc.co.il/

Petromans ndërpreu PSA-të për zonat A, B, D dhe E në vitin 2014. Në bazë të përfundimit të kontratës AKBN ekzekutoi garancinë e mbajtur në shumën prej 6 milionë euro[25]. **Pothuajse të gjitha PSA-të e nënshkruara deri në fund të vitit 2014, u ndanë nëpërmjet negociatave add hoc. Termat kryesore teknike dhe financiare të negociuara nuk janë publikuar.**

[24] Lista e të liçencuarve për Hidrokarburet paraqitet dhe përditësohet në faqen e internetit të MEI – www.energjia.gov.al dhe AKBN – www.akbna.gov.al.
[25] Informacion i raportuar nga AKBN për qëllim të këtij raporti.

Situata aktuale e licensimit dhe zonat e lira të kërkimit në Tetor 2015–*publikuar në www.energjia.gov.al*

Tabela 9 si më poshtë liston të gjitha zonat e kërkimit të naftës dhe gazit në territoret tokësore dhe detare të Shqipërisë në Tetor 2015, duke treguar situatën aktuale të licensimit dhe zonat e lira për kërkim.

Tabla 9 – Lista e zonave të kërkimit

Nr.	Vendn-dodhja	Blloku	Aktualisht operuar nga/ I lirë	Zona administruar nga
1	Në det	Blloku Rodoni N& S	I lirë	AKBN
2	Në det	Blloku Adriatiku 2	Emanuelle Energy	Albpetrol
3	Në det	Blloku Adriatiku 3	Emanuelle Energy	Albpetrol
4	Në det	Blloku Adriatiku 4	Emanuelle Energy	Albpetrol
5	Në det	Blloku Joni 5	Capricorn Albania	AKBN
6	Në tokë	Blloku 1	I lirë	AKBNl
7	Në tokë	Blloku 2	Petromanas & Shell	AKBN
8	Në tokë	Blloku 3	Petromanas & Shell	AKBN
9	Në tokë	Blloku 4	**Në negocim (*)**	AKBN
10	Në tokë	Blloku 5	I lirë	AKBN
11	Në tokë	Blloku 6	I lirë	AKBN
12	Në tokë	Blloku 7	I lirë	AKBN
13	Në tokë	Blloku 8	I lirë	AKBN
14	Në tokë	Blloku A	I lirë	AKBN
15	Në tokë	Blloku B	I lirë	AKBN
16	Në tokë	Blloku C	I lirë	AKBN
17	Në tokë	Blloku D	I lirë	AKBN
18	Në tokë	Blloku E	I lirë	AKBN
19	Në tokë	Blloku F	Bankers Petroleum	AKBN
20	Në tokë	Blloku Dumre	**Në negocim (*)**	AKBN
21	Në tokë	Blloku Panaja	I lirë	AKBN
22	Në tokë	Blloku Velça	I lirë	Albpetrol
23	Në tokë	Blloku Delvina	Transatlantic Albania	AKBN

Burimi: MEI – www.ernergjia.gov.al

(*) Në vitin 2015, MEI i dha zonat e kërkimit të Dumrese dhe bllokun 4, përkatësisht bashkimit të operatorëve Petromanas & Shell dhe Navitas, pjesë e Delek Group. Shoqëritë u përzgjodhën përmes një procesi konkurrues. PSA-të janë në negocim në datën e përfundimit të këtij raporti.

Figura 4 – Situata e zonave të kërkimit në Tetor 2015



Burimi: MEI – www.ernergjia.gov.al

2.2.6 Aktiviteti i naftës dhe gazit 2011-2014

Grafiku 13 – Historiku i prodhimit të naftës në tonë nga Albpetrol dhe sektori privat



Burimi: MEI - www.energjia.gov.al

Grafiku 14- Prodhimi i naftes dhe gazit 2013 dhe 2014



Burimi: Raportuar nga AKBN[26]

Prodhimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1929 me 750 tonë naftë bruto. Pas luftës së II-të botërore, prodhimi u rrit në mënyrë të vazhdueshme dhe shënoi pikun më të lartë në vitin 1974 me një prodhim vjetor prej 2.25 milionë ton i barazvlefshëm me 38,408 fuçi/ditë). Në vitet '80 prodhimi i naftës ra nën 1 milionë ton në vit dhe nuk u rrit më deri në vitin 2012.

Grafiku në të majtë paraqet trendin e prodhimit të naftës nga viti 1993 deri në 2014. Prodhimi i naftës përmes marrëveshjeve të hidrokarbureve u rrit 3 herë në pesë vitet e fundit.

AKBN[26] raportoi një prodhim të naftës së papërpunuar respektivisht 1,203,637 ton për vitin 2013 dhe 1,386,124 ton për vitin 2014.

Vlera totale e prodhimit përllogaritet në 530 milionë USD në vitin 2013 dhe 549 milionë USD në vitin 2014. Vlera e prodhimit është përllogaritur duke përdorur çmimet mesatare vjetore të shitjeve raportuar nga Albpetrol respektivisht 441 USD / ton në vitin 2013 dhe 396 USD / ton në vitin 2014.

Nafta e prodhuar nga të licensuarit private që operojnë në sektorin e hidrokarburave përfaqëson rreth 97% të totalit të naftës së prodhuar në vitin 2013 dhe 2014.

Rreth 88% e prodhimit vendas të naftës në 2013 dhe 87% në 2014 u gjenerua nga Bankers Petroleum që operon fushën e naftës në Patos-Marinzë.

AKBN[23] raportoi në vitin 2013 dhe 2014 prodhimin e gazit të nxjerrë përmes prodhimit të naftës, respektivisht në 22.5 milion Nm3, dhe 17.7 milionë Nm^3.

[26] Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga AKBN për këtë raport.

2.2.7 Punësimi në sektorin e naftës dhe gazit

MEI raporton se në vitet '70 dhe '80 kur sektori i kërkimit, prodhimit dhe përpunimit të hidrokarbureve ishte krejtësisht i zotëruar dhe administruar nga Shteti, punësonte rreth 25,000 punonjës.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga Albpetrol dhe AKBN, në fund të vitit 2014 sektorët e kërkimit dhe përpunimit të hidrokarbureve kishin të punësuar rreth **3,109**[27] punonjës, ku Albpetrol përfaqësonte numrin më të lartë të punonjësve me 66%[28].

Grafiku 15 - Punesimi dhe prodhimi ne sektorin e naftes



Burimi: Raportuar nga AKBN[28] dhe Albpetrol[29]

Numri i punonjësve në sektor u zvogëlua me 38% gjatë katër viteve të fundit. Këto ndryshime rrodhën si pasojë e transferimit të operacioneve të prodhimit nga Albpetrol tek shoqëritë private të naftës në përputhje me PSA-të në fuqi (shiko gjithashtu seksionin 2.2.2). Vihet re se sektori privat, nuk arriti të përthithë fuqinë punëtore të larguar nga puna gjatë këtyre transferimeve.

Grafiku 16: Punesimi ne sektorin e naftes 2011 - 2014



Burimi: Raportuar nga AKBN[28] dhe Albpetrol[29]

[27] AKBN raportoi për qëllime të analizave të këtij Raporti informacion për numrin e punonjësve të punësuar tek shoqëritë private që operonin në industrinë nxjerrëse në Shqipëri.
[28] Albpetrol AKBN raportoi për qëllime të analizave të këtij Raporti informacion për numrin e punonjësve të punësuar tek Albpetrolit në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

2.2.8 Përdorimi i naftës Shqiptare të papërpunuar

Nafta e prodhuar në vend eksportohet kryesisht për tu përpunuar jashtë vendit[29]. Konsumi i brendshëm përmbushet nga nafta e importit. Bazuar në të dhënat nga Administrata Doganore Shqiptare (tabela 10), eksporti i naftës rezulton të jetë rrthe 104% e naftës së prodhuar në vend në vitin 2013. Ky raport ka rënë në 77% të naftës së prodhuar në vitin 2014, kur nafta bruto e përpunuar përmes rafinerive vendase arriti në 22%.

Plotësimi i nevojave për naftë në vend

Nafta e papërpunuar e prodhuar në vend përfaqësonte 76% të kërkesave të brëndshme matur në naftë bruto në vitin 2011. Pas rritjes së veprimtarisë së të licensuarëve private në këtë sektor, prodhimi i naftës u rrit në mënyrë të qëndrueshme me rreth 12% në vit deri në fund të vitit 2014. Në vitin 2013, prodhimi i naftës së papërpunuar barazoi në masën 98% konsumin e brendshëm matur në nafte dhe e tejkaloi atë me rreth 108% në vitin 2014. Bazuar në këto të dhëna, mund të supozohet se nëse totali i naftës së papërpunuar të prodhuar në vend do të përpunohej në Shqipëri, prodhimi vendas do ishte shumë afër përmbushjes së kërkesave për konsum të brendshëm.

Tabla 10 – Pavarësia ndaj naftës së importit (2011 – 2014)

në ktoe

Viti	Prodhimi i brendshëm i naftës së papërpunuar	Eksportet e naftës së papërpunuar	Eksporti ndaj prodhimi	Konsumi i brendshëm i naftës së papërpunuar[30]	Prodhimi ndaj konsumit	Përpunimi i brendshëm i naftës së papërpunuar[31]	Përpunimi ndaj prodhimit
2011	895	697	78%	(1,172)	76%	209	23%
2012	1,029	1,001	97%	(1,044)	99%	107	10%
2013	1,206	1,252	104%	(1,235)	98%	62	5%
2014	1,386	1,069	77%	(1,287)	108%	300	22%

Burimi: INSTAT – Pavarësia energjetike kombëtare – www.insta. gov.al dhe MEI – www.enegjia.gov.al

Grafiku 17 - Eksportet e naftes bruto 2011-2014



Eksporti i naftës së papërpunuar

Në vitin 2013 dhe 2014, eksporti i naftës së papërpunuar ishte respektivisht **69.5 miliard Lek** dhe **55 miliard Lek** të cilat përbënin rreth **28%** dhe **22%** të totalit të eksporteve për secilin vit. Eksportet e naftës u rritën në mënyrë të qëndrueshme me një normë vjetore prej 30% nga viti 2011 në 2013, më pas u ulën me 20% në 2014 si pasojë e rritjes së aktivitetit të përpunimit të naftës brenda vendit.

Gjatë katër viteve të fundit nafta u eksportua kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore ku Italia shfaqet si importuesi kryesor i naftës, ndjekur nga Spanja dhe Malta.

Burimi: Raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare[29]

Përpunimi i naftës

("ARMO") është Shoqëria e vetme e përpunimit të naftës që operon në Shqipëri. Ajo u themelua si rrjedhojë e ndarjes së shoqërisë së naftës së zotëruar nga Shteti Albpetrol Sh.a. në prill të vitit 1999. Në gusht 2008, qeveria shqiptare privatizoi 85% të aksioneve të ARMO-s tek Anika Mercuria

[29] Administrata Doganore Shqiptare e raportoji informacion për eksportet e naftës brut në periudhën 2011-2014 për qëllime të analizave në këtë raport.
30 Kjo është një matje në termat e naftës brut dhe përfshin naftën e rafinuar të konsumuar brenda vendit dhe naftën bruto të rafinuar në Shqipëri.
[31] Burimi: http://www.energjia.gov.al/al/publikime/nafta/perpunimi-i-naftes

Rafinery Associated Oil ("AMRA Oil"). Në gusht 2013, Heaney Asset Corporation bleu 80% të aksioneve të AMRA Oil, duke kontrolluar kështu 68% të interesave tek ARMO.

Deri në Maj 2014, ARMO operonte me dy rafineri nafte përkatësisht në Ballsh dhe Fier, tre pika të shitjes me shumicë, objekte kërkimi, dhe terminal import/eksporti me një kapacitet total depozitues prej 220,000 metër kub. Rafineritë janë ndërtuar në vitet '70 me teknologjinë e viteve '60.

Objektet kanë një kapacitet përpunimi prej 1.5 milion tonë në vit, megjithatë punojnë me kapacitet të ulët si pasojë e teknologjisë së vjetëruar. Ballshi është rafineria e vetme komplekse në vend e pajisur për të prodhuar nënprodukte të ndryshme të naftë. Në vitin 2013 dhe 2014, ARMO punësoi rreth 1,500 punonjës.

Sipas informacioneve publike, ARMO ka ndërprerë veprimtarinë e saj në rafinerinë e Ballshit që nga qershori i vitit 2015. Ndërsa TPD Trading Petrol & Drilling Sh.a. (TPD) vazhdon të administrojë rafinerinë e Fierit që prej vitit 2013 ndërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi me ARMO.

Transporti i naftës

Dy tubacione për transportin e naftës së papërpunuar lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të vjetërimit. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit[32].

Aktualisht, nafta bruto transportohet me çisterna nga fushat e naftës në portin e Vlorës, nga ku eksportohet për në Itali, Spanjë, Maltë etj.

Shoqëria La Petrolifera Italo-Albanese Sh.a. vepron në terminalin bregdetar për naftën, gazin e lëngshëm dhe derivatet e tjera të naftës në portin e Vlorës, si dhe mundëson magazinimin e naftës së papërpunuar gati për eksport në depozitat e saj në port. Shoqëria ofron një infrastrukturë që mund të mbajë më shumë se dy anije njëkohësisht. Asnjë shoqëri shtetërore nuk operon në këtë sektor.

Struktura të tjera të depozitimit të naftës dhe gazit

Fushat e naftës dhe gazit nga ku janë nxjerrë të gjitha ose një pjesë e rezervave, mund të përdoren si vende depozitimi për gazin natyror për shkak të kushteve të përshtatshme gjeologjike. Kriporet në Dumre janë gjithashtu shumë të përshtatshme për ruajtjen e gazit natyror gjatë verës. Këto avantazhe gjeologjike të kombinuara me pozicionin gjeopolitik, e bëjnë Shqipërinë një vend tërheqës për projektin e gazsjellësit.

2.2.9 Projekti Adriatic Pipeline (Projekti TAP)

Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG është një bashkim i disa shoqërive themeluar me qëllimin planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin e gazsjellësit natyror TAP.

TAP do të transportojë gaz natyror nga fusha Shah Deniz II në Azerbajxhan për në Evropë. Afërsisht 870 km tubacion do të lidhet me Gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP) pranë kufirit turko-grek në Kipoi, do kalojë Greqi, Shqipëri dhe detin Adriatik, e më pas do të lidhet me bregdetin e Italisë Jugore. Kështu, Shqipëria do të bëhet një vend tranzit qendror energjinë në Bashkimin Evropian. TAP pritet të nxisë zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës përgjatë rrugës së gazsjellësit, duke përfshirë Shqipërinë. Ky do të jetë një burim i madh i investimeve të huaja direkte që nuk varet nga grantet ose subvencionet. Operacionet e TAP pritet të fillojnë në vitin 2020.

Informacione të mëtejshme mbi projektin e TAP mund t'i gjeni në: http://www.tap-ag.al/ dhe www.energjia.gov.al.

Qeveria shqiptare është angazhuar plotësisht për të mbështur projektin TAP në të gjitha hapat e autorizimit dhe lejeve shtetërore. Në fund të vitit 2013 Këshilli i Ministrave themeloi Grupin ndër-institucional për koordinimin e punës në zbatimin e projektit TAP në Shqipëri (VKM nr. 1081 datë 18 dhjetor 2013). Marrveshja e Qeverisë për projektin TAP e aprovuar me ligjin nr 116/2013 në datën 15 Prill 2013 dhe marrveshje të tjera të lidhura mund të gjenden në faqen e MEI - www.energjia.gov.al. Sipas MEI-t, në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian për tranzitin e lirë të gazit, marrëveshja nuk parashikon tarifë për tranzitin e gazit.

Përveç përfitimeve të pritshme makroekonomike dhe përfitimeve nga aksesi në infrastrukturën e gazit, Shqipëria do të përfitojë gjithashtu 7 milion EUR për forcimin e kapaciteteve dhe kompensim për komunitetin përreth rrugëtimit të TAP në Shqipëri.

[32] Burimi: Emergency Oil Stocks in the Energy Community Level, Petroleum Development Consultant Limited, Energetski Institut Hrvoje Požar, prill 2011.

2.2.10. Të ardhurat e qeverisë nga sektori i naftës dhe gazit

Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe të ardhurave nga investimet direkte në sektor. Figura 4 më poshtë tregon shpërndarjen e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi i Shtetit Shqiptar në PSA administrohet nga Albpetrol dhe AKBN, të cilat marrin nga PSA-të: bonuse, pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera nga rrjedhin nga mos-zbatimi i termave të kontratave si gjoba dhe garanci të ekzekutuara.

Figura 5 – Ndarja e të ardhurave nga sektori i naftës dhe gazit



Për shkak të organizimit aktual të sektorit të naftës, të ardhurat kryesore që derdhen në buxhetin e Shtetit janë renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe të ardhurat e gjeneruara nga investimet e drejtpërdrejta në Albpetrol.

Renta Minerare

Renta minerare përllogaritet mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti i nxjerrjes, në bazë të ligjit "Për taksat kombëtare" nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar. Renta përbën zërin kryesor të të ardhurave që Shteti mbledh nga ky sektor. Renta minerare për eksportet mblidhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe renta minerare për shitjet brenda vendit mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sipas ligjit për taksat kombëtare, renta minerare nga shitja e naftës dhe gazit përllogaritet në masen 10% të vlerës së tatueshme.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin në sektorin hidrokarbur, i cili rregullohet nga Dekreti nr. 782 "Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", datë 22 dhjetor 1994 ("Ligji për tatimin e naftës") përllogaritet në masën 50% mbi fitimin e tatueshëm. Sipas këtij ligji, në përllogaritjen e fitimit të tatueshëm merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet operative dhe kapitale të akumuluara si përcaktohet në marrëveshjen e hidrokarbureve. Tatimi mbi fitimin zbatohet kur të ardhurat e mbledhura tejkalojnë shumën e kapitalit me shpenzimet operative të akumuluara që prej fillimit të operacioneve.

MEI njoftoi se duke filluar nga dhjetori 2015[33] (shih gjithashtu 2.2.1) modeli PSA do të ndryshoje me qëllim që Shoqëritë e naftës të paguajnë tatim mbi fitimin që në fillim të fazës së prodhimit. Përkatësiht, 10% e të ardhurave do të klasifikohen si fitim neto dhe tatohet me 50%.

[33] Adresa e internetit: http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=315023&ref=ngj. Informacion i konfirmuar nga Drejtori i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve pjesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Z. Dritan Spahiu.

Interesat e Qeverisë në industrinë nxjerrëse

Qeveria ka të drejtë të përfitojë dividentët dhe të ardhurat nga privatizimi i mundshëm i Albpetrol. Albpetrol është gjithashtu subjekt i tatimit dhe taksave të zbatueshme për shoqëritë tregtare si tatimi mbi fitimin, renta minerare, TVSH, etj.

Përveç shpërndarjes së dividentëve, nuk ka politika të tjera transferimi midis Shtetit dhe Albpetrol.

Grafiku 18 - Ndarja e të ardhurave nga sektori i naftës



Tabela 11 - Të ardhurat nga pagesat e drejtpërdrejta nga sektori i naftës dhe gazit

Ne milion Lek

	2013				2014			
	Albpetrol	AKBN	Buxheti i Shtetit	Total	Albpetrol	AKBN	Buxheti i Shtetit	Total
Ndarja e prodhimit të naftës	4,968	-	-	4,968	4,354	-	-	4,354
Bonuset	11	47	-	58	12	23	-	35
Të tjera	-	-	-	-		633	-	633
Renta minerare	-	-	8,302	8,302	-	-	7,820	7,820
Tatimi mbi fitimin	-	-	1,668	1,668	-	-	1,327	1,327
Dividentët	-	-	-	-	-	-	757	757
	4,979	47	9,970	14,996	4,367	656	9,904	14,926

Burimi: Pagesat e raportuara nga te licensuarit për rakorimin EITI ne vitet 2013 dhe 2014.

Të ardhurat nga pagesat e drejtpërdrejta të zbatueshme për sektorin

Të ardhurat e gjeneruara nga pagesat e drejtpërdrejta grupohen në bonuse, ndarja e prodhimit të naftës, renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe dividentët. Ato përllogariten në 15 miliard Lek në vitin 2013 dhe 14.9 miliard Lek në vitin 2014.

Këto pagesa përbëjnë rreth 27% të prodhimit të naftës së bruto në vitin 2013 dhe 26% ne vitin 2014. Buxheti i Shtetit arkëtoi rreth 67% të pagesave të drejtpërdrejta në vitin 2013 dhe 2014. **Të ardhurat e paguara nga sektori i naftës për nga rentën minerare, tatimin mbi fitimin dhe dividentët paguar nga Albpetrol, përbënin rreth 3% e të ardhurave totale ne Buxhetin e Shtetit në vitin 2013 dhe 2.7% në vitin 2014**. Pjesa e mbetur u mblodh nga Albpetrol, dhe një pjesë e vogël prej 0.5% ose më pak nga AKBN-së. Ndarja e të ardhurave përcaktohet nga pasha relative e të ardhurave kryesore nga renta minerare dhe ndarja e prodhimit të naftës në vitin 2013 dhe 2014

Panvarësihst rritjes së prodhimit të brendshëm të naftës së papërpunuar, të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës dhe renta minerare ranë me respektivisht 14% dhe 6% në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013. Kjo rënie lidhet me uljen në çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare, të cilat shërbejnë si bazë për përllogaritjen e të ardhurave nga ndarja e prodhimit të naftës dhe renta minerare, që janë zërat kryesorë të të ardhurave nga nafta.

Renta minerare përfaqëson zërin kryesor të të ardhurave të gjeneruara nga sektori i naftës me një peshë prej 55% të të ardhurave të drejtpërdrejta nga sektori i naftës në vitin 2013 dhe 52% në vitin 2014. Renta minerare njihet në Buxhetin e Shtetit, bazuar në ligjin për taksat kombëtare. Shteti duhet t'i transferojë një pjesë të rentës minerare pushtetit vendor, përkatësisht njësisë së qeverisjes vendore prodhuese që gjeneron rentën (shih seksionin 2.5).

Të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës përfaqësojnë zërin e dytë më të madh me rreth 33% të të ardhurave të drejtpërdrejta në vitin 2013 dhe 29% të të ardhurave të drejtpërdrejta në vitin 2014. Ndarja e prodhimit të naftës u mblodh tërësiht nga Albpetrol në këto vite. PSA-të e administruara nga AKBN nuk kanë hyrë në fazën e prodhimit deri në fund të vitit 2014. Të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës rrjedhin kryesisht nga prodhimi para-ekzistues zhvilluar nga Albpetrol. PPE përbën respektivisht 89% të pjesës së naftës të mbledhur nga Albpetrol në vitin 2013 dhe 87% në vitin 2014.

Tatimi mbi fitimin u mblodh vetëm nga Albpetrol në vitin 2013 dhe 2014. Ky zë pritet të rritet në vitet e ardhshme, kur shoqëritë private të fillojnë të gjenerojnë tatim mbi fitimin.

Taksa mbi fitimet kapitale si një tjetër formë e mundshme të tatimit

Shumë shoqëri të vogla dhe të mesme të naftës kanë interesa në operacionet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit në Shqipëri. Këto shoqëri gjenerojnë pjesë të rëndësishme të vlerës së tyre brenda vendit, sa që transferimi i aksioneve apo të drejtave për operacionet në Shqipëri të gjenerojnë fitimet kapitale. Shumica e këtyre transaksioneve ndodhin jashtë vendit. Ligji dhe rregulloret e taksave në fuqi nuk parashikojnë taksa të zbatueshme për transaksionet që kryhen jashtë vendit lidhur me interesa dhe prona në vend. MEI rishikin për miratim të gjitha transaksionet e licensave që operojnë në sektorin e naftës dhe të gazit.

Aktualisht, këto transferime nuk janë subjekt i tatimeve në Shqipëri, si ligji i taksave dhe rregullimet nuk parashikojnë zbatimin e taksave për transaksionet që ndodhin jashtë Shqipërisë lidhur me interesa dhe vlerën e gjeneruar në vend.

2.3 Sektori minerar dhe guror

2.3.1 Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi në sektorin minerar

Shqipëria ka një histori të gjatë në sektorin minerar me depozita të mëdha të mineraleve të kromit, nikelit, bakrit dhe gurit gëlqeror. Studimet gjeologjike të kryera në vitet 1945-1995, kanë zbuluar depozita të konsiderueshme të mineralit të kromit, ferronikelit, bakrit, bitumit, dhe minerale jo-metalore si gur gëlqeror dhe gurë dekorativë etj.

Zhvillimi i industrisë minerare në Shqipëri ka kaluar nëpër tri faza kryesore.

Faza e parë përfshin periudhën deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, e cila shënoi dy ngjarje të rëndësishme: përpilimin për herë të parë të Hartës Gjeologjike të Shqipërisë në 1922, dhe miratimin e Ligjit Minerar në vitin 1929.

Në fazën e dytë (1944 1994), aktiviteti i minierave u organizua në ndërmarrje shtetërore.

Faza e tretë përfshin periudhën nga viti 1994 deri më sot, kur sektori minerar u hap për privatizimin e operacioneve minerare, pas miratimit të Ligjit Minerar Shqiptar.

Si një vend tradicional minerar, Shqipëria ka një numër në rritje të Shoqërive të vogla dhe të mesme minerare dhe gurore dhe numëron vetëm disa Shoqëri të mëdha industriale minerare. Në nëntor 2015, AKBN raportoi 600 licensa në prodhimi, që vepronin kryesisht në rrethin e Bulqizës (112), Beratit (43), Krujës (39), Kukësit (39), Matit (36), Tropojës (32) dhe Librazhdit (42).

Ligjet dhe rregulloret që qeverisin sektorin minerar dhe guror

Sektori minerar në Shqipëri rregullohet nga Ligji nr. 10304 "Për sektorin e Minerar në Republikën e Shqipërisë", datë 15 korrik 2010 ("Ligji Minerar"), i cili hyri në fuqi në gusht të vitit 2010 dhe shfuqizoi Ligjin Minerar të mëparshëm nr. 7796, datë 17 shkurt 1994. Pavarësisht se ligji hyri në fuqi në vitin 2010, zbatimi i plote i tij filloi në mesin e vitit 2011, pas miratimit dhe publikimit të udhëzimeve shoqëruese. MEI dhe AKBN paraqesin një përmbledhje të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për sektorin minerar në faqet e tyre të internetit, përkatësisht www.akbn.gov.al dhe www.energjia.gov.al.

Ligji Minerar i grupon mineralet në katër kategoritë e mëposhtme:

- Metalet, jo-metalet, qymyri dhe bitumi;
- Mineralet që përdoren në ndërtim
- Mineralet të çmuara dhe gjysëm të çmuar;
- Mineralet radioaktive.

AKBN raporton se nuk ka asnjë licensë prodhimi të dhënë për metale dhe gurë të çmuar, gjysëm të çmuar dhe minerale radioaktivë.

Kushtet e licensës

Sipas Ligjit Minerar, afati fillestar për licensën në kërkim është 3 vjet, dhe mund të shtyhet më tej. Licensat për shfrytëzim jepen fillimisht për 25 vjet, afat që mund të shtyhen deri në 10 vite dhe kur projektet paraqesin interes me rëndësi ekonomike dhe sociale, licensat në shfrytëzim mund të zgjaten deri në 99 vite.

Licensa për shfrytëzim i jep të licensuarit të drejtën ekskluzive për zhvillimin e infrastrukturës, nxjerrjen dhe zotërimin e mineralit të prodhuar në zonën e licensuar. MEI mund të japë gjithashtu licensa për përpunimin e mbetjeve minerare. Strategjia minerar inkurajon të licensuarit të investojnë në impiante të përpunimit.

Ligji Minerar i vë në dispozicion të licensuarve një sipërfaqe toke jo më të madhe së 100 km^2 për licensat në kërkim dhe jo më shumë se 10 km^2 për licensat në prodhim. Bazuar në projektet e paraqitura, MEI mund t'i japë një shoqërie dy ose më shumë licensa. Sipërfaqet dhe vlerat minimale të investimit në USD sipas tipit të licensës dhe mineralit paraqiten në Rregulloren "Për përcaktimin e kritereve, të vlerës minimale të sipëfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare" miratuar me VKM nr. 364 në 4 maj 2011. Këto përcaktime variojnë nga tipi i mineralit.

Përkrah licensës, e cila jepet për një periudhë afatgjatë, në përputhje me ligjin No. 10081, datë 23 shkurt 2009 “Mbi licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të licensuarit pajisen me leje minerare për cdo vit të aktivitetit.

Kërkesat për rehabilitim mjedisor

Sipas Ligjit të ri Minerar (2010), të licensuarit në këtë sektor nuk janë të detyruar të paguajnë më taksën mbi sipërfaqen në shfrytëzim. Në vend të saj, ligji i ri paraqet konceptin e përfshirjes së planit të rehabilitimit mjedisor dhe të planit vjetor të punës dhe investimeve. Plani vjetor miratohet nga AKBN për licensat në shfrytëzim dhe nga SHGJSH për licensat në kërkim sipas kushteve të çdo license. Në vijim, të licensuarit depozitojnë çdo vit garanci financiare, në përputhje me planet vjetore të miratuara. Rregullat për depozitimin dhe kthimin e garancive financiare dhe vleravet minimale përcaktohen në Rregulloren e miratuar me VKM nr. 440, datë 16 qershor 2011, ndryshuar[34] dhe Urdhërin e Ministrit përgjegjës për energjinë nr. 718 datë 3 tetor 2011.

Depozita për garancinë financiare për investimet përcaktohet në një vlere jo më të vogël se 10% e planit vjetor të investimit. Garancia i kthehet e plotë të licensuarit nëse investimi kryhet i plotë dhe brënda afatit të përcaktuar. Nëse i licensuari realizon më pak se 90% të investimit, MEI mund të përvetësojë garancinë dhe të regjistrojë të ardhurat në buxhetin e saj.

Depozita për garancinë financiare për rehabilitimin e mjedisit përcaktohet në bazë të planit të miratuar të prodhimit vjetor. Këto depozita kthehen kur i licensuari rehabiliton zonën e dëmtuar në përputhje me planin. Në të kundërt, MEI mund të përvetësojë garancinë dhe të kontraktojë rehabilitimin e mjedisit në atë zonë.

Kushtet e detajuar të licensave dhe kocensioneve minerare janë konfidenciale dhe nuk janë të disponueshme për palët e treta.

Ndryshimet në Ligjin Minerar [35]

Në tetor 2014, Parlamenti Shqiptar miratoi disa ndryshime të Ligjit Minerar. Ndryshimet në ligj i japin AlbEITI-t të drejtë të kërkojë dhe të mbledh informacion për pagesat tatimore nga të licensuarit në këtë sektor, autoritetet tatimore e doganore dhe njësitë e qeverisjes vendore, si dhe ta publikojë këtë informacion në raportin EITI.

Për më tepër, ndryshimet në ligj vendosin kritere mbi marrëdhënien me të nënkontraktuarit, e cila është mjaft e përhapur në aktivitetin minerar. Këto ndryshime kërkojnë qartësisht që përzgjedhja e të nënkontraktuarëve për operacionet e kërkimit dhe / ose prodhimit të miratohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrise në përputhje me kushtet teknike dhe financiare.

Gjithashtu, ndryshimet ligjore parashikojnë edhe punësimin e stafit teknik për kohëzgjatjen e licensës së kërkimit dhe / ose prodhimit.

Dhënia e licensave

AKBN dhe SHGJSH mbështesin MEI-n në procedurat para dhe pas licensimit, përkatësisht AKBN për licensat e prodhimit dhe SHGJSH për licensat e kërkimit.

MEI i jep licensat minerare përmes **konkurrimit publik** për zonat minerare konkurruese dhe nëpërmjet **negociatave të rastit mbi: aplikimi i parë – shqyrtohet i pari për licensim** në zonat e hapura minerare. Zonat minerare konkurruese dhe të hapura përcaktohen në planit vjetor bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Procedurat konkurruese zbatohen aty ku rezervat gjeologjike paraqesin interes të rëndësishëm ekonomik;
2. Negociatat e rastit zakonisht zbatohen për zona me informacion të kufizuar mbi rezervat, ku të licensuarit prezantojnë një plan të zgjeruar që përfshin zonat fqinje me zonën ku veprojnë si të licensuar dhe strategji të tjera me interes të rëndësishëm publik.

[34] VKM nr. 440, datë 16 qershor 2011, ndryshura nga VKM nr. 741, datë 9 shtator 2015
[35] Parlamenti Shqiptar publikon draftet e ligjeve dhe ndryshimet në faqet e tij zyrtare: www.parlament.al.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, MEI mund të japë kocensione minerare për projektet e vlerësuar me interes të rëndësishëm ekonomik dhe social.

MEI publikon njoftimet për procedurat konkurruese, përfshirë termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit të ofertës, në faqen e agjencisë së prokurimit publik: www.app.gov.al. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është një agjenci publike e cila raporton drejtpërsëdrejti te Kryeministri. APP mbikqyr aktivitetin e prokurimit publik duke përfshirë dhënien e licensave dhe kocensioneve minerare.

Ofertat minerare vlerësohen kundrejt kritereve kryesore si më poshtë, të cilat kanë një peshë rendesie nga 10% deri në 20%:

1. Kapaciteti teknik dhe eksperienca e firmës dhe e stafit të saj;
2. Kapaciteti financiar duke përfshirë flukset e parasë dhe mundësitë e financimit;
3. Parashikimi i prodhimit për kohëzgjatjen e licensës;
4. Parashikimi i vlerës së prodhimit për kohëzgjatjen e licensës;
5. Parashikimi i prodhimit për përpunim;
6. Investimet e projektuara në zonë; dhe
7. Norma e brëndshme e kthimit të projektit (IRR)

Aktiviteti i licensimit në 2013 dhe 2014

MEI ka shpallur procedura konkurruese për 58 zona minerare në vitin 2013. Vetëm për 35 nga 58 (60%) zona minerare procedura e licensimit u mbyll me sukses. Në 8 raste, zonat minerare u tërhoqën dhe në 15 raste, procedurat e prokurimit u anuluan për shkak të cilësisë së dobët të aplikimeve, etj. Lista e zonave minerare të licensuara në vitin 2013 dhe kandidatët fitues janë paraqitur në Shtojcën 8.

Në 2014, procedura konkurruese u shpallën për 106 zona minerare. Vetëm 50 nga 106 (47%) zona minerare procedura e licensimit u mbyll me sukses. Nga zonat 106 e planifikuara, 7 raste u tërhoqën dhe 49 raste u anuluan për shkak të cilësisë së dobët të aplikimeve, etj. Lista e zonave minerare të licensuara në vitin 2014 dhe kandidatët fitues janë paraqitur në Shtojcën 9.

MEI njofton se nuk ka licensuar zona të hapura minerare përmes negociatave të rastit në vitet 2013 dhe 2014.

Përpunimi i mineraleve

Sektori minerar, i dominuar më parë nga ndërmarrjet shtetërore, u hap ndaj investimeve të huaja private në vitin 1994. Objektet minerare të dhëna me kocension deri më tani janë si më poshtë:

- Miniera e kromit në Bulqizë, Minerat Pojske dhe Katjel, fabrika e pasurimit në Bulqizë, Impianti i seleksionimit në Klos, Uzina e ferrokromit në Elbasan dhe Burrel;
- Minierat e kromit në Kalimash, rrethin e Kukësit, Vlahnë, rrethin e Hasit dhe fabrika e pasurimit në Kalimash;
- Minierat e bakrit në Munellë, Lak-Rosh, Karma si dhe fabrika e pasurimit në Fushë Arrëz;
- Miniera e bitumit në Selenicë, miniera dhe furra e shkrirjes së bitumit në Vlorë.

Aktiviteti Minerar në vitet 2011-2014

Sektori minerar gjeneroi një prodhim vlerësuar rreth 140.9 milion USD në vitin 2013 dhe 175.5 milion USD në vitin 2014. Viti 2011 shënoi një vit të suksesshëm për sektorin minerar me prodhim të vlerësuar në 217.5 milion USD. Në 2012 dhe 2013 prodhimi minerar pësoi rënie përkatësisht me 31% dhe 6%, ndërkohë që 2014 pati një rritje me 25%. Këto ndryshime lidhen kryesisht me luhatjet në prodhimin e mineralit të kromit.

Kromi zinte pjesën më të madhe me rreth 72% të prodhimit vendas minerar në 2013 dhe 76% të prodhimit vendas minerar në 2014.

Gurët gëlqerorë dhe mineralet e tjera për ndërtim përfaqësonin grupin e dytë më të madh të mineraleve pas kromit. Pesha e tyre në prodhimin vendas minerar arriti në 14% në vitin 2013 dhe 12% në vitin 2014.

Bakri, përbërjet e nikelit dhe bitumi së bashku përbënin 13% të prodhimit minerar në vitin 2013 dhe 12% në vitin 2014.

Grafiku 19 - Prodhimi minerar 2011-2014



Burimi: Raportuar nga AKBN

Grafiku 20 - Punesimi ne sektorin minerar 2011-2014



Burimi: Raportuar nga AKBN

Punësimi në sektor

Sektorin minerar punësoi afërsisht 4600 punonjës në vitin 2014. Punësimi në sektor pësoi rënie në vitin 2012 dhe 2013 si pasojë e rënies së aktivitetit prodhues dhe u rrit përsëri në vitin 2014. Sektori i kromit dhe ai guror zinin rreth 94% të punësimit në sektorin minerar në vitin 2011. Gjatë periudhës 2012-2014 pati një zhvendosje të forcës punëtore nga sektori guror dhe i mineraleve të ndërtimit drejt sektorit të kromit. Këto ndryshime lidhen me ndryshimin në aktivitetin prodhues në të dy nën-sektorët. Sektori i kromit punësoi rreth 59% të forcës punëtore në vitin 2013 dhe 69% në vitin 2014.

Kufizimet në të dhënave e raportuara nga AKBN për sasinë e prodhimit dhe punësimin

Informacioni për sasinë e prodhimit dhe numrin e punonjësve janë marrë nga të dhënat e raportuara nga AKBN, të cilat janë përftuar nga vetë-deklarimet e të licensuarëve në AKBN si pjesë e raportimeve vjetore, dhe nuk janë konfirmuar nëpërmjet ndonjë procesi verifikimi. Gjithashtu, bazuar në shifrat e raportuara nga AKBN, vetëm 70% e licensave kanë raportuar prodhimin në vitin 2013. Ky raport u rrit në 85% në vitin 2014. Për më tepër, AKBN nuk dha detaje mbi cilësinë e mineraleve (përqëndrimin) të prodhuar në periudhen nga viti 2011 deri vitin 2014. Në mungesë të këtij informacioni, prodhimi minerar nuk mund të vlerësohet sipas çmimeve të tregjeve ndërkombëtarë për mineralet. Vlerat e prodhimit paraqitur në këtë raport janë vlerësuar duke përdorur çmimet[36] e eksportit për secilin grup mineralesh.

[36] Çmimet janë përftuar nga të dhënat e përpunuara nga ekipi i ALBEITI në bashkëpunim me stafin e Autoritetit doganor.

Minerali i kromit

Rezervat e rikuperueshme të kromit (me cilësi mesatare 30.8% Cr2O3) vlerësohen rreth 10 milion ton[37], dhe janë përqëndruar kryesisht në rajonin e Bulqizës, Kukësit, Hasit, Matit dhe Pogradecit. Strategjia aktuale në këtë sektor fokusohet në tërheqjen e investimeve të mëdha për përpunimin e mineralit të kromit.

Sipas raportimit nga AKBN[38], prodhimi i kromit nga licensat aktive rezulton të jetë rreth **526,230 ton në vitin 2013** dhe **712,374 ton në vitin 2014.**

Sipas të njëjtit burim, të licensuarit në prodhimin e kromit punësuan rreth **2,070 punonjës në vitin 2013** dhe **2,957 punonjës në vitin 2014.**

Vlera e raportuar e prodhimit, vlerësuar me çmimet e eksportit[39] arriti rreth **101.95 milion USD në vitin 2013 dhe 133.64 milion USD në vitin 2014**.

Sektori i kromit është gjerësisht i fragmentizuar me rreth 290 licensa në fund të nëntorit 2015. Aktivitetet e prodhimit janë të përqendruara në rajonin e Bulqizës me rreth 112 licensa aktive të njëjtën periudhë.

Grafiku 21 - Prodhimi i kromit

ton '000



Burimi: Raportuar nga AKBN për këtë raport[39]

Sipas raportimit të AKBN, të licensuarit në zonën e Bulqizës prodhuarn rreth **45% të prodhimit total të kromit në vitin 2013** dhe punësuan rreth **77% të fuqisë punëtore** të punësuar në sektorin e kromit. Në 2014, prodhimi në Bulqizë u rrit në **57% të prodhimit total,** me një punësim rreth **74% të fuqisë punëtore** të punësuar në sektor.

Figura 6 - Harta e depozitave të mineralit të kromit



Burimi: Raportuar nga AKBN[40] – www.akbn.gov.al

Grafiku 22 - Punesimi dhe prodhimi ne sektorin e kromit

Burimi: Raportuar nga AKBN për këtë raport[39]

[37] Burimi: VKM nr.479, datë 29 qershor 2011 "Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë".
[38] Informacioni për prodhimin, vendburimet, nurmi i punonjësve është bazuar në të dhëna të raportuara nga AKBN për analiza në këtë raport.
[39] Çmimet janë përftuar nga të dhënat e përpunuara nga ekipi i ALBEITI në bashkëpunim me stafin e Autoritetit doganor.
[40] "Invest in Albanian natural resources –Mineral resources in Albania", publikuar nga AKBN – www.akbn.gov.al.

Grafiku 23 - Prodhimi i kromit - 2013



Burimi: Raportuar nga AKBN për kete raport

Grafiku 24 - Prodhimi i kromit - 2014



Burimi: Raportuar nga AKBN për kete raport

Albchrome[41] shpk (Albchrome) i licensuar për minierat në Bulqizë është Shoqëria më e madhe industriale dhe punëdhënësi më i madh në sektorin e kromit në Shqipëri. Albchrome zotëron një kontratë kocensioni me Qeverinë Shqiptare që nga viti 2001 për prodhimin dhe përpunimin e mineralit të kromit dhe ferrokromit. Pasuritë e Shoqërisë përfshijne minierat e kromit në Bulqizë, fabrikat e ferrokromit në Elbasan dhe Burrel, fabrika e pasurimit të kromit në Klos, dhe elementë të tjerë të infrastrukturës minerare dhe metalurgjike.

Në vitin 2013 dhe 2014, prodhimi i Albchrome zinte përkatësisht 12% dhe 10% të prodhimit të brëndshëm. Në të njëjtën periudhë, Shoqëria punësoi rreth 600 punonjës me mbi 20% të forcës punëtore aktuale në sektor.

Eksporti i kromit

Prodhimi i kromit eksportohet në formën e xeherorit të kromit dhe ferrokromit.

Kromi u eksportua kryesisht në Kinë, ndërsa ferrokromi në Holandë, Austri dhe Itali.

Në vitin 2013, Administrata Doganore Shqiptare raportoi eskporte të xeherorit të kromit prej 756 mijë ton në vlerën 9.6 miliard Lek. Në 2014, eksporti i xeherorit të kromit ra në 501 mijë ton me vlerë prej 8.1 miliard Lek.

Grafiku 25 - Eksportet e kromit 2011-2014



Burimi: Raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare[42]

Eksporti i ferrokromit në vitin 2013 kapi vlerën e 3.7 miliard Lek për 28.4 mijë ton.

Në vitin 2014, kjo vlerë u rrit ne 32.5 mijë ton të shitur me 4.9 miliard Lek.

Grafiku 26 - Eksportet e ferrokromit 2011-2014



Burimi: Raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare[42]

[41] Informacioni për Albchrome u përftua nga adresa zyrtare e interenetit të shoqërisë – www.balfin.al dhe www.albchrome.al.
[42] Informacioni për sasinë, vlerën dhe destinacionin e eksportit u raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare për qëllime të analizave në këtë raport.

Minerali i bakrit

Figura 7 - Harta e rezervave të mineralit të bakrit

Rezervat gjeologjike të mineralit të bakrit (përfshirë Cu 1.3-2.65%, zink, ar dhe argjend) vlerësohen rreth 50 milion ton[43]. Gjithsesi, rezervat e rikuperueshme vlerësohen të jenë jo më shumë se 27 milion ton. Depozitat e bakrit ndodhen në gjashtë rajone: Korçë, Mirditë, Pukë, Shkodër, Kukës dhe Has.

Rezervat e rikuperueshme në minierat aktuale të bakrit arrijnë rreth 4.7 milion ton (Cu 1.39%). Rezervat e rikuperueshme në zonat e reja vlerësohen në 13.4 milion ton, ku 7.9 milion ton (Cu 1.85%) ndodhen në Munellë dhe 5.6 milion ton (Cu 2.65%) ndodhen në Lak-Rosh, Perlatin e Jugut, Karmë 2 dhe Bregun e Gështenjës.

Gjatë viteve 1980, industria e bakrit ishte industria më e suksesshme në sektorin nxjerrës në Shqipëri

Aktiviteti i mineralit të bakrit 2011-2014

Beralb, i cili zotëron një marrëveshje kocensioni që nga 2001 (http://www.beralb.com/), ishte e vetmja Shoqëri industriale për nxjerrjen e bakrit në vitet 2011-2013. Beralb ka licensë prodhimi për minierat e Munellës, Lak-Roshit, Karmës dhe Fush-Arrësit, si edhe tre miniera të tjera që ndodhen në krahinën e Pukës.

Burimi: Raportuar nga AKBN[44] – www.akbn.gov.al

Beralb përpunon bakrin përmes Fabrikës së Pasurimit të Bakrit në Fush-Arrëz, që ndodhet në veri të këtij qyteti. Fabrika ka një kapacitet vjetor prej 600,000 ton dhe gjeneron rreth 45,000 ton bakër koncentrat në vit. Shoqëria ka realizuar studime të ndryshme për të përmirësuar parametrat e cilësisë në trajtimin e xeherorit sidomos për rekuperimin e zinkut, arit, argjendit dhe elementëve të tjerë të çmuar. Investimet kumulative në aktivitet kapin vlerën 70 milion USD.

Grafiku 27 - Prodhimi i bakrit



Burimi: Raportuar nga AKBN[46] – www.akbn.gov.al

Grafiku 28 - Prodhimi dhe punesimi ne sektorin e bakrit



Burimi: Raportuar nga AKBN [45] – www.akbn.gov.al

Beralb përfaqëson punëdhënësin më të madh në Fushë-Arrëz dhe në zonën përreth, duke punësuar mbi 94% të forcës punëtore në sektorin e bakrit. Siç tregohet në grafikun 28 në të majtë, luhatja e numrit të punonjësve lidhet ngushtë me nivelin e prodhimit.

[43] Burimi: VKM nr.479, datë 29 qershor 2011 "Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë".

[44] "Invest in Albanian natural resources –Mineral resources in Albania", publikuar nga AKBN – www.akbn.gov.al.

[45] Informacioni për prodhimin, vendburimet, nurmi i punonjësve është bazuar në të dhëna të raportuara nga AKBN për analiza në këtë raport.

Eksportet e bakrit

Grafiku 29 - Eksportet e bakrit 2011-2014

ton '000



Në katër vitet e fundit, Beralb ka eksportuar mineralet drejt partnerëve të tij strategjik në Kinë dhe Turqi. Administrata Doganore Shqiptare raporton totalin e eksporteve të bakrit, përfshirë edhe koncentratin e bakrit në 38 mijë ton me vlerë 4.7 miliard Lek në vitin 2013. Në 2014, eksportet e bakrit ranë në 25.8 mijë ton në vlerën 2.5 miliard Lek.

Burimi: Raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare[46]

Ndryshime të rëndësishme në tregjet ndërkombëtare të mineraleve dhe ndikimi në sektorin minerar në vend

Aktiviteti i biznesit të bakrit ka pësuar humbje të konsiderueshme për shkak të rënies së çmimeve ndërkombëtare të bakrit. Çmimet në tregjet ndërkombëtare të bakrit[47] ranë me -22% nga 2011 në 2014, ndërkohë që çmimet e eksportit për xeherorin shqiptar ranë me -32% në të njëjtën periudhë. Në gjysmën e parë të vitit 2015, çmimi ndërkombëtar i xeherorit të bakrit pësoi rënie të mëtejshme me -13.4%.

Grafiku 30 - Çmimet e bakrit në eksport në USD/ton



Burimi: Raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare [41]

[46] Informacion për vendet e eksportit, sasitë dhe vlerat e eksportuara janë raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare për qëllimin e këtij raporti.

[47] Burimi për çmimin ndërkombëtar të bakrit : http://databank.worldbank.org/data

Depozitat e nikelit

Figura 8 – Depozitat e Nikelit



Burimi: Raportuar nga AKBN[51] – www.akbn.gov.a l

Rezervat e nikelit në Shqipëri (Ni 0.85-1.15%) gjenden kryesisht në afërsi të Pogradecit, Librazhdit, Bilishtit, Kukësit dhe Peshkopisë dhe vlerësohen të jenë rreth 300[48] milion ton.

Sipas AKBN-së[49] prodhim i nikelit ishte rreth **202 mijë ton** në vitin 2013 dhe **535 mijë ton** në vitin 2014. Vlerat e prodhimit matur me çmimet e eksportit arritën vlerën **4.8 milion USD në vitin 2013** dhe **12.8 milion USD në vitin 2014. Në vitin 2013,** nikeli u nxorr kryesisht në formën e hekur-nikelit dhe silikatit të nikelit, në rajonet e **Hasit 44%, Librazhdit 22%** dhe **Pogradecit 29%. Në vitin 2014, 63%** e prodhimit u nxorr në **Librazhd,** ndërkohë që në **Kukës dhe Pogradec** prodhimi zinte përkatësisht rreth 12% të prodhimit total të nikelit. Sipas AKBN, rajoni i Has-it nuk ka raportuar prodhim të nikelit në vitin 2014.

Prodhimi në të dy vitet, u gjenerua nga shoqëri minerare të vogla dhe të mesme, si dhe disa të licensuar që mblidhnin nikelin nga shoqëritë e vogla dhe të mesme.

Në 2013 dhe 2014, nikeli kryesisht u eksportua[50] në Kosovë, Maqedoni dhe Kinë.

Figura 9 – Guri gëlqeror dhe mineralet e tjera



Burimi: Raportuar nga AKBN[51-] – www.akbn.gov.al

Prodhimi i gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera

Studimet gjeologjike në Shqipëri në vitet 1995 zbuluan rreth 32 lloje të ndryshme të gurëve dhe mineraleve industrialë për ndërtim të shpërndarë në gjithë sipërfaqen e vendit duke përfshirë: gëlqerorët, ranorët, dolomitet, gurët dekorativë, argjilat, granitet, gipset, etj.

Këto minerale përfaqësojnë burimin kryesor të lëndëve të para për industrinë e ndërtimit në Shqipëri. Prodhimi[50] u nxorr kryesisht përmes prodhuesve të vegjël vendas dhe vlerësohet të jetë rreth **20 milion USD në vitin 2013** dhe **20.4 milion USD në vitin 2014**. Një numër i madh shoqërish të vogla vepronin në nxjerrjen **e gurit gëlqeror dhe materialeve të tjera** të ndërtimit në vend. **Antea Cement**, në rajonin e Krujës, ishte prodhuesi më i madh në vitin **2013** dhe **2014** duke kontribuar përkatësisht **24%** dhe **20% të vlerës totale të prodhimit në këtë nën-sektor.**

Eksportet[49] kapën shifrën **7.5 miliard Lek në vitin 2013** dhe **8.6 miliard Lek në vitin 2014.** Gurët dhe mineralet e tjerë u eksportuan kryesisht drejt Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Italisë.

Depozitat shqiptare të bitumit dhe asfaltit ndodhen afër Selenicës dhe në luginën e lumit Vjosa. Shqipëria gjithashtu zotëron depozita të mëdha kripe në afërsi të Kavajës dhe Vlorës.

[48] Burimi: VKM no.479, datë 29 qershor 2011 "Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë".
[49] Informacioni për prodhimin, rajonet dhe numrin e punonjësve bazohet në të dhënat e raportuara nga AKBN për këtë raport.
[50] Informacioni për vendet e eksportit, sasitë dhe vlerat e eksportuara janë raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare për qëllimin e këtij raporti.
[51] "Invest in Albanian natural resources – Mineral resources in Albania", publikuar nga AKBN – www.akbn.gov.al.

2.3.2 Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit nga sektori minerar

Shteti gjeneron të ardhurat e tij nga sektori minerar përmes mbledhjes së rentës zbatuar mbi vlerën e shitjes së mineraleve dhe taksave e tatimit mbi fitimin.

Renta minerare

Renta minerare përllogaritet mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti i nxjerrjes, në bazë të ligjit "Për taksat kombëtare" nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar.

Tabela 12 – Renta e aplikuar për mineralet

Mineral	Renta e zbatuar në 2011-2014
Krom	6%
Bakër	6%
Nikel-silikat	6%
Hekur-nikel	5%
Bitum	5%-6%
Gurë gëlqerorë dhe të tjerë	4-7%

Renta përfaqëson të ardhurat kryesore të fituara nga ky sektor. Renta për eksportet mblidhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe për shitjet vendase nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Renta e zbatuar për mineralet kryesorë tregohet në të majtë në tabelën 12.

Në nëntor 2014, ligji për taksat kombëtare u ndryshua që të lejojë zbatimin e një rente të reduktuar në 2/3 e normës nominale për mineralet e përpunuar në vend.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi të ardhurat neto të shoqërisë. Deri në dhjetor 2013, tatimi mbi fitimin në Shqipëri përllogaritej me 10% e fitimit të tatueshëm në përputhje me "Ligjin për tatimin mbi të ardhurat" Nr. 8438, datë 28 Dhjetor 1998, ndryshuar. Më 1 Janar 2014, norma e zbatueshme e tatimit mbi fitimin u rrit në15%. Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin minerar.

Të ardhurat e lidhura direkt me akivitetin e sektorit minerar

Tabela 13 – E ardhura nga flukset e pagesave lidhur direkt me akivitetin minerar

Ne milion Lek	2013	2014
Renta në eksport	995	817
Renta në shitjet vendase	740	1,093
Tatimi mbi fitimin (*)	697	644
	2,433	**2,554**

Të ardhurat e gjeneruara nga flukset e pagesave direkte si renta minerare dhe tatimi mbi fitimin në vitin 2013 dhe 2014 arritën përkatësisht vlerat 2.4 miliard Lek dhe 2.6 miliard Lek. **Pagesa të tilla përbënin 16% të vlerës së prodhimit minerar në vitin 2013 dhe 14% në vitin 2014.**

Burimi: Pagesat e raportuara nga te licensuarit dhe Shteti

(*) E ardhura nga tatimi mbi fitimin përfshin informacionin mbi pagesat e tatimit mbi fitimin të dhëna nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve vetëm nga shoqëritë e përzgjedhura për të raportuar në vitin 2013 dhe 2014. Sistemet e administrimit të informacionit të DPT nuk mund të prodhonin të dhëna statistikorë për sektorin. Për këtë arsye, tatimi mbi fitimin nga sektori minerar i prezantuar më sipër nuk është i plotë.

Renta minerare paraqet fluksin kryesor të të ardhurave të gjeneruara nga sektori minerare. Renta njihet në Buxhetin e Shtetit, bazuar në ligjin për taksat kombëtare. Në përpudhje me ligjin për taksat kombëtare, Shteti transferon një pjesë të rentës së mbledhur tek njesitë e qeverisjes vendore që gjeneruan prodhimin minerar (shiko seksionin 2.5).

2.4 Sektori i Hidro-Energjisë

2.4.1 Vështrim i përgjithshëm i sektorit të hidro-energjisë

Figura 10 – Potenciali Hidro-Energjitik në Shqipëri



Sistemi energjetik shqiptar praktikisht mbështetet vetëm në hidrocentralet (HEC) dhe për këtë arsye ai është krejtësisht i varur nga kushtet hidrologjike. Sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë[52], prodhimi i përgjithshëm vjetor i mundshëm nga hidrocentralet në Shqipëri është vlerësuar në 10,000 GWh. Kjo mund të përftohet nga një kapacitet i instaluar prej 3,000 MW. Bazuar në këto të dhëna, në fund të vitit 2014 mundësitë e shfrytëzuara deri tani përfaqësojnë 58% të potencialit të hidro-energjisë me kapacitet total të instaluar prej 1,725 MW.

Historia e zhvillimit të sektorit [53]

Gjatë periudhës 1945 – 1951, fuqia prodhuese e energjisë ishte mesatarisht 10 KWh për frymë. Sektori filloi të zhvillohet pas vitit 1952, kur hidrocentrali Selita filloi veprimtarinë, me një kapacitet prej 5 MW. Në vijim hidocentrale me madhësi të mesme u ndërtuan në Ulëz dhe Shkopet në veri të Shqipërisë, dhe Bistrica 1 & 2 në jug të Shqipërisë me një kapacitet total prej 78 MW. Përkrah HEC-ve të mesme, u ndëtuan dhe rreth 90 HEC-e të vegjël me një kapacitet total të instaluar prej 14MW, që varionte nga 5 deri në 1,200 KW.

Burimi: Raportuar nga AKBN

Këto HEC-e përmbushnin nevojat e energjisë në zonat malore në të gjithë vendin. Këto hidrocentrale të vogla kishin një jetë mesatare prej 25 vjet dhe gjeneronin mesatarisht 200 GWh energji në vite normale.

Tre hidrocentralet më të mëdha në vend: Fierza, Komani dhe Vau i Dejës u ndërtuan në formë kaskade mbi lumin Drin nga viti 1971 deri në vitin 1985 me një kapacitet të instaluar prej 1350 MW. Sektori nuk shënoi zhvillime të rëndësishme nga viti 1985 deri në vitin 2007.

Drini, që kalon tej për tej vendin në veri, është lumi më i madh në Shqipëri. Studimet raportojnë për disa potenciale hidroenergjetike të shfytëzueshme mbi lumin Drin, si Skavica në rrjedhën e sipërme dhe Bushati në rrjedhën e poshtme. Vjosa dhe Devolli janë gjithashtu lumenj të mëdhenj në vend. Studimet në këto lumenj tregojnë për mundësitë e zhvillimit të disa hidrocentraleve të vegjël dhe të mesëm.

[52] Strategjia Kombëtare e Energjisë, e miratuar në korrik të vitit 2003 mund të gjendet në faqen e internetit të AKBN: www.akbn.gov.al.
[53] Informacioni i paraqitur në këtë pjesë është marrë nga "Hydro-energetic Potential" publikuar nga AKBN: www.akbn.gov.al

Kocensionet e reja për HEC të mesme[54]

AKBN raporton se gjatë viteve 2008 - 2011 qeveria shqiptare nënshkroi marrëveshje kocensionare për ndërtimin e gjashtë hidrocentraleve të mëdha, si vijon:

- HEC-et "Ashta 1 dhe Ashta 2", në lumin Drin me fuqi të instaluar prej 48 MW
- Tre HEC-e mbi lumin Devoll me fuqi të instaluar prej 319 MW, dhe
- HEC-i "Kalivaç" me fuqi të instaluar prej 100 MW në lumin Vjosë.

HEC-et "Ashta 1 dhe Ashta 2" në lumin Drin [55]

Në vitin 2008 Qeveria Shqiptare dha një kocension 35 vjeçar për ndërtimin, operimin dhe transferimin (BOT) të dy hidrocentraleve mbi lumin Drin, Ashta 1 dhe Ashta 2, të cilët do të shfrytëzonin ujin e mbetur nga HEC-i i Vaut të Dejës. HEC-et përfunduan ndërtimin dhe filluan prodhimin në vitin 2013. Ky projekt solli një teknologji të re në rritjen e efikasitetit të përdorimit të ujit, duke përdorur disa turbina të vogla në vend të një turbine të madhe. Investimi i partnerëve të projektit EVN AG dhe Verbund AG raportohet në vlerën 200 milionë euro. Të dy HEC-et kanë një kapacitet total prej 53MW dhe pritet të gjenerojnë një prodhim vjetor prej 240 GWh.

Detajet e projektit dhe investimet janë paraqitur në faqen e internetit të Ashtës: http://www.energji-ashta.al/.

HEC-et në lumin Devoll[56]

Në vitin 2009 Qeveria e Shqipërisë dha me kocension të drejtat për ndërtimin, zotërimin, operimin dhe transferimin (BOOT) e tre hidrocentraleve mbi lumin Devoll shoqërisë Devolly Hidropower Sh.a. (DHP).

Aktualisht projekti konsiston në ndërtimin e dy hidrocentraleve, Banja dhe Moglicë në luginën e Devollit, me një kapacitet të instaluar prej 256 MW. Hidrocentralet pritet të gjenerojnë një prodhim vjetor prej 729 GWh, i cili përfaqëson një rritje prej 15% krahasuar me prodhimin e brendshëm në vitin 2014. Impiantet pritet të përfundojnë përkatësisht në vitin 2016 dhe në vitin 2018. Pas përfundimit me sukses të dy hidrocentraleve, DHP do të konsiderojë investimin në një HEC të tretë në lumin Devoll.

Shoqëria kocensionare Devoll Hydropower Sh.A. u krijua fillimisht si një ndërmarrje e përbashkët të drejta të barabarta pronësie midis Statkraft AS dhe shoqërisë austriake të energjisë EVN AG. Në fillim të vitit 2013, Statkraft bleu 50 përqind të aksioneve të EVN dhe tani është 100 përqind pronar i Shoqërisë dhe i projektit në ndërtim. Marrëveshja e kocensionit i jep shoqërisë Devolli Hydropower të drejtë të ndërtojë, të zotërojë dhe shfrytëzojë hidrocentralet derisa ata t'i transferohen Qeverisë Shqiptare në fund të periudhës së kocensionit.

Detajet e projektit dhe investimet janë paraqitur në faqen e internetit të DHP:
http://www.devollhydropower.al/

HEC-i "Kalivaç" në lumin Vjosa

Në vitin 1997, Qeveria e Shqipërisë i dha Becchetti Energy Group (BEG SPA), një kocension BOT për ndërtimin e HEC-it Kalivaç, mbi lumin Vjosa për një periudhe 30 vjet. HEC-i do të kishte një kapacitet prej 100MW dhe do të gjeneronte një prodhim vjetor prej 350GWh. Ndërtimi i projektit pritej të përfundonte në vitin 2000, por për shkak të vonesave në investime projekti mbeti disa vite mbrapa afatit të marrëveshjes. Marrëveshja e kocensionit u ndryshua më tej në vitin 2000 dhe në vitin 2007 kur Deuche Banka AG bleu 45% të aksioneve në Projekt. Pas disa vitesh Qeveria Shqiptare dhe Deuche Banka AG hapën çështje ligjore kundër BEG SPA për shkelje në marrëveshjet përkatëse.

[54] Burimi: "Hydro-energetic Potential" publikuar nga AKBN- www.akbn.gov.al
[55] Informacioni i prezantuar më sipër është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Shoqërisë - http://www.energji-ashta.al.
[56] Informacioni i prezantuar më sipër është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Shoqërisë - http://www.devollihydropoëer.al.

Prodhimi hidro-energjitik dhe bilanci energjisë në vitet 2000-2014

Prodhimi vjetor vendas varion kryesisht në varësi të cikleve hidroenergjetike. Në 15 vitet e fundit, prodhimi vjetor i energjisë arriti pikun e tij në vitin 2010 me 7,674 GWh dhe vlerën më të ulët në vitin 2007 me 2,826 GWh.



Burimi për prodhimin vendas: INSTAT - Bilanci i energjisë 2000-2014 – www.instat.gov.al.
Burimi për kapacitetin e instaluar: ERE – Raportet vjetore 2009-2014 – www.ere.gov.al.

HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës mbi lumin Drin gjeneruan mesatarisht rreth 90% të enegjisë në 15 vitet e fundit me një prodhim mesatar vjetor prej 4,286 GWh. Prodhimi i brendshëm neto është rritur disi në 4 vitet e fundit si rezultat i fillimit të prodhimit nga HEC-et private dhe me kocension.



Burimi: ERE – Raporti vjetor 2014 – www.ere.gov.al.

Grafiku 33: Prodhimi dhe përdorimi i energjisë elektrike 2000 – 2014



Burimi: INSTAT – Bilanci i Energjisë, 2000 -2014

Pavarësisht nga potenciali hidro-energjitik, në 15 vitet e fundit, Shqipëria ka qenë kryesisht një importues neto i energjisë elektrike për të kompensuar bilancin e vazhdueshëm negativ të energjisë.

Ky bilanci negativ i energjisë vjen kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të humbjeve në rrjet. Bazuar në të dhënat e raportuara nga INSTAT prodhimi vjetor mesatar për periudhën nga viti 2000 deri vitin e 2014 përbën rreth 76%[57] të energjisë vjetore transmetuar në rrjet, duke përfshirë humbjet.

Nëse humbjet teknike dhe financiare në rrjet do të eliminohen plotësisht, siç tregohet në Grafikun 33, bilanci i energjisë do të përmirësohej në mënyrë të ndjeshme dhe do të arrinte një prodhim mesatar në masën 122%[58] të totalit të nevojave për energji elektrike në vend. Grafiku 33 tregon një bilanc pozitiv të energjisë gjatë gjithë periudhës, me përjashtim të viteve 2002, 2007, 2008 dhe 2011, kur prodhimi nuk arriti të mbulonte nevojat e brendshme për energji. Kjo vjen si rrjedhojë e kushteve jo të favorshme meteorologjike si dhe mosshfrytëzimit të potencialeve energjetike të vendit.

[57] Përllogaritur si mesatare e thjeshtë vjetore e raportit prodhim – përdorim përgjatë viteve 2000 - 2013. Burimi i të dhënave nga "Bilanci energjisë elektrike, 2000 -2013" - www.instat.gov.al.
[58] Përllogaritur si mesatare e thjeshtë vjetore e raportit prodhim - konsum përgjatë viteve 2000 - 2013. Burimi i të dhënave nga "Bilanci energjisë elektrike, 2000 -2013" - www.instat.gov.al.

2.4.2 Përfshirja e Shtetit në sektor

Sistemi energjetik i vendit përbëhet nga impiantet e prodhimit të energjisë, sistemi i transmetimit dhe interkoneksionit dhe infrastruktura e sistemeve të informacionit, rrjeti i shpërndarjes dhe pajisjet e matjes së konsumit. Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar është lidhur me sistemet e Elektroenergjitike të vendeve të tjera nëpërmjet linjave të interkoneksionit.

Shteti Shqiptar është gjerësisht i përfshirë në sektorin hidroenergjetik. Në fund të vitit 2014, me përjashtim të disa HEC-eve private dhe me kocension, sistemi energjitik Shqiptar përfshirë HEC-et kryesore prodhuese mbi lumin Drin dhe sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, zotërohej dhe administrohej nga shoqëri të zotëruara 100% nga Shteti Shqiptar. Shoqëritë shtetërore në sektorin hidro-energjitik listohen më poshtë:

- Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)
- Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST ose OST)
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)

OST dhe OSHEE kanë qënë më parë nën administrimin e KESH. Shoqëritë u shkëputën nga KESH, përkatësisht në vitin 2004 dhe 2006, si pjesë e reformave për ristrukturimin e sektorit të energjisë elektrike.

2.4.3 Kuadri operativ i tregut të energjisë elektrike

Deri në Prill 2015 sektori i energjisë elektrike qeverisej nga Ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar (Ligji i vjetër për sektorin e energjisë), i cili përcakton parimet bazë për zhvillimin e sektorit të energjisë, duke përfshirë energjinë e rinovueshme nga termocentralet, operatorin e transmetimit të energjisë dhe rrjetet e shpërndarjes. Ky ligj gjithashtu përmban kërkesat dhe kriteret për dhënien e licensës për të kryer një aktivitet në sektorin e energjisë. Në Prill 2015 qeveria e Shqipërisë aprovoi ligjin e ri nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë” (Ligji i ri për sektorin e energjisë), i cili zëvëndësoi ligjin e vjetër. Ligji i ri ka qëllim që të pasqyrojë Direktivat e BE-së për sektorin e Energjisë Elektrike.

Linjat private të interkoneksionit.

Ligji i vjetër dhe ai i ri në sektorin e energjisë ofrojnë terma dhe kushte për ndërtimin e linjave tregtare të interkoneksionit. Ndërtimi i linjave tregtare të interkoneksionit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Shoqëria investuese ka të drejtën të përdori 80% të kapacitetit të linjave për një periudhë prej 20 vjetësh. Ndërkohë 20 % e kapacitetit të linjave tregëtare të interkoneksionit duhet të bëhen të disponueshme për përdorim publik. Pas 20 viteve, linjat i transferohen Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Deri tani nuk ka investime private në linjat e interkoneksionit.

Kocensionet e hidroenergjisë dhe PPPs

Ministria e Energjisë dhe Industrisë jep të drejtat për ndërtimin e hidrocentraleve të reja nëpërmjet marrëveshje të kocensionit dhe Partneritetit Publik Privat (PPP), sipas ligjit për kocensionet dhe PPP-të. Të gjitha kocensionet e hidroenergjisë dhe Marrëveshjet e PPP-ve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kocensionet e dhëna dhe aktiviteti i tyre është paraqitur në seksionin 2.4.5.

Rregullimi dhe rregullat e tregut.

Sipas Ligjit për Sektorin e energjisë elektrike, ERE është përgjegjëse për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve të tregut, dhe për sigurimin e kontrollit rregullator në tregun shqiptar të energjisë. Rregullat e Tregut së bashku me Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes dhe Modelin e Tregut jane pjese e akteve qe rregullojnë tregun e energjisë elektrike. Ato publikohen në faqen zyrtare të ERE-s http://www.ere.gov.al

Tregu shqiptar i energjisë elektrike (“Tregu”), i miratuar me vendim të Bordit të komisionerëve të ERE nr. 338, datë 19.03.2008, përcakton kuadrin ligjor për organizimin dhe ristrukturimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Modeli i Tregut, i ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar në vitin 2006, është zhvilluar në përputhje me Direktivat e BE-së për energjinë elektrike dhe kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike. Modeli i Tregut trajton gjithashtu përgjegjësitë dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Në vija të përgjithshme, Modeli i Tregut Shqiptar karakterizohet nga kontrata dypalëshe midis pjesëmarrësve të tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) kryen shërbimet ndihmëse për transmetimin e energjisë.

Figura 11 – Flukset e energjisë dhe bashkëpunimi midis pjesmarrësve të tregut



Pjesëmarrësit kryesorë të tregut dhe roli i tyre prezantohet në vijim:

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)

KESH është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i energjisë elektrike në Shqipëri. **KESH-i ka qënë i zotëruar 100%.dhe nën administrimin e Shtetit Shqiptar që prej themelimit të tij.**

Shoqëria është e ndarë në dy njësi kryesore operative: Divizioni i Gjenerimit dhe Furnizuesit Publik me Shumicë.

Gjenerimi i prodhimit (Divizioni i Gjenerimit – KESH Gen)[59]

KESH Gen është prodhuesi më i madh publik i energjisë elektrike me një kapacitet total të instaluar prej 1,448 MW. Aktualisht, Divizioni i Gjenerimit zotëron dhe operon HEC-et më të mëdha mbi Lumin Drin, HEC-in e Fierzës, HEC-in e Komanit dhe HEC-in e Vaut të Dejës, me një kapacitet total të instaluar prej 1350 MW, dhe një termocentral (TEC) në Vlorë ndërtuar në vitin 2009, me një kapacitet të instaluar prej 98MW. Deri në mesin e vitit 2013, KESH zotëronte dhe administronte HEC-et e mesme të Ulzës, Shkopetit dhe Bistrica 1 dhe 2 me një kapacitet total të instaluar prej 76MW. Këto hidrocentrale ju shitën shoqërisë Kurum International Ltd në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013 me një çmim prej 130 milionë USD.

Fierza HPP is located near the village of Fierza about 20 km from the town of Bajram Curri. The HPP was built in the period from 1971 to 1978. Koman HPP, built from 1980 to 1988, is located in the Drini River Valley, between Fierza HPP dhe Vau i Dejes HPP, dhe about 2 km from the Koman village. Vau i Dejes HPP, built from 1967 to 1971 is located in the lower part of the Drini River Valley, about 18 km from the city of Shkodra.

Hidrocentrali i Fierzës ndodhet në afërsi të fshatit Fierzë rreth 20 km nga qyteti i Bajram Currit. HEC-i është ndërtuar në periudhën nga viti 1971 deri në vitin 1978. HEC-i i Komanit, i ndërtuar në periudhën nga viti 1980 deri në vitin 1988, ndodhet në luginën e lumit Drin, rreth 2 km nga fshati Komanit, në mes të HEC-it të Fierzës dhe atij të Vaut të Dejës. HEC-i Vaut i Dejës, i ndërtuar në periudhën nga viti 1967 deri në vitin 1971, është i vendosur në pjesën e poshtme të Luginës së lumit Drin, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës.

[59] Burimi i informacionit mbi HEC-et: www.kesh.al.

Tabela 14 – Të dhëna teknike të HEC-eve në lumin Drin

Të dhëna teknike të HEC-eve	Fierza	Koman	Vau i Dejës
Viti i fillimit të shfrytëzimit	1978	1985	1971
Numri i agregateve	4	4	5
Fuqia e instaluar në total	125 MW	150 MW	50 MW
Fuqia e instaluar	500 MW	500 MW	250 MW
Lloji i turbinave	Francis	Francis	Francis
Kapaciteti total vëllim në liqen	2.7 miliard m^3	450 milionë m^3	560 milionë m^3
Lartësia maksimale e liqenit	296 m	176 m	76 m
Rënia nominale	118 m	96 m	52 m
Prodhimi mesatar vjetor	1,800 GWh	2,060 GWh	1,000 GWh

Burimi: KESH – www.kesh.al

KESH ka kryer disa ndërhyrje për të rritur efikasitetin e operacioneve dhe ruajtjen e mjedisit përrreth. Investimet totale që nga viti 2001 deri në vitin 2006 arrijnë në 22 milionë euro. KESH vlerëson situatën e digave dhe kryen investime përmes projektit të sigurisë të Digave, i financuar nga organizatat ndërkombëtare financiare.

Qëllimi i projektit është të rrisë sigurinë gjatë furnizimit të impianteve të mëdha hidroenergjetike të ndërtuar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat dhe për të rritur efikasitetin e furnizimit me energji elektrike.

TEC i Vlorës është ndërtuar në vitin 2009 dhe nuk vepron për shkak të një defekti në turbinën e impiantit ftohës.

Shitja e energjisë

Divizioni i Gjenerimit i shet energjinë elektrike Furnizuesit Publik me Shumicë, në përputhje me sasinë dhe çmimin e miratuar nga ERE. Për të përmbushur detyrimet e veta për furnizim, Divizioni i Gjenerimit importon energjinë në tregun ndërkombëtar me çmimet e tregut. Në të njëjtën kohë, shet në tregun e brendshëm ose ndërkombëtar tepricat e energjisë përtej kërkesave për furnizim publik.

Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH)

Furnizuesi Publik me Shumicë është një strukturë e organizuar brenda KESH-it me përgjegjesi për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar furnizim të mjaftueshëm për Furnizuesin Publik me Pakicë në mënyrë që të garantohet furnizimi pa ndërprerje i klientëve tariforë.

Për të përmbushur funksionin e tij, Furnizuesi Publik me Shumicë ka të drejtë të blejë të gjithë energjinë e prodhuar në vend nga Divizioni i Gjenerimit dhe prodhuesit e tregtuesit privat. Gjithashtu, Furnizuesi Publik me Shumicë importon në tregun ndërkombëtar ose blen nga tregtarët vendas me çmime tregu për të plotësuar nevojat e furnizimit publik dhe për të shmanguar ndërprerjet e energjisë elektrike. Me miratimin e ERE-s, Furnizuesi Publik me Shumicë, mund të refuzojë blerjen e energjisë elektrike kur kostoja e furnizimit kalon vlerën e kostos së mosfurnizimit për klientët me pakicë, të përcaktuar nga ERE në përputhje me politikën e qeverisjes dhe në konsultim me Këshillin e Ministrave.

KESH jep detaje për impiantet e prodhimit të energjisë, prodhimin, importin e enegjisë dhe detaje të projekteve aktuale në faqen e saj të internetit: www.kesh.al.

Operatori i sistemit të transmetimit (OST)[60]

OST është themeluar në vitin 2004 si një njësi e shkëpur nga KESH. OST operon rrjetin e transmetimit duke përfshirë pronësinë, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e tij. Sistemi i transmetimit përfshin linjat e transmetimit dhe linjat e interkoneksionit me tension nga 110-400kV dhe pikat e nënstacionit. Aktualisht sistemi i transmetimit numëron 293 km gjatesi për linjat e transmetimit 400 kV,1140 km për linjat 220 kV, 4.4 km për linjat 150 kV dhe 1285 km për linjat 110 kV. Siç paraqiten në Raportin vjetor të ERE, humbjet në rrjetin e transmetimit arritën në 2.1% të energjisë së transmetuar në vitin 2014 dhe 2.3% në 2013.

[60] Burimi i informacionit për rrjetin e shpërndarjes - Raporti "Gjendja e Sektorit të Energjisë në Shqipëri dhe Veprimtaria e ERE – s gjatë Vitit 2014" publikuar nga ERE: www.ere.gov.al.

Rrjeti i transmetimit OST përfshin linjat e mëposhtme të interkoneksionit të cilat ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për shkëmbimin ndërkombëtar të energjisë:

- Linja e transmetimit 220 kV midis Fierzës(Shqipëri) - Prizrenit (Kosovë)
- Linja e transmetimit 220 kV midis Koplikut (Shqipëri) - Podgoricës (Mali i Zi)
- Linja e transmetimit 400 kV midis Zemblakut (Shqipëri) - Kardias (Greqi)
- Linja e transmetimit 400 kV midis Tiranës (Shqipëri) - Podgoricës (Mali i Zi)

Roli i OST

OST, në përputhje me rregullat e funksionimit të Tregut dhe legjislacionin për sektorin e energjisë elektrike, garanton kapacitetin afatgjatë të sistemit dhe administron në mënyrë produktive dhe pa diskriminime flukset e energjisë për shkëmbimet brenda sistemit dhe me sistemet e tjera të vendeve të rajonit.

OST-ja përgjigjet për organizimin dhe administrimin e likuidimeve dhe pagesave të energjisë elektrike mes pjesëmarrësve të tregut dhe si dhe për devijimet (disbalancat) në furnizim. OST faturon përdoruesit e sistemit për sherbimin e transmetimit, shërbimet ndihmëse, pagesat sipas Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe për blerjen e energjisë balancuese sipas Rregullave të Tregut. Tarifat për shërbimin e transmetimit janë të rregulluara nga ERE.

OST ka qënë e zotëruar 100% dhe nën administrimin e Shtetit Shqiptar që prej themelimit të saj.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike - OSHEE (më parë njihej si Operator i Sistemit të Shpërndarjes - OSSH)[61]

OSHEE aktualisht zotëron, mirëmban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes në të gjithë vendin, përbërë nga nënstacione 110/20, 15,600 km rrjet i shpërndarjes së linjave 35/20/10/6 kV, si dhe transformatorët 110/35/20/10/6kV. OSHEE siguron lidhjen dhe shpërndarjen e shërbimeve për klientët tariforë, prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike dhe konsumatorët e kualifikuar të lidhur me shpërndarjen, në baza jodiskriminuese. Tarifat, termat dhe kushtet e shërbimeve të shpërndarjes janë të rregulluara nga ERE.

Pajisjet dhe rrjeti i shpërndarjes janë përdorur për një periudhë që varionë nga 12 deri në 40 vjeç dhe janë relativisht të vjetëruara. Kushtet e dobëta teknike të rrjetit të shpërndarjes në kombinim me humbje financiare për shkak të vjedhjes së energjisë dhe faturave të papaguara i kanë shkaktuar OSHEE-së humbje të konsiderueshme, të cilat u luhatën nga 35% në 43% në 15 vitet e fundit. OSHEE, gjithashtu blen energji nga çdo ofrues në treg me çmimet e tregut për të mbuluar të gjitha humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Furnizuesi Publik me Pakicë (FPP)

Furnizuesi Publik me Pakicë është një strukturë e veçantë brenda OSHEE që furnizon me energji klientët tariforë sipas kushteve të kontratës dhe tarifave të rregulluara nga ERE.

Furnizuesi Publik me Pakicë (FPP) blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice (WPS) me tarifa të miratuara nga ERE-ja. FPP është përgjegjës për zvogëlimin e humbjeve nga konsumatorët tariforë sipas kushteve të përcaktuara nga ERE-ja.

Në fund të vitit 2014 OSHEE zotërohet përsëri 100% nga Shteti Shqiptar, pas historisë së pasuksesshme të privatizimit me CEZ AS.

[61] Burimi i informacionit për rrjetin e shpërndarjes - Raporti “Gjendja e Sektorit të Energjisë në Shqipëri dhe Veprimtaria e ERE – s gjatë Vitit 2014” publikuar nga ERE-- www.ere.gov.al.

Privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Në përpjekje për të optimizuar kostot e shpërndarjes, dhe zvogëluar humbjet teknike dhe financiare në rrjet, dhe për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm të energjisë për konsumatorët tariforë, Shteti Shqiptar shiti 76% të aksioneve të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me vlerë 102 milion Euro tek investitori strategjik CEZ S.A. në Mars të vitit 2009. Privatizimi u krye nëpërmjet një procedure ndërkombëtare tenderimi dhe ku përveç të tjerash, CEZ S.A. u angazhua në përmbushjen e kushteve minimale teknike për përmirësimin e rrjetit të furnizimit dhe situates financiare të OSHEE.

CEZ operoi në tregun shqiptar përgjatë viteve 2010 – 2012. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me anë të vendimit nr. 158 datë 16 nëntor 2012, vendosi për fillimin e procedurave për heqjen e licensës së furnizuesit publik me pakicë dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Në janar 2013 shoqëria kaloi në administrim të përkohshëm deri në likuidim në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Në 31 korrik 2014, me anë të Ligjit Nr. 114/2014 “Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A.S.” Parlamenti Shqiptar vendosi për transferimin e aksioneve të OSHEE nga CEZ A.S. tek Shteti Shqiptar me vlerën nominale prej 1 Euro, me kusht që Shteti Shqiptar t’i paguajë CEZ A.S. detyrimet për huatë në shumën total prej 95 milion Euro.

Kjo shumë është e pagueshme në pesë këste: 10,000,000 Euro me miratimin e marrëveshjes, 21,750,000 Euro në vitin 2015 dhe 21,083,333 Euro për vitin 2016, 2017 dhe 2018.

Furnizuesi Publik me Shumicë, OSHEE dhe FPP operojnë me liçenca të veçanta të lëshuara nga ERE.

Prodhuesit privat të energjisë elektrike

Prodhuesit privat të energjisë elektrike ndahen në prodhues të vegjël dhe prodhues të mëdhenj. ***Prodhuesit privat të Vegjël të Energjisë elektrike (PVE)*** janë centralet e vegjël gjenerues të energjisë elektrike, që lidhen në sistemin e shpërndarjes. ***Prodhuesit e Pavaruar të Energjisë elektrike (PPE)*** janë prodhuesit e pavaruar që lidhen direkt në sistemin e transmetimit. PVE-të dhe PPE-të mund të shesin energji tek Furnizuesit Publik me Shumicë me çmim të regulluar ose tek operatorët e tjerë të tregut me terma të negociura lirisht.

ERE përcakton tarifa të thjeshta e të njëhsuara të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël në tregun e rregulluar.

Klientët e energjisë elektrike

Klientët tariforë blejnë energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakicë me tarifa të rregulluara nga ERE***.***

Klientët e Kualifikuar janë klientë që mund të zgjedhin lirisht furnizuesin e energjisë elektrike, duke përfshirë Furnizuesin Publik me Pakicë. Sipas përcaktimit të Nenit 48 klientë të kualifikuar mund të jenë konsumatorët e lidhur me linjën e tensionit 110kV e sipër dhe të gjithë konsumatorët e tjerë që kanë një konsum më të madh se 50 milion kWh në vit***.***

Operatorë të tjerë të tregut

Tregtuesit e energjisë blejnë dhe shesin energji elektrike me shumicë tek operatorët e tregut, me përjashtim të furnizuesit publik me pakicë dhe klientëve tariforë.

Tregtuesit mund të blejnë energji nga Divizioni i Gjenerimit pranë KESH (për tepricat), PVE-të dhe PPE-të, për t'ja shitur Furnizuesve të Kualifikuar, Furnizuesit Publik me Shumicë ose OSHEE-së.

Furnizues të Kualifikuar janë furnizuesit vendas ose të huaj të licensuar nga ERE, te cilët mund të blejnë energji nga tregtuesit, nga PVE-të ose nga PPE-të për t'jua shitur Klienteve te Kualifikuar. Furnizuesit e Kualifikuar mund t'u shesin energji edhe Furnizuesit Publik me Shumicë, Tregtuesve ose Furnizuesve të Kualifikuar të tjerë. PVE-të dhe PPE-të duhet te licensohen që të bëhen Furnizues të Kualifikuar, nëse ata vendosin që t'i shesin direkt energji elektrike Klientëve të Kualifikuar.

Rregullimi i çmimit dhe i kushteve të tjera nën Modelin e Tregut Shqiptar është i domethënës. Ai reflekton situatën aktuale, pothuajse monopol, të pjesëmarrësve kryesor në prodhimin dhe furnizimin e energjisë elektrike. Megjithatë, rregullimi ka në fokus vetëm shërbimin e furnizimit publik të energjisë elektrike. Modeli i tregut shqiptar, lë hapsirë për zhvillimin e tregtisë së lirë ndërmjet operatoreve vendas dhe të huaj për tepricat e energjisë elektrike, që do të sillte fuqizimin e vendit tonë si eksportues të energjisë elektrike dhe kapaciteteve të lira të interkoneksionit në rajon nëse prodhimi do të tejkalonte përdorimin e energjisë në vend. Nëse prodhimi i energjisë tejkalon përdorimin e brendshëm të energjisë, vendi ynë mund të veproj si një eksportues i fuqisë dhe kapacitetit të lirë në rajon.

Tabela 15 – Të dhëna kryesore financiare të sektorit[62]

	2013				2014			
	KESH	OST	OSHEE	Total	KESH	OST	OSHEE	Total
Prona, impiantet dhe pajisjet	80,728	38,891	22,800	142,419	81,460	41,819	20,552	143,831
Kredi për SOE të tjera	24,653	104	-	24,757	24,302	-	-	24,302
Tregu dhe të arkëtueshme të tjera	79,588	10,435	10,398	100,421	64,574	13,419	12,637	90,630
Totali i pasurisë	184,969	49,431	33,198	267,598	170,336	55,238	33,189	258,763
Kapitali aksionar	86,761	22,455	(66,738)	42,478	63,251	24,163	(71,248)	16,166
Kredi të garantuara nga shteti	79,321	22,881	19,015	121,217	83,623	25,459	22,565	131,647
Tregu dhe të pagueshme të tjera	18,887	4,095	80,921	103,903	23,463	5,576	81,872	110,911
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	184,969	49,431	33,198	267,598	170,336	55,199	33,189	258,724
Të ardhura nga shitja	24,989	5,534	37,706	68,229	10,832	6,886	47,286	65,004
Importet e energjisë	(8,715)		(34,457)	(43,172)	(9,837)		(34,199)	(44,036)
Shpenzime të tjera operative, neto	(3,903)	(3,131)	(29,158)	(36,192)	370	(4,266)	(14,018)	(17,914)
Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve OSHEE	-	-	-	-	(19,653)			(19,653)
Kostot financiare, net	(3,070)	(37)	(94)	(3,201)	(3,848)	(286)	(1,144)	(5,278)
Fitimi para tatimit	9,300	2,366	(26,002)	(14,336)	(22,135)	2,334	(2,075)	(21,876)
Shpenzime tatimore	(1,356)	(801)	(1)	(2,158)	(105)	(445)	(2)	(552)
Fitimi pas tatimit	7,945	1,565	(26,003)	(16,493)	(22,241)	1,890	(2,078)	(22,429)

Burimi: Pagesat e raportuara nga të licensuarit dhe Shteti.

[62] Përmbledhja e treguesve financarë kryesorë paraqet të dhëna marrë nga pasqyrat financiare vjetore të KESH, OST dhe OSHEE për 2014. Kompanitë ndanë me ne këtë infromacion për qëllim të këtij raporti.

Garanci dhe transferime të tjera midis Shtetit dhe Shoqërive Shtetërore

Përkrah përfitimeve në formën e taksave dhe tarifave nga sektori i hidroenergjisë, Shteti injekton fonde në këtë sektor nëpërmjet investimit në kapital dhe kreditimit direkt të shoqërive me pronësi shtetërore. Gjithashtu, Shteti paraqitet si garantues i huave bankare të marra nga shoqëritë me pronësi shtetërore si KESH dhe OST. Në fund të vitit 2013 dhe 2014 huatë e dhëna apo garantuar për shoqëritë KESH dhe OST për përmirësimin e infrastrukturës gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike arritën *përkatësisht në 96.5 miliardë Lek (të barabartë me 121.2 miliardë Lek minus 24.7 miliardë Lek) dhe 107.3 miliardë Lek (të barabartë me 131.6 miliardë Lek minus 24.3 miliardë Lek)*.

Për shkak të situatës së vështirë financiare në sektorin e energjisë elektrike, niveli i huamarrjeve të garantuara nga Shteti parashikohet të rritet edhe më tej. Këto kredi do të përdoren për të financuar investime në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit të energjisë, transmetimin dhe shpërndarjen, gjithashtu përmirësime në matjen e konsumit të energjisë nga ana e konsumatorëve tariforë dhe në mbledhjen e faturave për energji të konsumuar.

Në shtator 2014[63], Banka Botërore miratoi financimin prej 150 milionë USD nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për Projektin e Rimëkëmbjes së Sektorit Energjetik në Shqipëri miratuar me VKM 171, datë 25 skhkurt 2015 “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”. Projekti do të mbështesë reformat e sektorit energjetik të Shqipërisë, veçanërisht ato të ndërmarra për përmirësimin e besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit, ku përfshihen reformat për diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë, reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e arkëtimeve.

2.4.4 Dhënia e kocensioneve hidro-energjetike

Ministria përgjegjëse për energjinë është Autoriteti Kontraktues për të gjitha kocensionet e dhëna në sektorin e hidro-energjisë. Legjislacioni dhe rregulloret për kocensionet përcaktojnë parimet dhe procedurat për vlerësimin e mundësive të kocensionit në sektorin e hidroenergjisë dhe dhënies së këtyre kocensioneve. Sipas legjislacionit në fuqi, të gjitha kocensionet në Shqipëri jepen për një periudhë jo më të gjatë se 35 vjet.

Deri në maj 2013, ndërtimi dhe funksionimi i hidrocentraleve në Shqipëri rregullohej me Ligjin Nr. 9663, datë 18 dhjetor 2006 "Për Kocensionet" ("Ligji i Vjetër i Kocensioneve) dhe rregulloren shoqëruese “Rregullat e vlerësimit dhe të dhënies së kocensioneve” të miratuar me VKM Nr. 1701, datë 17 dhjetor 2012.

Dispozitat e rregullores së vjetër të kocensionit konstatojnë se kocensionet në hidro-energjitikë janë të organizuara në përputhje me modelin *Ndërtim-Administrim-Transferim ose Build-Operate-Transfer-(“BOT”)*. Sipas tij, operatori financon ndërtimin e hidrocentralit dhe merr përfitimet që rrjedhin nga funksionimi i tij. Shitja e energjisë së prodhuar nga Operatori garantohet përmes Marrëveshjeve së Blerjes së Energjisë Elektrike të nënshkruar midis Operatorit dhe Furnizuesit Publik me Shumicë të Energjisë me tarifa të rregulluara nga ERE sipas modelit “feed in”.

Në maj të vitit 2013 ligji dhe rregullorja e vjetër për kocensionin u zëvendësua me Ligjin nr. 123/2013 "Për kocensionet dhe Partneritetin Publik-Privat" ("Ligji për Kocensionet dhe PPP") dhe Rregulloren shoqëruese “Për vlerësimin dhe dhënien e kocensioneve dhe partneritetit publik-privat” miratuara me VKM Nr. 575 datë 10 korrik 2013 ("Rregullorja e re e kocensioneve"). Në përpjekje për të harmonizuar ligjin me direktivën e BE-së 2004/18/EC[64], ligji dhe rregullorja e re paraqitën konceptin e Partneritetit Publik-Privat (PPP) dhe shtrirjen e të drejtave, përgjegjësive të secilës palë dhe shpërndarjen e riskut gjatë periudhës së kocensionit.

[63] http://www.worldbank.org/sq/neës/press-release/2014/09/29/world-bank-approves-us150-million-project-for-albanias

[64] DIREKTIVA 2004/18/EC E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KËSHILLIT më datë 31 mars 2004 mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik.

Përkufizimi i partneritetit publik privat

Sipas ligjit për Kocensionet dhe PPP, Partneriteti publik privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues (partnerit publik) dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë (partnerit privat), ku partneri privat merr përsipër detyrimin për të ofruar shërbime publike brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve publike. Në parakushtet e nevojshme përfshihet ndërtimi ose rinovimi i infrastrukturës publike dhe/ose operimi dhe mirëmbajtja e saj.

Sipas përcaktimeve të kontratës, partneri privat shpërblehet nëpërmjet pagesave nga partneri publik dhe/ose pagesave nga përdoruesit e shërbimit publik të cilat rregullohen nga partneri publik.

Dhënia e kocensioneve dhe marrëveshjeve të Partneritetit Publik Privat

Figura 12 – Procesi i dhënies dhe monitorimit të kocensioneve



1. Identifikimi i mundësive për ndërtimin e HEC-ve me kocension

Ministria e Energjisë dhe Industrisë mund të identifikojë fushat për t'u dhënë me kocension nëpërmjet shqyrtimit të propozimeve të marra (ndryshe propozimet e pakërkuara) nga investitorët privatë apo institucione të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

Para se të njoftojë për mundësinë për kocension / PPP, MEI do të sigurohet mbi fizibilitetin teknik dhe ndikimin ekonomik, mjedisor dhe shoqëror të çdo marrëveshje, në përputhje me dispozitat e ligjislacionit në fuqi.

Në rastin e propozimeve të marra nga investitorët privatë, këta të fundit kryejnë një studim fizibiliteti i cili paraqitet në Projekt-Propozimin e dërguar MEI-t. Propozimi i dhënë për projektin i nënshtrohet një procesi të vlerësimit teknik në përputhje me VKM Nr. 191, datë 22 mars 2007 "Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të HEC-ve me kocension". Ky vlerësim kryhet nga grupi i ekspertëve të hidro-energjisë, gjeologjisë dhe mjedisit, të caktuar nga Ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratuar nga AKBN në përputhje me Ligjin Nr. 8093, datë 1 mars 1996, "Për rezervat ujore" dhe Ligjit Nr. 8402, datë 10 shtator 1998 "Për kontrollin dhe rregullimin e punimeve të ndërtimit"[65].

2. Procedurat e prokurimit

Nëse projekt-propozimet e marra kthehen në mundësi kocensioni Ministria fton të gjithë aplikantët e interesuar në një procedurë tenderimi të publikuar me anë të një njoftimi të kontratës, në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20 nëntor 2006 "Mbi prokurimin publik" ("Ligji mbi prokurimin publik"). Me anë të vendimit nr. 130 që daton më 12 Mars 2014 Këshilli i Ministrave vendosi që prokurimi i kocensioneve, përfshirë pranimin e projekteve dhe komunikimin me operatorët do të bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: www.app.gov.al.

Kocensionet jepen në përputhje me dispozitën e ligjit Nr. 9643, që daton më 20 Nëntor 2006, dhe e ndryshuar në ligjin "Mbi Prokurimin Publik".

[65] VKM Nr. 191 datë 22 mars 2007 "Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve me kocension"

Sipas ligjit dhe rregullores së kocensionit çdo aplikant merr një trajtim të drejtë dhe jopreferencial, megjithatë neni 7 i ligjit të ri të kocensionit lejon që komisioni i prokurimit të caktojë një bonus deri në 10% të pikëve për propozuesin e projektit. Në rast se, kocensioni i caktohet një investitori të ndryshëm nga propozuesi fillestar, rregullorja e re e kocensionit parashikon kompensimin e propozuesit të projektit nga 0.5% deri në 2% të vlerës së kocensionit bazuar në shtrirjen e studimit të fizibilitetit të përfshirë në projekt-propozimin fillestar.

Çmimi i kontratës vlerësohet kundrejt:

a) Advantazheve më të mëdha teknike dhe ekonomike siç vlerësohen nga Autoriteti Kontraktues, ose

b) Tarifës më të lartë të kocensionit të ofruar për specifikimet teknike të kërkuara në njoftimin e kontratës.

Operatori duhet të garantojë përmbushjen e detyrave të tij deri në 10% të vlerës së investimit, garanci e ekzekutueshme në rastet e zgjidhjes së kontratës apo shkeljes të kushteve kontraktuale.

3. Miratimi i kocensioneve

Të gjitha kontratat e kocensionit janë firmosur nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë në kapacitetin e autoritetit kontraktues nga Këshilli i Ministrave. Pas nënshkrimit të kontratës, operatori harton planin e detajuar të zbatimit. Përpara miratimit, ky plan i nënshtrohet përsëri oponencës teknike shtetërore. Ndërtimi i hidrocentraleve energjetike është subjekt i 10 deri në 20 lejeve dhe licensave nga organe të ndryshme rregullatore, duke përfshirë: lejen mjedisore (vjetore), lejet për ndërtimin (para ndërtimit), leje për përdorimin e burimeve ujore (vjetore), licensë për prodhimin e energjisë (para fillimit të prodhimit), lejen për lidhjen me rrjetin e transmetimit etj.

Termat teknik dhe joteknik të marrveshjeve kocensionare dhe partneritetit publik privat janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen për palët e treta pa pëlqimin e të gjitha palëve përfshirë në marrëveshjen e kocensionit.

Kushtet dhe termat kryesore të marrëveshjeve të kocensionit dhe PPP-ve për ndërtimin e hidrocentraleve janë si më poshtë:

1. Objekti i marrëveshjes

Objekti i marrëveshjes së kocensionit është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe dorëzimi i tij tek Autoritetit Kontraktues (Ministria e Energjisë dhe Industrisë) në perfundim të afatit të kontratës.

2. Kohëzgjatja e Kocensionit

Kocensioni jepet për një periudhë deri në 35 vjet. Periudha e kocensionit mund të zgjatet vetëm në rastin e një Ngjarje të Forcës Madhore ose të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Forma e Shoqërisë Kocensionare

Pas hyrjes në fuqi të kontratës së kocensionit Kocensionari duhet të themelojë Shoqerinë kocensionare, të cilës do ti kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Kocensionarit sipas kontratës së kocensionit. Forma e shoqërisë duhet të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionare”, me objekt të vetëm të veprimarisë tregtare aktivitetin që ushtrohet në kuadër të kontratës së kocensionit. Kjo shoqëri do të ketë një kohëzgjatje në përputhje me afatin e kontratës së kocensionit.

4. Karakteristikat e hidrocentralit

Në kontratë përcatohen qartë emri, vendndodhja, numri dhe karakteristikat teknike të HEC-ve dhe prodhimi vjetor i parashikuar i energjisë elektrike. Gjithashtu, përcaktohet fuqia e instaluar e hidrocentralit të cilën Kocensionari duhet të zbatojë në projektin e ndërtimit.

5. Vlera e Investimit

Vlera që kocensionari do të investojë në total shprehet në vlerë monetare në kontratë. Nga kjo vlerë në formë përqindjeje përcaktohet masa e investimit që duhet të shkojë për makineri dhe pajisje. Duke qënë se kjo vlerë bazohet në vlerësime, në varësi të ndryshimeve qe mund të ndodhin ajo mund të ndryshojë, por vlera e investimit nuk mund të jetë më e vogël se 95% e vlerës së parashikuar.

6. Tarifa kocensionare dhe vlera e riinvestimit

Tarifa kocensionare shprehet në përqindje (%) të prodhimit vjetor të energjisë elektrike. Tarifa e kocensionit është fikse dhe nuk ndryshon deri në përfundim të kontratës së kocensionit. Kocensionari gjithashtu ka detyrimin te riinvestojë një pjesë të investimit fillestar (e dhënë në përqindje) për makineri dhe pajisje, pas 15 ose 25 vjet nga hyrja në fuqi e kontratës.

7. Sigurimi i kontratës

Kocensionari duhet të depozitojë në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, për llogari të Autoritetit Kontraktues një shumë që varion nga 5-10% të vlerës totale të investimit, sipas negociatave të kontratës. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, mirëmbajtje dhe plotësimin e termave të tjera të kontratës për periudhën e kocensionit.

8. Garantimi i përfitimeve të kocensionit

Në përputhje me rregullat e tregut Operatori mund të lidh një marrëveshje për shitjen e energjisë me Furnizuesin Publik me Shumicë dhe do të shesë energjinë e prodhuar me tarifat në fuqi, të përcaktuara nga ERE.

9. Të tjera lidhur me riskun e projektit

Në rastin e veprave komplekse dhe me risk, kontrata parashikon kushtet për ndarjen dhe shtrirjen e riskut lidhur me koston e punimeve dhe karakteristika të tjera mes partnerit publik dhe privat.

Regjistri i kocensioneve.

Deri në 2013, regjistri i kocensioneve mbahej nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me ligjin e vjetër të kocensioneve. Ligji i ri përcakton Ministrinë e Financave si përgjegjëse për mbajtjen e Regjistrit të Kocensioneve. Regjistri së bashku më një listë të kocensioneve të hidrocentraleve në fuqi nuk është bërë publike. Një kopje e regjistrit të kocensioneve të HEC-eve është paraqitur në Shtojcën 10 të këtij raporti.

Monitorimi i Kocensioneve

MEI në bashkëpunim me AKBN janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të kocensionit dhe partneritetit publikprivat. AKBN raporton çdo tremujor tek Autoriteti Kontraktues, situatën e kocensioneve në fazën e ndërtimit dhe shkeljet përkatëse. Aktualisht, AKBN është në proces vlerësimi të investimit faktik dhe fuqisë së instaluar për kocensionet që kanë përfunduar fazën e ndërtimit dhe janë në proces prodhimi.

Licensimi i fuqisë prodhuese.

Kur përfundon ndërtimi i HEC-it, Kocensionarët i nënshtrohen një kontrolli përfundimtar teknik, përpara se të aplikojnë për licensimin e fuqisë prodhuese. ERE jep licensa të fuqisë prodhuese bazuar në rregulloret në fuqi. Rregullat dhe praktikat e licensimit për prodhimin, tregtimin dhe furnizimin me energji si dhe regjistri i licensave për çdo lloj license publikohet dhe përditësohet vazhdimisht në faqen zyrtare të internetit të ERE: www.ere.gov.al

Raportet e publikuara për sektorin e fuqisë.

ERE publilkon në tremujorin e parë të vitit pasardhës një raport gjithëpërfshirës për gjëndjen e sektorit të energjisë elektrike gjatë vitit në raportim. Ky raport përfshin të dhëna për a) prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjsë elektrike; b) rregullimin dhe monitorimin e operatorëve të tregut të energjisë elektrike; c) veprimtarinë e licensimit dhe trajtimin e konflikteve; d) zhvillimet në legjislacion; e) marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë, etj..

2.4.5 Kocensionet e dhëna gjatë viteve 1997 - 2014

Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN[66], shteti shqiptar ka firmosur rreth 171 marrëveshje kocensioni për ndërtimin e 502 HEC-eve në të gjithë vendin gjatë periudhës nga viti 1997 në 2013. Vitet 2009 dhe 2013 janë cilësuar si vitet me aktivitetin më të lartë kocensionar. Në vitin 2009 MEI dha 55 kocensione për ndërtimin e 177 HEC-eve që do të kenë një kapacitet instalimi prej 820 MW dhe një prodhim vjetor të përllogaritur prej 3,362 GWh. Bazuar në statusin e progresit të kocensionit, raportuar nga AKBN, vetem 43 nga 177 HEC-e kanë hyrë në prodhim deri në fillimin e vitit 2015, 52 HEC-e janë në ndërtim e sipër dhe 82 HEC-e nuk kanë filluar ende të ndërtohen. Në vitin 2013 MEI dha 46 kocensione për ndërtimin e 130 HEC-eve që pritet ta shtojnë me 484 MW kapacitetin e brendshëm të instaluar dhe me një prodhim vjetor të përllogaritur prej 2,179 GWh. Asnjë prej këtyre kocensioneve nuk ka hyrë në fazën e ndërtimit deri në fillim të vitit 2015.

Grafiku 34 - Numbri i HEC-ve dhënë me koncension



Burimi: Regjistri i kocensioneve raportuar nga AKBN për kete raport

Vlera që do të investohet në bazë të marrëveshjeve të kocensionit në fuqi vlerësohet të jetë mbi 300 miliardë Lek për një kapacitet të instaluar prej 2,113 MW dhe prodhimi vjetor i energjisë llogaritet rreth 9,121 GWh. Nëse marrim në konsideratë prodhimin vjetor të energjisë të Divizionit të Gjenerimit të KESH me një mesatare prej 4,000 GWh, totali i prodhimit të brendshëm vjetor i parashikuar, duke përfshirë Divizionin e Gjenerimit të KESH dhe HEC-et me kocension, tejkalon potencialin energjetik të vendit prej 10,000 GWh parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Energjisë në vitin 2003[67]. *Në vitin 2014, AKBN raportoi 110 HEC në fazën e prodhimit me kapacitet të instaluar prej 295 MW dhe një prodhim të vlerësuar vjetor prej 1.272 GWh (Tabela 20). Sipas ERE-s, në vitin 2014, HEC-et private dhe me kocension (me përjashtim të të atyre të transferuara nga KESH për tek Kurum International Sh.A. në vitin 2013), kishin një kapacitet të instaluar prej 294 MW dhe prodhuan rreth 919 GWh*

Nga 502 HEC-e me kocension, 308 HEC-e me kapacitet të instaluar prej 1,152 MW dhe energji të parashikuar 5,359 GWh nuk kanë filluar ende fazën e ndërtimit. Pjesa e mbetur prej 84 HEC-esh janë në fazën e ndërtimit dhe 110 HEC kanë hyrë në fazën e prodhimit.

[66] Informacioni për HEC-et e dhëna me kocension u raportua nga AKBN për qëllime të analizave në këtë raport.
[67] Strategjia Kombëtare e Energjisë, Tiranë, Korrik 2003 gjendet në faqen e AKBN: www.akbn.gov.al

Tabela 16 – Kocensionet e dhëna dhe faza në të cilën ndodhen

Faza e kocensionit dhe viti kur janë dhënë HPP-të	Numri i HPP-ve	Kapaciteti i instaluar	Prodhimi I pritshëm vjetor	Vlera kontraktuale e investimit
		në MWh	*në GWh*	*(në milionë Lek)*
Në fazë ndërtimi	**84**	**666**	**2,489**	**134,757**
1997	1	100	350	18,060
2007	1	5	22	322
2008	17	53	266	8,204
2009	52	411	1,438	90,885
2010	4	4	16	469
2011	9	94	398	16,816
Faza para ndërtimit	**308**	**1,152**	**5,359**	**152,829**
2008	3	5	14	512
2009	82	340	1,618	43,899
2010	14	11	64	1,076
2011	37	211	1,008	24,799
2012	41	76	345	9,308
2013	130	484	2,179	70,440
2014	1	25	131	2,794
Në fazën e prodhimit	**110**	**295**	**1,272**	**26,473**
Totali	**502**	**2,113**	**9,121**	**314,059**

Burimi: Regjistri i kocensioneve raportuar nga AKBN për kete raport

Sipas kushteve të përgjithshme të kocensionit ndërtimi i HEC-ve duhet të përfundojë brenda dy vitesh nga dhënia e kocensionit. Nga tabela 16 më sipër vërehet se pothuajse të gjitha kocensionet që nuk kanë filluar zbatimin apo janë në fazën e ndërtimit e kanë tejkaluar afatin prej dy vitesh.

Grafiku 35 -Tarifa e supozuar e koncensionit *në milion Lekë*



Grafiku 35 prezanton një përllogaritje të tarifës së kocensionit që do të gjenerohej nëse do të plotësoheshin kushtet e më poshtme:

- HEC-et që do të ishin ndërtuar në dy vjet nga data e kocensionit, do të fillonin prodhimin në vitin e trete dhe do të prodhonin energjinë e parashikuar në kontratën e kocensionit;
- Tarifat mesatare[68] të vendosura nga ERE do të zbatoheshin në shitjen e energjisë së gjeneruar nga hidrocentralet e dhëna me kocension;
- Tarifa e kocensionit do të zbatohej për energjinë e parashikuar në çdo kontratë kocensionare;

Siç prezantohet në grafik, bazuar në këtë vlerësim të ardhurat nga tarifa e kocensionit do të ishin 1,739 milionë Lek në vitin 2013 dhe 1,905 milionë në vitin 2014, shifër e cila është 10 herë më e madhe se tarifa e marrë në të dy vitet e treguara në seksionin 2.4.7.

[68] Çmimet mesatare janë përftuar si mesatare lineare e tarifave të aplikuara nga ERE për HEC-et private dhe HEC-et e reja nën kocension. Këto tarifa publikohen dhe përditësohen vazhdimisht në faqen e internetit të ERE-s: www.ere.gov.al.

Kocensionet e dhëna - Kostoja e energjisë

Grafiku 36 - Kosto e instaluar për KW (*Lekë për KW)*



Burimi: Regjistri i kocensioneve raportuar nga AKBN

Bazuar në informacionin e dhënë nga AKBN kostot e investimit[69] për MW të instaluar varion nga 11 mijë Lek deri në 1,200 mijë Leke.

Grafiku 36 tregon të dhënat sipas kontratave të kocensionit. AKBN dhe MEI nuk mund të japin informacion mbi kostot faktike të investuara dhe kapacitetin e instaluar. Nuk ka korrelacion të qartë në një krahasim të thjeshtë të nivelit të investimeve dhe kapacitetit të instaluar siç tregohet ne grafikun në të majtë.

Analiza duhet të thellohet më tej në bazë të karakteristikave të HEC-eve dhe të zonës përreth. Një Analizë e tillë mund të shërbejë edhe si bazë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së HEC-eve.

[69] MEI e dërgoi zyrtarisht këtë informacion tek Sekretariatit të ALBEITI për qëllim të këtij Raporti dhe ALBEITI autorizoi prezantimin e tij në këtë raport.

2.4.6 Kontributi në prodhimin e brendshëm bruto

Kontributi i sektorit te energjisë elektrike, duke perfshirë prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen përllogaritet të jetë rreth 27.8 miliardë Lek ose 2.36% e PBB-së në vitin 2013 dhe 25.8 miliard Lek ose 1.78% e PPB-së në 2014. Gjate 5 viteve të fundit, kontributi më i lartë u shënua në vitin 2010 me 41.7 miliardë ose 3.4%, vit kur prodhimi neto arriti nivelin maksimal në 7,674 GWh si rrjedhojë e kushteve të favorshme hidrike në vend .

Ky kontribut relativisht i ulët është rezultat i pozicionit dominues të tregut të rregulluar, ku tarifat e rregulluara janë disa herë më të ulta se çmimet mesatare të eksportit ose importit[70].

Grafiku 36 - Kontributi në PBB % dhe milione Lekë



Burimi: INSTAT – www.instat.gov.al

Në vitin 2013 dhe 2014, rreth 87% dhe 72% e prodhimit neto të energjisë elektrike u gjenerua nga Divizioni i gjenerimit pranë KESh.

Sipas rregullave të tregut, për shkak të defiçitit të vazhdueshëm në bilancin e energjisë elektrike, prodhuesi kryesor i energjisë elektrike - Divizioni i Gjenerimit në KESh e shet pothuajse të gjithë prodhimin me çmimet e rregulluara nga ERE të cilat janë disa herë më të ulta se çmimet mesatare për importin dhe çmimet e rregulluara për HEC-et me kocension.

Grafiku 38 – Tarifat e rregulluara nga ERE cmimet mesatare në import / eskport në Lek/KWh



Burimi: ERE – Raporti vjetor 2014 – www.ere.gov.al.

Gjatë këtyre viteve, Divizioni i Gjenerimit pjesë e KESH-it e ka shitur energjinë elektrike tek furnizuesi publik me shumicë me tarifa të rregulluara që variojnë nga 0.4 Lek për KWh në vitin 2010 në 1 Lek për KWh në vitin 2013 dhe 2014. Këto tarifa ishin disa herë më të ulta se çmimi që KESH do të kishte përfituar nëse energjia do të ishte eksportuar gjatë këtyre viteve.

Nëse i gjithë prodhimi do të shitej me çmimet e tregut ndërkombëtar, kontributi në PBB do të rritej mbi nivelin 2%.

[70] Çmimet e importit dhe eksportit luhaten sipas kërkesës dhe furnizimit me energji në tregun ndërkombëtar.

Bilanci i tregtisë së jashtme

Divizioni i Gjenerimit KESH eksporton tepricat ditore të energjisë së prodhuar përtej energjisë së nevojshme për përdorim të brendshëm. Në rast se energjia e prodhuar në vend nuk mjafton për të mbuluar nevojat për përdorim dhe humbjet, KESH Gen, FPSH dhe FPP importojnë energji në tregun ndërkombëtar. Serbia dhe Zvicra paraqiten si partnerët kryesorë në importin dhe eksportin e energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar me mbi rreth 70% të importeve dhe eskporteve përgjatë viteve 2011 – 2014.

Tabela 17 – Eksportet dhe importet e energjisë elektrike në vitet 2011 - 2014[71]

	2011	2012	2013	2014
Eksportet				
Energjia e eksportuar në *GWh*	1,225	288	938	84
Vlera e energjisë së eksportuart (*në milionë Lek)*	6,672	1,972	4,123	595
Çmimi mesatar në eksport Lek / KWh	**5.45**	**6.85**	**4.39**	**7.06**
Importet				
Energjia e importuat në *GWh*	3,003	3,394	1,674	3,219
Vlera e energjisë së importuar (*në milionë Lek)*	22,575	30,105	11,310	23,010
Çmimi mesatar në import Lek / KWh	**7.52**	**8.87**	**6.76**	**7.15**

Burimi: Raportuar nga Administrata Doganore Shqiptare

Kontributi i humbur i humbjeve në rrjet

Humbjet në rrjetin e shpërndarjes arritën nivelin 45.04% të energjisë totale transmetuar në sistemin e shpërndarjes në vitin 2013 (një rritje prej 20% nga shifra në vitin 2011). Në 2014 humbjet filluan të rekuperohen, përmes veprimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare dhe OSHEE në luftën kundër lidhjeve informale të energjisë dhe mbledhjen e pagesave të prapambetura. Megjithatë humbjet, përfaqësojnë ende një pjesë të madhe të kërkesës për energji në vend.

Nëse humbja e energjisë do të ishte eksportuar në çmimet e tregut ndërkombëtar në 2014, do të gjeneronte një të ardhur prej 19 miliard Lek (2013: të ardhura jo më pak se 14.5 miliard Lek deri në 22.3 miliard Lek). Nëse vlerësohet me çmimet e tregut ndërkombëtar energjia e humbur përbënte mesatarisht rreth 1.4% të PBB në 2014.

Tabela 18 –Kosto oportune e humbjeve në rrjet

	2011	2012	2013	2014
Humbjet në rrjet në GWh[72]	2,179	3,250	3,306	2,783
Humbjet në % të energjisë së shpërndarë[73]	37.58%	44.96%	45.04%	37.81%
Kontributi i humbjeve vlerësuar me çmimet mesatare të importit *(në miliard Lek)*	16.4	28.8	22.3	19.9
Kontributi në PBB	1.3%	2.2%	1.7%	1.4%
Kontributi i humbjeve vlerësuar me çmimet mesatare të eksportit *(në miliard Lek)*	11.9	22.3	14.5	19.6
Kontributi në PBB	0.9%	1.7%	1.1%	1.4%

[71] Administrata Doganore Shqiptare raportoji informacion për sasinë, vlerën dhe vendet e importit dhe eksportit të energjisë elektrike në periudhën 2011 - 2014 për qëllime të analizave në këtë raport.
[72] "Bilanci i energjisë 2000-2014" – www.instat.gov.al.
[73] ERE – Raportet vjetore 2009-2014 – www.ere.gov.al.

2.4.7 Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit

Shteti shqiptar merr pjesën e tij nga vlera e krijuar nga skektori hidroenergjitik nëpërmjet:

- Tatimit të veprimtarisë
- Taksave / tarifave, dhe
- Dividendëve apo fitimit nga shitja e investimeve direkte në sektorin e hidro-energjisë

Figura 13 – Shpërndarja e të ardhurave nga sektori i hidro-energjisë



Të ardhurat kryesore që lidhen drejtpërdrejtë me sektorin e hidro-energjisë janë paraqitur si më poshtë:

Tarifa kocensionare dhe të ardhura të tjera sipas marrëveshjeve

Tarifa kocensionare i paguhet Autoritetit Kontraktues në përqindje mbi vlerën e prodhimit vjetor të energjisë elektrike dhe çdo përfitimi tjetër që rrjedh nga marrëveshja. Kjo përqindje është pjesë konfidenciale e marrëveshjes dhe ndryshon në kocensione të ndryshme. Tarifa përllogaritet në përqindje mbi çdo faturë mujore të energjisë së shitur tek KESH dhe mblidhet nga KESH për llogari të Autoritetit Kontraktues, në përputhje me Urdhërin Nr. 4 datë 9 janar 2012 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, përgjegjëse për sektorin e energjisë në atë kohë.

Përveç tarifës së kocensionit, HEC-et me kocension mund të jenë subjekt gjobash të konsiderueshme për mospërputhje me marrëveshjen e kocensionin apo të PPP-së.

Marrëveshja e kocensionit parashikon penalitete për:

- Mosparaqitjen në kohë e projektit të zbatimit për miratim;
- Moszbatimin e kushteve dhe afateve të kontratës;
- Moskryerjen e investimeve deri në të paktën 95% të vlerës së rënë dakort;
- Mosrealizimin i fuqisë së instaluar sipas projektit;
- Mosrealizimin e prodhimit të energjisë elektrike parashikuar në marrëveshje etj.

Autoriteti kontraktues përfiton garancinë e kontratës deri në 10% të vlerës së investimit, në rast se zgjidh kontratën, si pasojë e moszbatimit të kushteve kontraktuale nga partneri privat.

Të ardhurat nga investimet dhe privatizimevet e shoqërive me pronësi shtetërore

Sektori i energjisë elektrike dominohet nga shoqëri me pronar Shtetin përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Shteti si pronar përfiton dividentët e shpërndarë nga fitimi i Shoqërive si dhe të ardhura nga shitja pjesore ose tërësore e aksioneve.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi të ardhurat neto të shoqërisë. Deri në dhjetor 2013, tatimi mbi fitimin në Shqipëri përllogaritej në masën 10% të fitimit të tatueshëm në përputhje me "Ligjin për tatimin mbi të ardhurat" Nr. 8438, datë 28 Dhjetor 1998, ndryshuar. Më 1 Janar 2014, norma e aplikushme e tatimit mbi fitimin u rrit në 15%. Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin e hidroenergjisë.

Tarifat për licensimin dhe rregullimin e sektorit të energjisë elektrike

Të gjitha tarifat për licensimin për prodhimin, tregtimin, furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë janë paguar në kohën kur licensa është dhënë modifikuar ose transferuar sic është vendosur nga ERE. ERE mbledh çdo vit nga të licensuarit pagesat e rregullimit të cilat përllogariten mbi bazën e të ardhurave nga shitja realizuar nga aktiviteti i licensuar. Këto të ardhura shërbejnë për të mbuluar kostot e institucionit, dhe si të tilla mbeten në buxhetin e EREs.

Të ardhurat nga pagesat e lidhura direkt me aktivitetin në sektor

Të ardhurat e gjeneruara nga pagesat e lidhura drejtpërdrejtë me aktivitetin në sketor, siç janë tarifa kocensionare, tatimi mbi fitimin, dividentët dhe të ardhurat nga privatizimi në vitin 2013 arritën në 16 miliardë Lek, ndërsa të ardhurat në vitin 2014 ishin më pak se 1 miliardë Lek. Rezultati në vitin 2013 përfshin ndikimin e privatizimit të hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit, Bistricës 1 dhe Bistricës 2 tek Kurum International Sh.A. në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013. Nëse ky efekt nuk do të ishte, të ardhurat e gjeneruara nga të njëjtat pagesa do të ishin të krahasueshme me të ardhurat në vitin 2014.

Prodhimi hidro-energjisë është dominuar nga KESH, i cili përfaqëson kontribuesin kryesor në hidro-energji. Megjithatë, siç është paraqitur në seksionin 2.4.5 një numër i madh i kocensioneve janë në fazën e ndërtimit ose fazën e para-ndërtimit. Nëse këto kocensione do të kishin hyrë në prodhim brenda afatit prej 2 vitesh nga data e kocensionit, tarifat e kocensioneve për vitin 2013 dhe 2014 do të kishin qenë respektivisht 1.7 miliardë Lek dhe 1.9 miliardë Lek.

Tabela 22 – Të ardhurat nga pagesat e lidhura direkt me aktivitetin në sektorin e hidro-energjisë

Në milion Lek

	2013				2014			
	ERE	KESH	Buxheti i Shtetit	Total	ERE	KESH	Buxheti i Shtetit	Total
Tarifa kocensionare	-	133	-	133	-	190	-	190
Pagesat rregullatore	23	-	-	23	72	-	-	72
Tatimi mbi fitimin (*)	-	-	520	520		-	253	253
Dividentët	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga privatizimi	-	-	15,439	15,439	-	-	-	-
Totali	23	133	15,959	16,115	72	190	253	515
Totali *(duke përjashtuar të ardhurat nga privatizimi)*	23	133	520	676	72	190	253	515

Burimi: Pagesat e raportuara nga te licensuarit dhe Shteti

(*) E ardhura nga tatimi mbi fitimin përfshin informacionin mbi pagesat e tatimit mbi fitimin dhënë nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve vetëm për shoqëritë e përzgjedhura për të raportuar në vitin 2013 dhe 2014. Sistemet e administrimit të informacionit të DPT nuk mund të prodhonin të dhëna statistikore për sektorin. Për këtë arsye, tatimi mbi fitimin nga sektori e hidro-energjisëi prezantuar më sipër nuk është i plotë.

2.5 Transfertat lokale

Renta minerare e arkëtuar nga shitja e naftës, gazit dhe mineraleve është regjistruar në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për Taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 Korrik 2008, i ndryshuar, një pjesë e taksës së rentës minerare do të transferohet tek çdo njësi të qeverisjes vendore ("NJQV "), në përpjesëtim me kontributin e tyre në prodhimin dhe shitjen e mineraleve. Deri në nëntor të vitit 2014, Ligji për taksat kombëtare ka kërkuar që 25% e taksës së rentës minerare i transferohej çdo njësie të qeverisjes vendore ("NJQV"), në përpjesëtim me kontributin e tyre dhe në kuadër të kushteve të ligjit të buxhetit vjetor.

Në vitin 2013, ligji i buxhetit vjetor kufizoi transferimin e rentës minerare në 50% të transfertës së pakushtëzuar. Në kushte të tilla, NJQV-të mund të përfitonin, vetëm nëse pjesa e tyre e rentës minerare (llogaritur si 25% e rentës minerare gjeneruar në zonën e tyre) mund të arrijë mbi vlerën e transfertës së pakushtëzuar llogaritur në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor, nga 101% deri në 150% të transfertës së pakushtëzuar. Në këto kushte, pjesa e transferueshme e rentës minerare mund të ndryshonte nga 1% në 50% *të transfertës së pakushtëzuar*. Në vitin 2014 pjesa e transferueshme e rentës minerare e gjeneruar nga sektori minerar u rrit deri në 80% të transfertës së pakushtëzuar. *Për shkak të ndikimit të formulës së buxhetit vjetor, transferimi i rentës minerare mund të ishte jo në përpjestim me kontributet e NJQV-ve.*

Ministria e Financave njoftoi se pagesat lokale të rentës minerare arritën në **101 milionë Lek** në vitin 2013 dhe **120 milion Lek** në vitin 2014. Këto transferta janë shpërndarë vetëm tek rajonet prodhuese të naftës, ku 35% e totalit të rentës minerare të shpërndarë shkoi për Bashkinë e Patosit në të dy vitet.

Transfertat e rentës minerare tek NJQV-të në prodhimin e naftës përbëjnë rreth 1.2% të rentës minerare të gjeneruar nga sektori i naftës në vitin 2013. Ministria e Financave raportoi se nuk ka transferta të rentës minerare të kryera tek vendet prodhuese në sektorin minerar.

Grafiku 39 - Transfertat e rentes 2013



Grafiku 40 - Transfertat e rentes 2014



Burimi: Raportuar nga Ministria e Finances për qellime te ketij raporti

Ndryshim në Ligjin për Taksat Kombëtare

Më 27 Nëntor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet në Ligjin për taksat kombëtare. Sipas ndryshimeve të propozuara, NJQV-të do të kenë të drejtë të marrin 5% të rentës minerare të gjeneruara nga Shoqëritë që operojnë në zonën e tyre pa marrë parasysh ndonjë transferim të parashikuar në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor.

Administrimi i të ardhurave gjeneruar nga sektori

Të ardhurat e gjeneruara nga të tre sektorët njihen përkatësisht në Buxhetin e Shtetit, Buxhetin e AKBN-së dhe llogaritë financiare të Albpetrol-it sipas të drejtave që ka secilit prej institucioneve. Ministria e Financave dhe institucionet qeveritare që mbledhin të ardhura në të tre sektorët nuk raportuan ndonjë përcaktim apo përdorim të të ardhurave të gjeneruara nga të tre sektorët për zbatimin e projekteve specifice në secilin prej sektorëve gjatë vitit 2013 dhe 2014. Institucionet qeveritare që mbledhin të ardhura informuan se këto të ardhura do të përdoren për të mbuluar kostot e operacioneve të Shtetit dhe institucioneve përkatëse.

2.5 Mbikqyrja rregullatore dhe kërkesat për auditim në Shqipëri

Auditimi i shoqërive private

Në Shqipëri, çdo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ("Ltd" ose "Sh.p.k"), me përjashtim të bizneseve të vogla, i nënshtrohen auditimit ligjor. Ligji mbi Auditimin nr. 10091, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, datë 5 mars 2009 e përkufizon si shoqëri të vogla, ato që përmbushin dy nga kriteret e mëposhtme:

1) Totali i aktiveve është më i vogël se 40 milion Lek
2) Kanë mesatarisht jo më shumë se 30 punonjës, dhe
3) Të ardhurat vjetore nuk i kalojnë 30 milionë Lek.

Shoqëritë anonime (“JSC” ose “Sh.a.”) janë subjekt i auditimit ligjor, pavarësisht madhësisë së tyre. Shoqëritë anonime ("JSC" ose "Sh.a.") janë subjekt i auditimit ligjor pavarësisht nga madhësia e tyre. Auditimi është i bazuar në ligjet, rregulloret, standardet e auditimit dhe praktikat gjerësisht të pranuara në Shqipëri, duke përfshirë edhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Pasqyrat Financiare dorëzohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (www.qkr.gov.al) brenda datës 31 korrik të vitit pasues kalendarik.

Nuk ka kërkesa të veçanta auditimi në lidhje me shifrat e raportuara në EITI.

Aktualisht nuk ka kërkesa të veçanta për auditim performance të kocensioneve dhe marrveshjeve të hidrokarbureve nga ekspertë të pavarur apo të partneriteteteve publik- privat në Shqipëri, qoftë edhe si pjesë e auditimit vjetor të raportimit të shoqërive.

Auditimi i institucioneve qeveritare

Aktiviteti dhe llogaritë e Institucioneve shtetërore auditohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri (KLSH) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e KLSH-së në faqen e tij të internetit: http://www.klsh.org.al/. Udhëzimet dhe standardet e auditimit bazohen në standardet e INTOSAI për auditimin e Qeverisë.

Pronësia e shoqërive private

Informacione mbi aksionarët dhe veprimtarinë e të gjitha Shoqërive që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, mund ti gjeni në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit: http://www.qkr.gov.al/nrc/default1.aspx.

Ky informacion shtrihet deri tek aksionerët direkt të shoqërisë. Aktualisht, Ministria nuk ka një regjistër ku të listohen me detaje aksionarët deri tek individët themelues të shoqërive, kur këto shoqëri kanë strukturë kompleske pronësie dhe nuk janë të listuara në tregun e aksioneve.

3. Pamje e përgjithshme e flukseve të raportuara dhe e shoqërive raportuese

Shoqëritë dhe agjencitë qeveritare duhet të raportojnë taksat dhe të ardhurat. MSG përcakton pagesat dhe Shoqëritë që do të përfshihen në raportimin në bazë të peshës së të ardhurave që rrjedhin në buxhetin e Shtetit nga industria nxjerrëse dhe sektori i hidro-energjisë.

Të licensuarit e përzgjedhur duhet të raportonin pagesat e përzgjedhura dhe ndonjë pages tjetër të konsiderushme për vitet 2013 dhe 2014 lidhur me aktivitetin e naftës dhe gazin, aktivitetin minerar dhe atë të hidro-energjisë. MSG, përmes termave të referencës për raportimin EITI, specifikon të ardhurat që duhet të rekordohen siç përshkruhet në vijim.

3.1 Përzgjehdja e pagesave dhe shoqërive raportuese në sektorin e naftës dhe gazit

Figura 14 – Pagesat e përzgjedhura për naftën & gazin



Figura 15 - Pagesat nga Albpetrol



Në përputhje me kërkesat e specifikuara në standardet EITI 4.1[74], MSG zgjodhi për raportim:

1) Të gjitha **pagesat materiale që rrjedhin nga** kushtet e **Marrëveshjeve Hidrokarbure** të tilla si ndarja e prodhimit të naftës dhe bonuset (shiko seksionin 2.2.2 dhe 2.2.3). Këto të ardhura mblidhen nga Albpetrol për zonat nën administrimin e tij ose nga AKBN për zonat nën administrimin e AKBN-së. Aktualisht, marrëveshjet e hidrokarbureve të dhëna për zonat nën administrimin e AKBN-së nuk kanë hyrë në fazën e prodhimit dhe për këtë arsye nuk gjeneruan pagesa për ndarjen e naftës në vitin 2013 dhe 2014.

2) Të gjitha pagesat materiale që rrjedhin nga investimet direkte të shtetit në këtë sektor. Këto përfshijnë vetëm dividentë nga Albpetrol në vitet 2013 dhe 2014.

3) **Pagesat me natyrë tatimore** të tilla si renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi dividentët, të cilat lidhen drejtpërdrejt me operacionet hidrokarbure. Përveç pagesave të renditura në kërkesat e EITI 4.1, MSG vendosi të përfshijë edhe pagesat për gjobat tatimore dhe TVSH-në pasi këto kanë treguar një fluks të konsiderueshme të ardhurash në Buxhetin e Shtetit në vitet e mëparshme.

4) Pagesat të tjera më të mëdha se USD 50,000 për pagesat e bëra ndaj Shtetit dhe 5,000 USD për pagesat e bëra ndaj NJQV-ve. MSG përzgjodhi për raportim të gjitha shoqëritë e naftës dhe gazit në vitin 2013 dhe 2014. (Lista e detajuar jepet në Shtojcat 1.1 dhe 1.2).

[74] KËRKESA E EITI-it 4.1 liston pagesat e detyrueshme për t'u përfshirë në rakordim.

Në Shqipëri, MSG-ja (përmes termave të referencës) ka përjashtuar pagesat që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e naftës dhe gazit të tilla si: taksat e importit dhe taksat vendore që kanë natyrë të përgjithshme dhe zbatohen njësoj për të gjitha industritë. Të tilla taksa dhe tarifa janë të ngjashme për të gjitha industritë dhe nuk kanë kërkesa të veçanta për zbatim në sektorin e naftës dhe gazit. Gjithashtu, tarifat për lejet vjetore nuk paraqesin pagesa thelbësore nga sektori dhe prandaj nuk janë përfshirë në rakordim.

Gjithsesi, në rastet kur taksat vendore paguar një NJQV-je u rapuarn në vlerën mbi 50,000 USD, këto u përzgjodhën në rakordim si pagesa të konsiderueshme.

Pagesat Sociale

U kërkua që shoqëritë të raportonin pagesat sociale të kryera në shumën mbi 5 milion Lek. Këto pagesa u pranuan si deklarime të njëanshme dhe nuk u kërkua rakordimi me deklarimin e marrësit të pagesës.

Pagesat në natyrë

Të licensuarit duhet të raportonin të gjitha kontributet e dhëna në natyrë Shtetit ose shoqërive të zotëruara prej tij.

3.2 Përzgjehdja e pagesave dhe Shoqërive raportuese në sektorin minerar

Figura 16 - Pagesat e përzgjedhura nga sektori minerar



Pagesat e përzgjedhura në sektorin minerar përfshijnë të gjitha **pagesat me natyre tatimore** të tilla si renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi dividentit, të cilat janë **të lidhura direkt me operacionet minerare.** Përveç këtyre pagesave, MSG vendosi të përfshijë edhe pagesat për gjobat tatimore dhe TVSH pasi këto kanë treguar një rrjedhë të konsiderueshme pagesash në Buxhetin e Shtetit në vitet e mëparshme.

Shoqëritë e përzgjedhura në sektorin minerar u udhëzuan të raportonin detaje për pagesa të tjera të konsiderueshme për shtetin që tejkalonin vlerën 50,000 USD dhe për njësitë e qeverisjes vendore mbi 5,000 USD.

Në sektorin minerar, MSG dhe EITI Shqipëri përzgjodhën për raportim të gjitha shoqëritë që kishin licensë kërkimi në përpjekje për të zbuluar pagesa të rëndësishme nga aktiviteti i kërkim-zbulimit dhe prodhuesit më të mëdhenj minerar bazuar në kriteret e mëposhtme:

- ✓ për nën-sektorin e kromit, përzgjedhja përfshiu të gjitha shoqëritë që raportojnë prodhimin e më shumë se 3,000 ton në vit;
- ✓ për nën-sektorin e bakrit, përzgjedhja përfshiu të gjitha shoqëritë që raportojnë prodhimin e më shumë se 100 ton në vit;
- ✓ për nën-sektorin e nikelit, të gjitha shoqëritë që raportuan prodhim mbi 10,000 ton në vit;
- ✓ për nën-sektorin gëlqeror, të gjitha shoqëritë që raportuan prodhim mbi 20,000 ton në vit dhe për argjilën mbi 100,000 ton në vit;
- ✓ për bitumin dhe nën-sektorin e rërës së bitumit, të gjitha shoqëritë që raportuan prodhim mbi 10,000 ton në vit.

Përzgjedhja përfshinte 81 subjekte raportuese për vitin 2013 dhe 99 subjekte raportuese për vitin 2014. (lista e subjekteve raportuese të përzgjedhura në sektorin e minerar paraqitet në Shtojcat 2.1 dhe 2.2).

Për vitin 2012, subjektet raportuese të përzgjedhura përfshinin gjithashtu të gjitha Shoqëritë që raportonin vlerë prodhimi më të madhe ose të barabartë me 750,000 dollarë, pavarësisht nga sasitë e prodhuara për secilin lloj minerali. Ky kriter nuk është zbatuar në vitet 2013 dhe 2014, për shkak se AKBN nuk ka siguruar informacionin në kohën e përzgjedhjes së subjekteve në korrik 2015.

Nuk pati raportime të pagesave të konsiderueshme lidhur me kocensionet minerare në vitin 2013 dhe 2014.

Përzgjedhja mbulon 85% të vlerës së përllogaritur të prodhimit minerar për vitin 2013 dhe 87% së përllogaritur të prodhimit minerar për vitin 2014. Megjithatë, kjo analizë është e kufizuar për shkak se informacioni i dhënë nga AKBN për prodhimin minerar për vitet 2013 dhe 2014 nuk përfshin detaje të cilësisë së mineraleve (përqëndrimi). Në këto rrethana, prodhim minerar nuk mund të vlerësohet duke përdorur çmimet ndërkombëtare të mineraleve. Përveç kësaj, siç shpjegohet në seksionin 2.3.1, AKBN njofton se të dhënat e raportuara të prodhimit bazohen në vetë-deklarimet e dorëzuara nga të licensuarit. AKBN nuk ka kryer verifikime të mëtejshme për të konfirmuar sa është prodhimi i nxjerrë. Më tej, vetëm 70% e licensave gjithsej, raportuan prodhimin e tyre në vitin 2013. Ky raport u rrit në 85% në vitin 2014. Duke pasur parasysh këto fakte, mund të mendohet se ka pasiguri të konsiderueshme në të dhënat e prodhimit dhe vlerën e prodhimit të raportuar në vitin 2013 dhe 2014.

3.3 Përzgjedhja e pagesave dhe shoqërive raportuese në sektorin e hidro-energjisë

MSG vendosi të përfshijë sektorin hidro-energjitik në kuadrin e raportimit EITI duke filluar nga viti 2013. Për të vlerësuar rëndësinë e sektorit dhe pagesat kryesore nga sektori, MSG kontraktoi Deloitte Audit Albania Sh.pk në 11 Shkurt 2015 "Për të kryer një studim për vlerësimin e kontributit të sektorit të hidro-energjisë për ekonominë Shqiptare dhe përfshirjen e tij në kuadrin të raporteve EITI".

Studimi solli faktet kryesore lidhur me:

- ✓ Pjesëmarrjen e Shtetit në sektor, flukset kryesore të pagesave dhe marrëdhëniet midis Shtetit dhe shoqërive shtetërore;
- ✓ Pagesat materiale të gjeneruara nga shoqëritë në sektor në fazën e prodhimit dhe para-prodhimit bazuar në ligjin dhe rregulloret në fuqi; dhe
- ✓ Kufirin për përzgjedhjen e pagesave material (me peshë në totalin e të ardhurave nga sektori)

Studimi zbuloi se flukset materiale paguhen kryesisht nga shoqëritë në fazën e prodhimit, ndërsa KESH, prodhuesi shtetëror i energjisë kontribuon pjesën me të madhe të pagesave. MSG përzgjodhu për raportim 10 prodhuesit më të mëdhenj të hidro-energjisë, duke përfshirë KESH, të cilët gjeneronte 96% të prodhimit në vitin 2013 dhe 87.9% të prodhimit në vitin 2014. Në përpjekje për të zbuluar ndonjë pagesë materiale në fazat para-prodhimit, MSG vendosi të përfshirjë në procesin e raportimit 5 investitorët më të mëdhenj, të cilat përfaqësonin rreth 70% të totalit të investimeve private për kocensionet e dhëna në hidro-energji, bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN. (Lista e subjekteve të përzgjedhura raportuese është paraqitur në Shtojcën 3.1 dhe 3.2)

Pagesat e përzgjedhura për rakordim në sektorin e hidro-energjisë përfshijnë:

Figura 17 - Pagesat e përzgjedhura nga sektori hidro-energjise



Figura 18 - Payments streams paid by KESH



1) **Tarifa kocensionare**, të cilat paguhen në përputhje me marrëveshjen kocensionare bazuar në prodhimin vjetor të gjeneruar nga shoqëritë që operojnë HEC-t me kocension; dhe

2) **Pagesat me natyrë tatimore** të tilla si renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi dividentët të cilat lidhen direkt me aktivitetin në sektor. Përveç këtyre pagesave, MSG vendosi të përfshijë edhe pagesat për gjobat tatimore dhe TVSH pasi këto kanë treguar një rrjedhë të konsiderueshme pagesash në Buxhetin e Shtetit në vitet e mëparshme.

3) Investimet dhe pagesat e tjera të kryera nga KESH ndaj Shtetit në cilësinë e aksionerit të saj.

4) Shoqëritë që e përzgjedhura në sektorin e hidro-energjisë u udhëzuan të raportonin detaje për pagesa të tjera të konsiderueshme për shtetin që tejkalojnë vlerën 50,000 USD dhe për njësitë e qeverisjes vendore mbi 5,000 USD.

3.4 Kufizime të tjera në analizën e pagesave të rëndësishme

Sistemet e adminsitrimit të informacionit të Qeverisë nuk mund raportonin informacion të veçantë për të ardhurat e gjeneruara nga çdo sektor sipas fluskeve të të ardhurave. Ne kuptojmë që të ardhurat dhe shpenzimet e Qeverisë janë regjistruar në sistemin e administrimit të parasë: Sistemi i Thesarit. Ky sistem mund të japë informacion të përditësuar për të ardhurat e gjeneruara nga çdo taksë. Megjithatë, nuk mund të identifikojë dhe të regjistrojë veçmas të ardhurat në total dhe sipas taksave gjeneruar nga sektori i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe i hidro-energjisë.

Në mungesë të këtij informacioni, MSG nuk mund të marrë informacion të saktë dhe të plotë nga sistemet e informacionit të Qeverisë për totalin e përgjithshëm të të ardhurave të krijuar për secilën nga të ardhurat e mbledhura nga sektori i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe i hidro-energjisë.

Përveç kësaj, **sistemet e informacionit të Qeverisë nuk mund të prodhojnë informacion mbi të ardhurat e përgjithshme të paguara nga çdo licensë individuale** për shkak të arsyeve të mëposhtme:

1. Shoqëritë mund të kenë një ose më shumë licensa, megjithatë nuk i kontabilizojnë taksat dhe pagesat veçmas për licensë individuale, por për të gjithë biznesin i cili vepron me një numër unik të identifikimit tatimor (NUIS). **Për këtë arsye, sistemet e informacionit të Qeverisë mund të nxjerrin të dhëna për tatimet e paguara nga një NUIS, por jo për taksat e paguara nga çdo licensë.**
2. Çdo institucion publik që mbledh të ardhura dhe mban sistemin e tij të kontabël për për regjistrimin dhe administrimin e pagesave të bëra nga secili NUIS. Më konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Administrata Doganore Shqiptare, Drejtorite e Taksave vendore, Ministritë dhe subjektet e tjera publike, të cilat mbledhin të ardhura mbajnë të dhënat e tyre për të ardhurat e përllogaritura dhe pagesat e bëra nga çdo NUIS, por ky informacion nuk konsolidohet në sistemin e informacionit të Qeverisë për të siguruar infromacion për të ardhurat e mbledhura nga çdo NUIS individualisht. **Prandaj, MSG nuk mund të marrë informacion për të ardhurat e përgjithshme të paguar çdo shoqëri e licensuar në një vit fiskal me qëllim identifikimin e subjekteve me flukse të konsiderueshme pagese.**

Për më tepër, edhe vete sistemet e adminitrimit të pagesave dhe kontabilitetit të mbajtura veçmas nga çdo subjekt publik (duke përfshirë edhe organet tatimore) nuk mund të japin informacion të ndarë për të ardhurat nga sektori i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe i hidro-energjisë. Ne kuptojmë se klasifikimi sektorëve në sistemet e tyre të administrimit nuk është i programuar në mënyrë që të përfshijë të licensuarit që operojnë në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës dhe gazit, minierave dhe sektorin e hidro-energjisë. Prandaj, MSG-të nuk mund të marrin informacion të saktë dhe të plotë për totalin e të ardhurave të gjeneruar secili sektor më vete në total dhe sipas llojit të pageses apo taksës.

4. Qasja, metodologjia dhe puna e kryer

Ne e kryem punën tonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën nr. ALBEITI SSS/004 ("Kontrata jonë e Angazhimit") datë 14 korrik, 2015. Qëllimi i angazhimit tonë ishte përpilimi i raportit EITI për vitet 2013 dhe 2014 në përputhje me standardin EITI publikuar në korrik 2013, dhe ndryshuar në janar 2015.

Në përputhje me qëllimin tonë të punës kemi listuar procedurat listuar në vijim:



A. Mbledhja e informacionit të nevojshëm kontekstual në përputhje me kërkesat në vijim:

a) Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe regjimit fiskal që rregullon industrisë nxjerrëse (Kërkesa 3.2);

b) Paraqitja e pamjes së përgjithshme të industrisë nxjerrëse, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të rëndësishëm në kërkim-zbulim (Kërkesa 3.3);

c) Kontributi i industrive nxjerrëse në ekonomi për vitet fiskale të mbuluar nga raporti EITI (Kërkesa 3.4) deri ku mundësohet nga analizat dhe informacionet e publikuara nga Instituti Shqiptar i Statistikave;

d) Të dhënat për prodhimit në vitet fiskal mbuluar nga raporti EITI (Kërkesa 3.5);

e) Informacion në lidhje me pjesëmarrjen e Shtetit në industritë nxjerrëse dhe në sektorin hidro-energjitik (Kërkesa 3.6);

f) Shpërndarja e të ardhurave të industritë nxjerrëse (Kërkesa 3.7);

g) Çdo informacion shtesë kërkuar nga MSG mbi administrimin e të ardhurave nga industria dhe shpenzimet (Kërkesa 3.8);

h) Informacion për regjistrin e të licensuarve (Kërkesa 3.9) dhe procesi për dhënien e licensave (Kërkesa 3.10);

i) Një përshkrim kompakt i hapave dhe udhëzimeve të licensimit, kërkesave dhe institucionet e përfshira për secilën prej industrive të analizuara në këtë raport;

j) Çdo informacion i kërkuar nga MSG mbi strukturën dhe analizën për gjithë zinxhirin e pronësisë së shoqërive të licensuara deri tek përfituesi final i të adhurave (Kërkesa 3.11);

k) Çdo informacion i kërkuar nga MSG për kontratat (Kërkesa 3.12).

Procesi dhe qasja për mbledhjen dhe analizën e informacionit kontekstual

Ne kryem një vlerësim paraprak të informacionit kontekstual përmes **përmbledhjes dhe analizave të informacionit të mëposhtëm**:

- Ligjet dhe rregulloret e zbatuara, duke përfshirë edhe marrëveshjet e qeverisjes dhe politikat tatimore;
- Konkluzionet dhe rekomandimet nga raportet e mëparshme në raportet EITI duke përfshirë edhe komentet nga procesi fillestare i validimit.
- Faktet dhe procedurat e publikuara në faqet e internetit të:
    - Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë - www.energjia.gov.al,
    - Ministrisë së Financave - www.financa.gov.al/;
    - Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes - www.ekonomia.gov.al/;
    - Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve – www.tatime.gov.al;
    - Administratës Doganore Shqiptare – www.dogana.gov.al;
    - AKBN-së – www.akbn.gov.al/
    - Albpetrol-it – www.albpetrol.al/;
    - Institutit Shqiptar të Statistikave – www.instat.gov.al/;
    - Entit Rregullator të Energjisë - www.ere.gov.al/;
    - KESH – www.kesh.al/;
    - OSHEE – www.oshee.al/;
    - OST – www.ost.al; and
    - Shoqëritë më të mëdha që operojnë në sektorin privat të naftës dhe gazit, sektorin minerar dhe të hidro-energjisë: www.bankerspetroleum.com; www.albchrome.al; www.beralb.com; www.devollhydropower.al; www.energji-ashta.al etc.

Bazuar në përmbledhjen paraprake dhe analizën e informacionit kontekstual hartuam format raportimit për të mbledhur informacion i cili nuk ishte publik / i aksesueshëm në faqet e internetit të institucioneve qeveritare në korrik 2015.

Subjektet publike dorëzuan raportimin e informacionit kontekstual përmes emailit nga muaji gusht deri në dhjetor 2015. Ne mbodhëm, analizuam dhe konfirmuam nëpërmjet pyetjeve informacionin e marrë nga institucionet publike.

Ne identifikuam dhe analizuam kufizimet dhe pengesat lidhur me analizën dhe publikimin e informacionit kontekstual në raport, kur kjo ishte e nevojshme.

Kufizime dhe limitime

Puna jonë është kufizuar në mbledhjen dhe analizimin e të dhënat të paraqitura në këtë studim, në përputhje me termat e referencës pjesë integrale e kontratës sonë. Puna jonë nuk përfshin dhënien e sigurisë apo rakordimin e të dhënave dhe informacionit konstektual paraqitur në këtë studim. Të gjitha burimet e informacionit janë të referuara qartë në të gjithë studimin.



B. Qasja për mbledhjen dhe rakordimin e pagesave

Në përputhje me rolin e Administratorit përcaktuar në standardin EITI dhe termat e referencës pjesë integrale e kontratës sonë së angazhimit, për rakordimin e pagesave të konsiderueshme, ne:

- Rishikuarm kufijtë e materialitetit, subjektet dhe pagesat e përzgjedhura për raportim nga Grupi Shqiptar i Punës. Komentuam, sipas rastit, për kufizimet e të dhënave të përdorura në përcaktimin e materialitetit dhe përzgjedhjen subjekteve dhe pagesave për rakordim.
- Bazuar në pagesat e përzgjdhura për rakordim nga Grupi Shqiptar i Punës për EITIn, hartuam formularët draft të raportimit për rishikim dhe miratim nga Sekretariati i EITI-t në Shqipëri dhe Grupi Shqiptar i Punës.
- Ligjëruam një seminar të organizuar nga EITI Shqipëri më 27 korrik 2015, ku dhamë udhëzimet dhe sqarimet për procesin e rakordimit si dhe për përpilimin dhe dorëzimin e raportimit nga shoqëritë që operojnë në sektorin e naftës dhe gazit, sektorin minerar dhe sektorin e hidro-energjisë;
- Shpërndamë formularët dhe instruksionet për raportm me CD pjesmarrësve në seminar dhe me email të gjitha shoqërive të përzgjedhura për raportim. Në shumicën e rasteve informacioni i marrë për shoqëritë e përzgjedhura si NUIS, personat dhe të dhënat e kontaktit (email, numer telefoni), adresat, etj. Ishte i gabuar. Kjo e vështirësoi procesin e mbledhjes dhe krahasimit të pagesave duke e shtyrë atë përtej afateve të përcaktuara;
- Mblodhëm të dhënat për pagesat raportua nga institucionet publike dhe shoqëritë e licensuara dhe ndërtuam bazën për krahasimin e detajuar të pagesave. **Institucionet publike dhe shoqëritë e licensuara e dorëzuan raportimin e tyre elektronik me email nga data 14 gusht në 1 dhjetor 2015, përtej afatit për raportim të përcaktua më 31 gusht 2015**;
- Informuam në mënyre të vazhdueshme AlbEITI-in për statusin e raportimit të institucioneve publike dhe shoqërive të licensuara, në mënyrë që të siguronim bashkëpunimin maksimal të subjekteve raportuese në kohën e përcaktuar në kontratën tonë të angazhimit;
- Krahasuam shumat e raportuara nga institucionet publike me shumat e raportuara nga shoqëritë e licensuara, për të identifikuar ndonjë mospërputhje midis të ardhurave të raportuara institucionet publike dhe pagesave të raportuara nga të licensuarit;
- Kontaktuam institucionet publike dhe shoqëritë e licensuara për të sqaruar arsyen e mospërputhjeve. **Për shkak të vonesave të konsiderueshme në raportim nga të dyja palët, procesi i hetimit dhe sqarimit të mospërputhjeve u zgjat deri në 11 dhjetor 2015;**
- Rakorduam dhe krahasuam pagesat përkundrejt informacioneve të tjera të publikuara, duke përfshirë llogaritë e Buxhetit të Shtetit, kur informacion ishte mjaftueshëm i detajuar për të mundësuar krahasimin.
- Përgatitëm draftin e raportit duke përmbledhur rezultatet e punës dhe mësimet e nxjerra, dhe rekomandimet për përmirësime si dhe përditësimin mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të viteve të mëparshme;
- Komentuam për kufizimet dhe barrierat e identifikuara gjatë procesit, kur ishte e nevojshme.
- Mblodhëm dhe pasqyruam në raportin tone komentet nga grupet e interest dhe dorëzuam raportit përfundimtar.

Figura 18 në vijim përmbledh procesin e rakordimit dhe raportimit

Figura 18 – Procesi i rakordimit



Ne morëm pasqyrat financiare të Albpetrol dhe KESH, por për shkak se këto shoqëri mbledhin pagesa në natyrë dhe jo në para ne nuk mundëm të krahasonim direkt informacionin për pagesat e raportuara nga shoqëritë e licensura me informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol-it dhe KESH-it për vitet 2013 dhe 2014. **Në kërkuam por nuk morem deri në datën e këtij raporti, pasqyrat financiare të audituara të AKBN-së**.

Ne i kërkuam shoqërive të licensuara të merrnin konfirmimin nga audituesit e jashtëm që informacioni i raportuar është i plotë dhe në përputhje me pasqyrat e tyre financiare të audituara, por kjo kërkesë nuk pati sukses. Ne kuptuam që kjo kërkesë ka kosto shtesë për shoqëritë sidomos kur procesi i auditimit të pasqyrave financiare ka përfunduar. Prandaj, rekomandojmë që MSG të kërkojë që raportimi dhe procedurat verifikuese të integrohen në programin e përvitshëm të punës së auditimit të shoqërisë.

Deri në datën e këtij raporti, 94 nga 108 shoqëri të përzgjedhura raportuan pagesat për vitin 2013 dhe 103 nga 115 shoqëri të përzgjedhura raportuan pagesat për vitin 2014. Nga këto, ne morëm raportimin zyrtar e të nënshkruar nga administrator i shoqërisë vetëm nga 15 shoqëri.

Duke qenë se llogaritë vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Administratës Doganore Shqiptare nuk ofrojnë informacione të detajuara për të ardhurat e mbledhura nga sektori i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe ai i hidro-energjisë, ne nuk mund të krahasonim informacionin e përfshirë në këtë raport me atë të llogaritve vjetore të publikuara nga institucionet.

Standardi EITI nuk ka materialitet për shpjegimin e mospërputhjeve. Si rrjedhojë, të gjitha devijimet që mund të shpjegohen, duhet të shpjegohen pavarësisht nga materialiteti i tyre. Në rastet mospërputhjesh, ne kontaktuam shoqëritë e licensuara dhe institucionet publike për sqarime të mëtejshme.

Për shkak se llogaritë e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nuk paraqiten të ndara sipas industrive, ne nuk mundëm të krahasonim flukset e raportuara nga kjo industri me llogaritë e publikuara të Buxhetit të Shtetit në vitin 2013 dhe 2014.

Ky proces nuk konfirmon që nuk ka patur pagesa të tjera që i janë bërë Shtetit përveç atyre të raportuara, duke qenë se këto shuma mund të mos jenë raportuar nga të licensuarit dhe institucionet shtetërore njëkohësisht.

Rregullimi aktual i EITI nuk kërkon që ne të kryenim testime të detajuara për të zbuluar nëse ka shuma të paraportuara; dhe zbulimi i shumave të paraportuara do të ishte i vështirë edhe nëpërmjet testimit të detajuar të të gjitha shoqërive të licensuara.

Rezultati i procedurave tona paraqitet në kapitullin 6.



Në përfundim të procesit, në mënyrë që të theksonim faktet kryesore dhe të paraqisnim një informacion lehtësisht të kuptueshëm, përmblodhëm gjetjet dhe faktet kryesore të procesit në një përmbledhje ekzekutive dhe në seksionin 2.1, si dhe përpiluam një listë që paraqet lidhjen informacionit të paraqitur në raport më kërkesat e standardit EITI përfshirë në Shtojcën 11 të këtij Raporti.

5 Përmbledhja e rakordimit

5.1 Përmbledhja e rakordimit për vitin 2013 në mijë Lek

Tabela më poshtë përmbledh rezultatet e rakordimit për vitin 2013.

Tabela 20 – Përmbledhja e rakordimit për vitin 2013 2013

Industria	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Raportimi i korrigjuar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Sektori i naftës dhe gazit	12,556,176	10,782,175	(249,276)	1,556,842	12,306,900	12,339,017	37,936	(5,819)
Sektori minerar	2,422,098	1,362,990	(1,097,316)	27,649	1,324,782	1,390,639	33,889	31,968
Sektori i hidro-energjisë	3,255,344	3,999,958	16,069,147	15,275,333	19,324,491	19,275,291	(49,200)	-
Total	**18,233,619**	**16,145,123**	**14,722,555**	**16,859,824**	**32,956,174**	**33,004,947**	**22,625**	**26,149**

5.2 Përmbledhja e rakordimit për vitin 2014 në mijë Lek

Tabela më poshtë përmbledh rezultatet e rakordimit për vitin 2014.

Tabela 20 – Përmbledhja e rakordimit për vitin 2014

Industria	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Raportimi i korrigjuar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Sektori i naftës dhe gazit	14,476,042	5,703,905	(80,520)	8,712,907	14,395,522	14,416,812	44,023	(22,734)
Sektori minerar	2,350,610	1,329,318	(857,907)	166,134	1,492,703	1,495,452	5,253	(2,502)
Sektori i hidro-energjisë	2,227,881	1,279,301	(742,126)	206,505	1,485,755	1,485,806	51	-
Total	**19,054,533**	**8,312,524**	**(1,680,553)**	**9,085,545**	**17,373,980**	**17,398,069**	**49,327**	**(25,236)**

6 Rezultatet e rakordimit

Ky kapitull paraqet rakordimin e flukseve të pagesave nga të licensuarit në sektorin e naftës dhe gazit, të licensuarit e përzgjedhur në sektorin minerar dhe shoqëritë hidro-energjetike të përzgjedhura, si dhe rakordimi i pagesave të kryera nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit.

6.1 Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit

6.1.1 Rezultati i rakordimit për vitin 2013

Në total, 8 shoqëri hidrokarbure duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 4 të licensuar në prodhim dhe 5 në kërkim. Bankers Petroleum zotëron njëkohësisht licensë në prodhim dhe në kërkim.

Ne morëm deklarime për 7 nga 8 shoqëri hidrokarbure. Institucionet shtetërore, në deklarimin e tyre të njëanshëm, nuk raportuan të ardhura të arkëtuara nga kjo shoqëri.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë hidrokarbure.

Tabela 22 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit në vitin 2013

Shumat në mijë Lek

Pagesat sipas	Raportimi fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shumat e korrigjuara
		Paguesi	Arkëtuesi	
Të Licensuarit	12,556,177	(249,277)	-	12,306,900
Shtetit	10,782,174	-	1,556,841	12,339,015
Mospërputhja	**1,774,003**			**(32,115)**

Shoqëritë e licensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 12,556,177 mijë Lek, të cilat ishin 1,774,003 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 249,277 mijë Lek dhe 1,556,841 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona “pa kundërparti”, përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Rakordimi i pagesave nga sektori i naftës dhe gazit sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 23 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Ndarja e prodhimit të naftës	3,530,170	3,529,741	-	-	(429)	-
Renta – eksport	6,838,859	6,806,239	(3,051)	29,569	-	-
Renta – shitje brenda vendit	80,720	47,598	-	31,069	(2,053)	-
Bonuset - AKBN	45,579	49,618	3,878	(161)	-	-
Bonuset - Albpetrol	10,695	-	-	10,695	-	-
TVSH	22,526	-	-	17,842	501	(5,185)
Penalitetet tatimore	43,890	111,336	(43,256)	(111,336)	-	(634)
Pagesa të tjera ndaj Shtetit	1,642,112	144,633	-	1,537,396	39,917	-
Pagesa të tjera ndaj Qeverisjes Vendore	341,625	93,010	(206,847)	41,768	-	-
Totali	**12,556,176**	**10,782,175**	**(249,276)**	**1,556,842**	**37,936**	**(5,819)**

Renta minerare përbënte fluksin kryesor të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nga sektori i naftës dhe gazit me rreth 56% të totalit të pagesave përfshirë në tabelën 23. Renta e paguar në doganë për eksportet ishte rreth 55.5% e totalit të pagesave raportuar nga sektori i naftës dhe gazit për vitin 2013. Ky raport lidhet ngushtë me peshën që zënë eksportet e naftës së papërpunuar përkundrejt shitjeve në vend. Pagesat për ndarjen e prodhimit të naftës përbënin fluksin e dytë më të madh të raportuar në vitin 2013, me rreth 29% të totalit të pagesave raportuar nga sektori i naftës dhe gazit.

Dy prodhuesit më të mëdhenj ishin gjithashtu dhe kontribuesit më të mëdhenj në të ardhurat e Buxhetit e Shtetit, përkatësisht Bankers Petroleum me 85% dhe Transatlantic Albania (më parë *Stream oil dhe gas*) me 10%.

Përkrah pagesave të detyrueshme, Bankers Petroleum raportoi gjithashtu pagesa sociale në përfitim të komunitetit përreth në shumën 194 milion Lek për vitin 2013. Këto pagesa u pranuan në mënyrë të njëanshme.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 7 nga 8 të licensuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Ne nuk morëm raportim nga shoqëria Emanuelle Adriatic Energy Ltd, megjithatë institucionet shtetërore nuk raportuan pagesa të arkëtuara për këtë kompani.

Mospërputhjet kryesore nga rakordim

Në total, 3 shoqëri korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa institucionet Qeveritare korigjuan raportimin e tyre fillestar për 6 shoqëri. Mospërputhjet e identifikuara në 18 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit.

Ka ende 11 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 32,115 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma që u raportuan dhe mbështetën me dokumenta pagese nga Shoqëritë.
- Të licensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës.
- Supozime të ndryshme përdorur për konvertimin e sasisë nga barrel në ton.
- Në shumë raste, të licensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese.
- Shumë nga të licensuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme duke raportua shuma më të vogla ose më të mëdha për një ose disa taksa.
- Të licensuarit raportuan depozitimin e parapaguar për rentën minerare në llogari të doganës, në vend të rentës së paguar në momentin e eksportit (*)

(*) Në rastin e eksporteve shoqëritë depozitojnë një parapagim për rentën minerare në llogari të doganës. Renta mbahet nga kjo depozitë në datën e eksportit dhe përpara kësaj date parapagimin i depozituar i përket të licensuarit. Për këtë arsye parapagimet e rentës nuk konsiderohen si të ardhura deri sa pagesa e rentës të ekzekutohet në momentin e eksportit.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 1.1.

6.1.2 Rezultati i rakordimit për vitin 2014

Në total, 8 shoqëri hidrokarbure duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 4 të licensuar në prodhim dhe 5 në kërkim. Bankers Petroleum zotëron njëkohësisht licensë në prodhim dhe kërkim.

Ne morëm deklarime për 7 nga 8 shoqëri hidrokarbure. Institucionet shtetërore, në deklarimin e tyre të njëanshëm nuk raportuan të ardhura të arkëtuara nga kjo shoqëri.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë hidrokarbure.

Tabela 24 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit në vitin 2014

Shumat në mijë Lek

Pagesat sipas	Raportimi fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shumat e korrigjuara
		Paguesi	Arkëtuesi	
Të Licensuarit	14,476,042	(80,520)	-	14,395,522
Shtetit	5,703,905	-	8,712,907	14,416,812
Mospërputhja	**8,772,137**			**(21,289)**

Shoqëritë e licensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 14,476,042 mijë Lek, të cilat ishin 8,772,137 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 80,520 mijë Lek dhe 8,712,907 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona “pa kundërparti”, përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Rakordimi i pagesave nga sektori i naftës dhe gazit sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 25 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Ndarja e prodhimit të naftës	3,934,072	3,941,512	-	-	7,440	-
Renta – eksport	5,421,507	-	-	5,444,829	23,322	-
Renta – shitje brenda vendit	720,015	639,152	-	84,323	3,460	-
Bonuset - AKBN	22,654	22,647	-	6	(1)	-
Bonuset - Albpetrol	17,495	-	-	12,311	(5,185)	-
TVSH	39,831	26,643	(38,957)	(26,643)	-	(874)
Penalitetet tatimore	27,338	683,487	-	(656,413)	29	(293)
Pagesa të tjera ndaj Shtetit	4,028,987	262,934	-	3,781,011	14,958	-
Pagesa të tjera ndaj Qeverisjes vendore	264,143	127,530	(41,563)	73,483	-	(21,567)
Totali	**14,476,042**	**5,703,905**	**(80,520)**	**8,712,907**	**44,023**	**(22,734)**

Renta minerare përbën fluksin kryesor të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nga sektori i naftës dhe gazit me rreth 43% të totalit të pagesave përfshirë në tabelën 25. Renta e paguar në doganë për eksportet ishte rreth 38% e totalit të pagesave raportuar nga sektori i naftës dhe gazit për vitin 2014. Ky raport lidhet ngushtë me peshën që zënë eksportet e naftës së papërpunuar përkundrejt shitjeve në vend. Pagesat për ndarjen e prodhimit të naftës përbënin fluksin e dytë më të madh të raportuar në vitin 2014, me rreth 27% të totalit të pagesave raportuar nga sektori i naftës dhe gazit.

Në vitin 2014, pagesat e tjera ndaj Shetit paraqesin gjithashtu një fluks të konsiderueshëm të ardhurash me rreth 28% të totalit të pagesave raportuar nga sektori i naftës dhe gazit paraqitur në tabelën 25 (2013: 13%). Kjo rritje lidhet me përvetësimin e garancisë për mbylljen e njëanshme të marrëveshjes hidrokarbure për blloqet kërkimit A-B dhe D-E. Këto pagesa u arkëtuan nga AKBN si përfaqësues i Shtetit në këto marrëveshje.

Dy prodhuesit më të mëdhenj ishin gjithashtu dhe kontribuesit më të mëdhenj në të ardhurat e Buxhetit e Shtetit, përkatësisht Bankers Petroleum me 87% dhe Transatlantic Albania (më parë Stream oil dhe gas) me 5%.

Përkrah pagesave të detyrueshme, Bankers Petroleum raportoi gjithashtu pagesa sociale në përfitim të komunitetit përreth në shumën 136 milion Lek për vitin 2014. Këto pagesa u pranuan në mënyrë të njëanshme.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 7 nga 8 të licensuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Ne nuk morëm raportim nga shoqëria Emanuelle Adriatic Energy Ltd, megjithatë institucionet shtetërore nuk raportuan pagesa të arkëtuara për këtë kompani.

Mospërputhjet kryesore nga rakordim

Në total, 2 shoqëri korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa institucionet Qeveritare korigjuan raportimin e tyre fillestar për 7 shoqëri. Mospërputhjet e identifikuara në 40 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 21 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 21,289 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma që u raportuan dhe mbështetën me dokumenta pagese nga Shoqëritë.
- Të licensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës.
- Supozime të ndryshme përdorur për konvertimin e sasisë nga barrel në ton.
- Në shume raste, të licensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese.
- Shumë nga të licensuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme duke raportua shuma me të vogla ose më të mëdha për një ose disa taksa.
- Të licensuarit raportuan depozitimin e parapaguar për rentën minerare në llogari të doganës, në vend të rentës së paguar në momentin e eksportit (*)

(*) Në rastin e eksporteve shoqëritë depozitojnë një parapagim për rentën minerare në llogari të doganës. Renta mbahet nga kjo depozitë në datën e eksportit dhe përpara kësaj date parapagimin i depozituar i përket të licensuarit. Për këtë arsye parapagimet e rentës nuk konsiderohen si të ardhura deri sa pagesa e rentës të ekzekutohet në momentin e eksportit.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 1.2.

6.2 Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar

6.2.1 Rezultati i rakordimit për vitin 2013

Në total, 81 shoqëri minerare duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 78 të licensuar në prodhim dhe 5 në kërkim. Beralb zotëron njëkohësisht licensë në prodhim dhe kërkim.

Ne morëm deklarime për 72 nga 82 shoqëri minerare. Shoqëritë që nuk raportuan deri në datën e këtij raporti ishin: Kurti, Vllazeria Has, "SHQIPONJA G.M.K", PASHKASHESH, Qeramika Apollon (Ish Milis Brik), Igli – 07, Elidon 06 shpk, Emma Chrom 2011 shpk dhe Afrimi K shpk. Bazuar në raportimin e njëanshëm të institucioneve shtetërore për këto shoqëri, pagesat e tyre zinin rreth 2% të pagesave totale të raportuar nga sektori minerar.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë minerare.

Tabela 26 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar në vitin 2013

Shumat në mijë Lek

Pagesat sipas	Raportimi fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shumat e korrigjuara
		Paguesi	Arkëtuesi	
Të Licensuarit	2,422,098	(1,097,316)	-	1,324,782
Shtetit	1,362,990	-	27,649	1,390,639
Mospërputhja	**1,059,108**			**(65,857)**

Shoqëritë e licensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 2,422,098 mijë Lek, të cilat ishin 1,059,108 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 1,097,316 mijë Lek dhe 27,649 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona “pa kundërparti”, përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Rakordimi i pagesave nga sektori minerar sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 27 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Renta – eksport	531,016	535,210	(6,903)	14,914	26,010	1
Renta – shitje brenda vendit	109,547	289,062	(847)	(149,942)	(899)	31,319
TVSH	1,161,407	100,914	(1,013,104)	46,158	(1,231)	-
Tatimi mbi fitimin	503,870	403,002	(64,027)	47,745	10,161	743
Penalitetet tatimore	28,736	20,035	(8,693)	(235)	(152)	(91)
Tatimi mbi dividentin	61,028	14,767	(3,742)	42,515	-	(4)
Pagesa të tjera ndaj Shtetit	26,494	-	-	26,494	-	-
Totali	**2,422,098**	**1,362,990**	**(1,097,316)**	**27,649**	**33,889**	**31,968**

Tatimi mbi fitimin dhe renta minerare përbënin përkatësisht 50% dhe 32% të pagesave të raportuara nga sektori minerar. Kontributi nga tre prodhuesit më të mëdhenj të kromit, bakrit dhe gurit gëlqeror përbën për bënin se bashku 46% të pagesave totale të raportuara nga sektori minerar. Këto tre shoqëri ishin përkatësisht Beralb (bakër) me kontribut prej 35% të totalit të pagesave raportuar në tabelën më sipër, Albchrome (krom) me kontribut 7% dhe Antea Cement (gur gëlqeror) me kontribut 4%.

Përkrah pagesave të detyrueshme, Antea Cement dhe Beralb raportuan gjithashtu pagesa sociale në përfitim të komunitetit përreth në shumën 5.4 milion Lek dhe 4.4 milion Lek për vitin 2013. Këto pagesa u pranuan në mënyrë të njëanshme.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 4 nga 72 të licensuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Mospërputhjet kryesore nga rakordim

Në total, 55 shoqëri korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa institucionet Qeveritare korigjuan raportimin e tyre fillestar për 45 shoqëri. Mospërputhjet e identifikuara në 212 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 60 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 65,857 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma që u raportuan dhe mbështetën me dokumenta pagese nga Shoqëritë.
- Të licensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës.
- Në shume raste, të licensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese.
- Shumë nga të licensuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme duke raportua shuma me të vogla ose më të mëdha për një ose disa taksa.
- Të licensuarit raportuan depozitimin e parapaguar për rentën minerare në llogari të doganës, në vend të rentës së paguar në momentin e eksportit (*)

(*) Në rastin e eksporteve shoqëritë depozitojnë një parapagim për rentën minerare në llogari të doganës. Renta mbahet nga kjo depozitë në datën e eksportit dhe përpara kësaj date parapagimin i depozituar i përket të licensuarit. Për këtë arsye parapagimet e rentës nuk konsiderohen si të ardhura deri sa pagesa e rentës të ekzekutohet në momentin e eksportit.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.1.

6.2.2 Rezultati i rakordimit për vitin 2014

Në total, 99 shoqëri minerare duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 96 të licensuar në prodhim dhe 5 në kërkim. Beralb zotëron njëkohësisht licensë në prodhim dhe kërkim.

Ne morëm deklarime për 88 nga 99 shoqëri minerare. Shoqëritë që nuk raportuan deri në datën e këtij raporti ishin: Kurti, Pakti, Mineral- Invest, Ternova Chrome ReBurimis, Fada &ALDI, Joni 2008, TMC Transport & Mining & Construction, Pashkashesh, Igli – 07, Balkan ReBurimis dhe "Mining Ferro Nikel" sh.p.k..

Bazuar në raportimin e njëanshëm të institucioneve shtetërore për këto shoqëri, pagesat e tyre zinin rreth 2% të pagesave totale të raportuar nga sektori minerar.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë minerare.

Tabela 28 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar në vitin 2014

Shumat në mijë Lek

Pagesat sipas	Raportimi fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shumat e korrigjuara
		Paguesi	Arkëtuesi	
Të Licensuarit	2,350,610	(857,907)	-	1,492,703
Shtetit	1,329,318	-	166,134	1,495,452
Mospërputhja	**1,021,292**			**(2,749)**

Shoqëritë e licensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 2,350,610 mijë Lek, të cilat ishin 1,021,292 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 857,907 mijë Lek dhe 166,134 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona “pa kundërparti”, përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Rakordimi i pagesave nga sektori minerar sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 29 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Renta – eksport	529,185	386,036	30,552	180,355	7,071	(415)
Renta – shitje brenda vendit	189,638	223,899	(27,463)	(62,048)	(1,352)	1,028
TVSH	806,207	57,349	(733,391)	12,866	(2,544)	(57)
Tatimi mbi fitimin	600,567	470,398	(96,035)	38,231	4,508	(411)
Penalitetet tatimore	48,848	74,088	(28,997)	(57,035)	(181)	(2,617)
Tatimi mbi dividentin	112,484	117,548	(2,573)	(7,667)	-	(30)
Pagesa të tjera ndaj Shtetit	63,681	-	-	61,432	(2,249)	-
Totali	**2,350,610**	**1,329,318**	**(857,907)**	**166,134**	**5,253**	**(2,502)**

Tatimi mbi fitimin dhe renta minerare përbënin përkatësisht 49% dhe 34% të pagesave të raportuara nga sektori minerar. Kontributi nga tre prodhuesit më të mëdhenj të kromit, bakrit dhe gurit gëlqeror përbën për bënin se bashku 48% të pagesave totale të raportuara nga sektori minerar. Këto tre shoqëri ishin përkatësisht Fushe-Kruja Cement Factory (gur gëlqeror) me kontribut 24% të totalit të pagesave raportuar në tabelën më sipër, Beralb (bakër) me kontribut prej 13%, Aneta Ceament (gur gëlqeror) me kontribut 6% dhe Albchrome (krom) me kontribut 5%.

Përkrah pagesave të detyrueshme, Antea Cement dhe Beralb raportuan gjithashtu pagesa sociale në përfitim të komunitetit përreth në shumën 45.6 milion Lek dhe 3 milion Lek për vitin 2013. Këto pagesa u pranuan në mënyrë të njëanshme.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 4 nga 88 të licensuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Mospërputhjet kryesore nga rakordim

Në total, 63 shoqëri korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa institucionet Qeveritare korigjuan raportimin e tyre fillestar për 62 shoqëri. Mospërputhjet e identifikuara në 262 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 87 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 2,754 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma që u raportuan dhe mbështetën me dokumenta pagese nga Shoqëritë.
- Të licensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës.
- Në shume raste, të licensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese.
- Shumë nga të licensuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme duke raportua shuma me të vogla ose më të mëdha për një ose disa taksa.
- Të licensuarit raportuan depozitimin e parapaguar për rentën minerare në llogari të doganës, në vend të rentës së paguar në momentin e eksportit (*)

(*) Në rastin e eksporteve shoqëritë depozitojnë një parapagim për rentën minerare në llogari të doganës. Renta mbahet nga kjo depozitë në datën e eksportit dhe përpara kësaj date parapagimin i depozituar i përket të licensuarit. Për këtë arsye parapagimet e rentës nuk konsiderohen si të ardhura deri sa pagesa e rentës të ekzekutohet në momentin e eksportit.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.2.

6.3 Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori hidro-energjisë

6.3.1 Rezultati i rakordimit për vitin 2013

Në total, 15 shoqëri hidro-energjetike, përfshirë KESH, duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 10 të licensuar në prodhim dhe 5 shoqëri në fazën e investimit.

Ne morëm deklarime për 13 nga 15 shoqëri hidro-energjetike. Shoqëritë që nuk raportuan deri në datën e këtij raporti ishin: Sllabinja Power sh.p.k. dhe Shoqeria Kocensionare "Kalivaç Green Energy" sh.p.k.

Bazuar në raportimin e njëanshëm të institucioneve shtetërore për këto shoqëri, pagesat e tyre zinin rreth 0.1% të pagesave totale të raportuar nga sektori i hidro-energjisë.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë hidro-energjetike.

Tabela 30 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2013

Shumat në mijë Lek

Pagesat sipas	Raportimi fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shumat e korrigjuara
		Paguesi	Arkëtuesi	
Të Licensuarit	3,255,344	16,069,147	-	19,324,491
Shtetit	3,999,958	-	15,275,333	19,275,291
Mospërputhja	**(744,614)**			**49,200**

Shoqëritë e licensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 3,255,344 mijë Lek, të cilat ishin 744,614 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 16,069,147 mijë Lek dhe 15,275,333 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona “pa kundërparti”, përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Rakordimi i pagesave nga sektori i hidro-energjisë sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 31 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Tarifa kocensionare	61,064	68,579	(4,205)	(16,556)	(4,836)	-
Tatimi mbi fitimin	520,419	985,291	493,913	29,040	(1)	-
TVSH	2,048,078	2,214,318	149,762	(16,478)	-	-
Penalitete tatimore	10,664	143,375	(9,982)	(142,696)	(3)	-
Tarifa rregullatore për ERE-n	20,782	38,395	1,059	(16,577)	(23)	-
Pagesa të tjera ndaj Shtetit	-	-	15,438,600	15,438,600	-	-
Pagesa të tjera ndaj Qeverisjes vendore	594,337	550,000	-	-	(44,337)	-
Totali	**3,255,344**	**3,999,958**	**16,069,147**	**15,275,333**	**(49,200)**	**-**

Në vitin 2013, Qeveria arkëtoi një shumë të konsiderueshme nga privatizimi i katër HEC-ve tek shoqëria Kurum International, paraqitur në pagesa të tjera ndaj Shtetit. Kjo pagesë përbënte 80% të totalit të pagesave raportuar nga sektori për vitin 2013 si më sipër. TVSH dhe tatimi mbi fitimin përbënin përkatësisht 11% dhe 5% të pagesave të raportuara nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2013. Nëse katër HEC-et nuk do të ishin privatizuar në vitin 2013, TVSH dhe tatimi mbi fitimin do të ishin respektivisht 57% dhe 26% të totalit të pagesave të raportuara nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2013. KESH ishte kontribuesi kryesor në pagesat e rregullta (pa përfshirë efektin e privatizimit) me rreth 95% të totalit të pagesave në vitin 2013.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 4 nga 13 të licensuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Mospërputhjet kryesore nga rakordim

Në total, 6 shoqëri korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa institucionet Qeveritare korigjuan raportimin e tyre fillestar për 9 shoqëri. Mospërputhjet e identifikuara në 41 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 12 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 49,200 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Pagesat për tatimin mbi fitimin paraqitur neto me shumat e arkëtuara për TVSH-në e rimbursueshme nga Shteti.
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës.
- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma që u raportuan dhe mbështetën me dokumenta pagese nga Shoqëritë.
- Të licensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.
- Në shume raste, të licensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese.
- Shumë nga të licensuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme duke raportua shuma me të vogla ose më të mëdha për një ose disa taksa.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 3.1.

6.3.2 Rezultati i rakordimit për vitin 2014

Në total, 15 shoqëri hidro-energjetike, përfshirë KESH, duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 10 të licensuar në prodhim dhe 5 shoqëri në fazën e investimit.

Ne morëm deklarime për 13 nga 15 shoqëri hidro-energjetike. Shoqëritë që nuk raportuan deri në datën e këtij raporti ishin: Sllabinja Power sh.p.k. dhe Shoqeria Kocensionare "Kalivaç Green Energy" sh.p.k.

Bazuar në raportimin e njëanshëm të institucioneve shtetërore për këto shoqëri, pagesat e tyre zinin rreth 0.1% të pagesave totale të raportuar nga sektori i hidro-energjisë.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë hidro-energjetike.

Tabela 32 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2014

Shumat në mijë Lek

Pagesat sipas	Raportimi fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shumat e korrigjuara
		Paguesi	Arkëtuesi	
Të Licensuarit	2,227,881	(742,126)	-	1,485,755
Shtetit	1,279,301	-	206,505	1,485,806
Mospërputhja	**948,580**			**(51)**

Shoqëritë e licensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 2,227,881 mijë Lek, të cilat ishin 948,580 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 742,126 mijë Lek dhe 206,505 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona “pa kundërparti”, përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Rakordimi i pagesave nga sektori i hidro-energjisë sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 33 – Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Tarifa kocensionare	66,824	66,423	(395)	-	(6)	66,824
Tatimi mbi fitimin	252,529	786,276	550,635	16,888	-	252,529
TVSH	1,639,304	187,677	(1,110,662)	341,022	57	1,639,304
Penalitete tatimore	197,257	187,677	(181,704)	(172,124)	-	197,257
Tarifa rregullatore për ERE-n	71,967	51,248	-	20,719	-	71,967
Pagesa të tjera ndaj Shtetit	-	-	-	-	-	-
Pagesa të tjera ndaj Qeverisjes vendore	-	-	-	-	-	-
Totali	**2,227,881**	**1,279,301**	**(742,126)**	**206,505**	**51**	**2,227,881**

TVSH dhe tatimi mbi fitimin përbënin përkatësisht 36% dhe 54% të pagesave të raportuara nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2014. Energji Ashta ishte kontribuesi kryesor në pagesat e rregullta (pa përfshirë efektin e privatizimit) me rreth 41% të totalit të pagesave në vitin 2014, ndërsa kontributi i KESH u rendit i dyti me rreth 31%.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 4 nga 13 të licensuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Mospërputhjet kryesore nga rakordim

Në total, 6 shoqëri korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa institucionet Qeveritare korigjuan raportimin e tyre fillestar për 10 shoqëri. Mospërputhjet e identifikuara në 35 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 2 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 51 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Pagesat për tatimin mbi fitimin paraqitur neto me shumat e arkëtuara për TVSH-në e rimbursueshme nga Shteti.
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës.
- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma që u raportuan dhe mbështetën me dokumenta pagese nga Shoqëritë.
- Të licensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.
- Në shume raste, të licensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese.
- Shumë nga të licensuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme duke raportua shuma me të vogla ose më të mëdha për një ose disa taksa.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 3.2.

6.4 Përmbledhja e rakordimit të pagesave të Albpetrol ndaj Buxhetit të Shtetit

6.4.1 Rezultati i rakordimit për vitin 2013

Në vitin 2013, Albpetrol kontribuoi si më poshtë në Buxhetin e Shtetit:

Tabela 34 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit në vitin 2013

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Renta – eksport	100,000	147,802	48,470	-	(668)	-	Shuma të paraportuara fillimisht nga Albpetrol.
Renta – shitje brenda vendit	472,573	472,573	-	-	-	-	
TVSH	846,176	846,176	-	-	-		
Tatimi mbi fitimin	450,710	450,710	-	-	-		
Penalitetet tatimore	457,778	460,992	-	-	3,214		
Dividentët përfshirë tatimin mbi dividentin	90,882	99,461	-	-	8,580		
Pagesa të tjera ndaj Qeverisjes vendore	76,652	76,652	-	-	-		
Totali	**2,494,772**	**2,554,368**	**48,470**	**-**	**11,126**	**-**	

Mospërputhjet në shumën 11,126 mijë Lek mbetën të pazgjidhura të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti.

Në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure nën administrimin e tij, Albpetrol mblodhi të ardhuat e mëposhtme nga sektori i naftës dhe gazit.

Tabela 35 - Përmbledhja e pagesave arkëtuar nga Albpetrol në vitin 2013

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Ndarja e prodhimit të naftës	3,530,170	3,529,741	-	-	(429)	-
Bonuseset - Albpetrol	10,695	-	-	10,695	-	-
Total	**3,540,865**	**3,529,741**	**-**	**10,695**	**(429)**	**-**

Pjesa nga ndarja e prodhimit të naftës u pagua plotësisht në natyrë në sasinë e 75,825 ton në vitin 2013. Vlerat e paraqitura më sipër janë përftuar duke zbatuar çmimet mesatare të shitjes së Albpetrol në vitin 2013 prej 441 USD / ton. Shumat në USD u përkthyen në Lek me normën mesatare të këmbimit të USD në Lek sipas Bankës së Shqipërisë në vitin 2013, ku 1 USD ishte i barabartë me 105.7 Lek.

6.4.1 Rezultati i rakordimit për vitin 2014

Në vitin 2014, Albpetrol kontribuoi si më poshtë në Buxhetin e Shtetit:

Tabela 36 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit në vitin 2014

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Renta – eksport	-	-	-	-	-	-	
Renta – shitje brenda vendit	829,277	830,839	1,562	-	-	-	Shënimi 1
TVSH	1,465,705	1,465,705	-	-	-		
Tatimi mbi fitimin	430,680	464,032	-	-	33,352	-	Tax authorities raported this amount as compensation. However, Albpetrol does not agree on their presentation.
Penalitetet tatimore	14,284	2,853	(11,432)	-	-	-	Shënimi 1
Dividentët përfshirë tatimin mbi dividentin	798,699	808,569	9,870	-	-	-	Shënimi 1
Pagesa të tjera ndaj Qeverisjes vendore	17,760	22,559	-	-	4,800	-	Resulted from reconciliation with Patos municipality.
Totali	**3,556,406**	**3,594,557**	**-**	**-**	**38,151**	**-**	

Shënimi 1 - *Albpetrol raportoi këto pagesa si penalitete tatimore.*

Mospërputhjet në shumën 38,151 mijë Lek mbetën të pazgjidhura të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti.

Përkrah pagesave të detyrueshme, Albpetrol raportoi gjithashtu pagesa sociale në përfitim të komunitetit përreth në shumën 23 milion Lek për vitin 2014. Këto pagesa u pranuan në mënyrë të njëanshme.

Në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure nën administrimin e tij, Albpetrol mblodhi të ardhuat e mëposhtme nga sektori i naftës dhe gazit.

Tabela 37 - Përmbledhja e pagesave arkëtuar nga Albpetrol në vitin 2014

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Ndarja e prodhimit të naftës	3,530,170	3,529,741	-	-	(429)	-
Bonuseset - Albpetrol	10,695	-	-	10,695	-	-
Total	**3,540,865**	**3,529,741**	**-**	**10,695**	**(429)**	**-**

Pjesa nga ndarja e prodhimit të naftës u pagua plotësisht në natyrë në sasinë e 94,304 ton në vitin 2014. Vlerat e paraqitura më sipër janë përftuar duke zbatuar çmimet mesatare të shitjes së Albpetrol në vitin 2014 prej 396 USD / ton. Shumat në USD u përkthyen në Lek me normën mesatare të këmbimit të USD në Lek sipas Bankës së Shqipërisë në vitin 2014, ku 1 USD ishte i barabartë me 105.5 Lek.

7 Komente dhe rekomandime

Raportimi EITI u përfundua në nëntor 2015 dhe përfshin pagesat e bëra në vitin 2013 dhe 2014Raportimi i parë u përfundua në vitin 2011 (fillimi i zbatimit të nismës EITI) për pagesat e bëra në vitin 2009.

Gjatë rrjedhës së këtij angazhimi, ne identifikuam dhe përmblodhëm si më poshtë aspekte që mund të përmirësohen më tej, që ndikojnë në shtrirjen e raportimit EITI dhe vetë procesin. Përcaktimi i prioriteteve relative dhe kohës së zbatimit të rekomandimeve të pranuara është përgjegjësi e Grupit Shqiptar të Punës.

Në zbatim të rekomandimeve përfshirë në raportin EITI 2010, me qëllim forcimin e aksesit në të dhëna të besueshme brenda afatit të raportimit, Grupi Shqiptar i Punës caktoi pika kontakti kordinues për procesin EITI në çdo institucion qeveritar raportues përfshirë MEI-n, AKBN-në, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Administratën Doganore Shqiptare etj, si dhe shoqëritë e mëdha që operojnë në sektorin hidrokarbur dhe atë minerar.

Emërimi i pikave kyçe EITI në institucionet shtetërore kontribuoi pozitivisht për të rritur ndërgjegjësimin dhe koordinimin e aktiviteteve të EITI. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar raportimin dhe analizimin e aktivitetit të industrisë dhe pagesat nga industria nxjerrëse.

Gjatë punës tonë vume re disa pengesa dhe kufizime në mbledhjen e të dhënave të besueshme dhe gjithëpërfshirëse në kohën e kërkuar për të hartuar këtë raport, përfshirë këtu: aspektet rregullatore, gatishmërinë e subjekteve raportuese dhe institucioneve publike, cilësinë e dobët të të dhënave në dispozicion etj.

Disa nga këto pengesa dhe kufizime dhe veprimet e sugjeruara korrigjuese janë listuar në vijim.

7.1 Aksesi në kohë i informacionit të besueshëm nga të licensuarit

7.1.1 Vonesat dhe mospërputhjet

Shoqëritë e licensuara raportuan me shumë vonesë përtej çdo afati dhe me shumë mospërputhje. Mbi 90% e raportimeve nga shoqëritë e përzgjedhura dorëzuan raportimet e tyre mbas afatit të vendosur në Gusht 2015 dhe rreth 120 nga 150 shoqëri të përzgjedhura për të dy vitet korigjuan raportimin e tyre fillestar.

Përmes pyetjeve drejtuar shoqërive raportuese ne kuptuam se në pjesën më të madhe të rasteve, informacioni i kërkuar nuk ishte i disponueshëm dhe i gjindshëm në llogaritë kontabël dhe sistemi i raportimit financiar ose kërkonte përpunim shtesë. Për shkak të kohës së kufizuar, disa prej tyre refuzuan të bashkpunonin me ne gjatë procesit të rakordimit.

Në shumicën e rasteve shoqëritë nuk përfshinë pagesat e plota në raportimet e tyre fillestar ose raportuan detyrimet në vend të pagesave. Më së shumti, mospërputhjet u identifikuan gjatë rakordimin të pagesave ndaj autoriteteve tatimore. Në shumë raste shoqëritë ngatërruan pagesat me kompensimet tatimore neto si dhe pagesat e kryera për lloje të ndryshme taksash. Ky fakt ishte më i dukshëm në rastet kur pagesat rridhnin nga inspektimet tatimore.

Rekomandime

Në mënyrë që të lehtësohet procesi i rakordimit dhe përpilimi i raportit, ne sugjerojmë që të përcaktohet një kalendar vjetor për kryerjen e procesit të raportimit dhe rakordimit. Afati vjetor për raportim duhet të planifikohet në kohë dhe të përfshihet në kalendarin vjetor të raportimit të shoqërive. Për këtë arsye, përzgjedhja e shoqërive raportuese dhe kërkesave për raportim duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara afatit për dorëzimin e raportimit.

Gjithashtu, me qëllim që të zvogëlohet numri i mospërputhjeve me pagesat e raportuara nga autoritetet tatimeve, MSG mund t'i kërkojë shoqërive raportuese që të krahasojnë shumën e pagesave të kryera ndaj tatimeve gjatë vitit në raportim me degët rajonale të tatimeve përpara se t'i raportojnë këto pagesave për rakordimin EITI.

Ministria duhet të ndjekë zbatimin rigoroz të legjislacionit shqiptar në fuqi lidhur me raportimin financiar dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërive në sektorin nxjerrës dhe atë të hidro-energjisë. Kjo do të sjellë përmirësim të cilësisë dhe sasisë së informacionit financiar prodhuar për aktivitetet nxjerrëse në Shqipëri.

7.1.2 Procedurat verifikuese

Shoqëritë e licensuara nuk paraqitën konfirmimin për saktësinë e raportimit EITI nga audituesit e pasqyrave financiare. Një pjesë e mire e tyre nuk ju nënshtruan auditimit ligjor për shkak të formës së organizimit (si për shembull regjistrimi si degë e shoqërisë së huaj dhe jo si shoqëri më vete) ose niveli i ulët i aktivitetit gjatë vitit. Megjithatë, edhe kur shoqëritë i ishin nënshtruar auditimit ligjor të pasqyrave financiare, refuzuan t'i angazhonin audituesit e tyre për verifikimin e informacionit të raportuar për EITI-n. Në kuptimin tonë kjo kërkesë nuk pati sukses sepse mbarte kosto shtesë auditimi kur procesi i auditimit kishte përfunduar më herët.

Rekomandime

Në kontekstin e përmirësimit të cilësisë të raportimit të Shoqërive dhe njëkohësisht për të marrë siguri mbi informacionin e raportuar, ne rekomandojmë që Ministria t'ju kërkojë shoqërive të licensuara të paraqesin pagesat dhe informacione shtese sipas standardit EITI në një raport të veçantë ose në një aneks të pasqyrave financiare vjetore. Në të dy rastet ky informacion duhet të jetë subjek i auditimit të pavaruar vjetor.

7.1.3 Aspekte të tjera cilësore të analizës së pagesave

Shoqëritë e licensuara në Shqipëri tatohen në bazë të rezultateve financiare të biznesit të tyre raportuar sipas numërit identifikues tatimor të biznesit. Ky numër mund të përfshijë informacion financiar dhe tatimor për një ose më shumë licensa me aktivitet minerar, hidro-energjetik dhe sektorë të tjerë të ekonomisë. (Për shembull, një nga shoqëritë e përzgjedhura në vitin 2013 dhe 2014, raportoi pagesa të identifikuara me të njëjtin numër tatimor për biznesin e hidro-energjisë dhe aktivitete të tjera ekonomike. Shoqëria njoftoi se pagesat e kryera për biznesin e hidro-energjisë zinin një peshë rreth 15% të totalit të pagesave të raportuara në 2013 dhe 2014)

Rekomandime

Ne rekomandojmë që MEI të rrisë kërkesat rregullatore për të siguruar raportimin e pagesave dhe taksave për secilën licensë më vete. Nëpërmjet krahasimit të pagesave për çdo licensë me nivelin e prodhimit dhe tatimit, MEI mund të përftojë një bazë të mjaftueshme të dhënash për buxhetimin e të ardhurave dhe analizën e efektivitetit të politikave fiskale në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

7.2 Aksesi në kohë i informacionit të besueshëm nga institucionet publike raportuese

Institucionet publike raportuan me shumë vonesë përtej çdo afati dhe me shumë mospërputhje. Përmes pyetjeve drejtuar institucioneve publike ne kuptuam se strukturat dhe sistemet e tyre të administrimit të informacionit nuk mund të prodhonin informacionin e kërkuar për qëllime të raportit EITI.

7.2.1 Mangësitë e raportimit të konsoliduar në qeverisjen qëndore dhe vendore

Sistemet e informacionit të Qeverisjes qëndrore nuk mund të prodhonin të dhëna për taksat e paguara nga çdo taksapagues. Arkëtimet dhe pagesat e Qeverisë regjistrohen në një sistem të veçantë për administrimin e parasë: Sistemi i Thesarit. Ne kuptojmë që ky sistem mund të prodhojë informacion për arkëtimet mujore në total sipas taksave, por nuk mund të prodhojë informacion të detajuar për çdo taksapagues. Për këtë arsye, MSG i kërkoi agjencive qeveritare që mbledhin pagesat në sektor të raportojnë arkëtimet nga të ardhurat kryesore në sektor, meqënëse nuk mund ta merrte këtë informacion nga një burim i vetëm.

Rekomandime

Për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria ne rekomandojmë:

- Bashkëpunimin me ekipin e raportimit të Qeverisë për të krijuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i Thesarit me informacion për pagesat e mbledhura për çdo taksapagues sipas llojit të taksave. Për disa arsye shpjeguar më poshtë, ne mendojme se qasja në raportet e prodhuar nga sistemet e informacionit të Qeverisjes Qëndrore do të ishte zgjidhja më e mirë.
- Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, ne rekomandojmë vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë të ardhura në sektor.

7.2.2 Raportimi i Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV)

Për shkak se aktiviteti i shoqërive raportuese shtrihet në një numër të madh njësish të qeverisjes vendore, MSG mundi të përzgjidhte për raportim vetëm disa NJQV bazuar në pagesat më të mëdha raportuar nga shoqëritë në vitin 2013 dhe 2014. Procesi i raportimit nuk përfshinte të gjitha njësitë e qeverisjes vendore që mbledhin të ardhura nga sektori naftës, minerar dhe hidro-energjitik.

Rekomandime

NJQV-të kanë autonomi të caktuar në bashkëpunimin me biznesin dhe tatimin e aktivitetit në zonat nën administrim. Për të përmirësuar transparencën e këtij bashkëpunimi në aspektin e pagesave të tatimeve dhe taksave lokale, tarifave për shërbimet, kontributet dhe aktivitetet në dobi të komunitetit lokal, etj. ne rekomandojmë zgjedhjen e NJQV-ve për raportim bazuar në nivelin e aktivitetit prodhues raportuar nga AKBN. Përzgjedhja e NJQV-ve për raportim dhe e kërkesave për raportim duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara afatit për dorëzimin e raportimit në mënyrë që të integrohet në kalendarin e raportimeve vjetore të NJQV-ve.

7.2.3 Kufizimet në raportet e prodhuara nga Sistemi i Tatimeve

Sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili administron numrin dhe vlerën më të madhe të tatimeve dhe taksave, nuk mund të prodhonte informacion për pagesat kryer nga çdo taksapagues. Për këtë arsye kërkesat për raportin EITI rritën ndjeshëm ngarkesën e punës së drejtorive rajonale të tatimeve, të cilat e mblodhën këtë informacion nga dokumentat në dosjet e tatimpaguesve. Si rrjedhojë, informacioni i kërkuar erdhi me vonesë dhe shumë mospërputhje

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njoftoi se në vitin 2015 nisi punën sistemi i ri për administrimin e taksave, që do mund të prodhojë informacion të plotë dhe sipas pagesave për të gjithë tatimpaguesit duke filluar nga viti 2015.

Rekomandime

Siç rekomandohet edhe më sipër në pikën 7.2.1 për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria, MSG dhe EITI Shqipëri duhet të bashkëpunojë me ekipin e raportimit të Qeverisë për të hartuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i Thesarit.

Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, dhe duke konsideruar madhësinë e të ardhurave që mbledh DPT në sektor ne rekomandojmë vlerësimin e mundësisë për të prodhuar raporte dhe informacion nga sistemi i tatimeve.

7.3 Çështje lidhur me cilësinë e informacionit kontekstual paraqitur në raport

7.3.1 Publikimi i statistikave dhe fakteve mbi industrinë nxjerrëse

Standardi i ri EITI kërkon paraqitjen në raport të kontekstit në te cilin operon industria nxjerrëse dhe informacion për rregullimin e industrisë në vend, duke përfshirë sa më poshtë:

- Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse, informacion për rezervat, vendburimet, strukturën aktuale dhe madhësinë e industrisë, aktiviteteve të rëndësishme kërkimore etj.;
- Kontributin e industrisë në ekonomi, punësim dhe nivelin e eksporteve;
- Totalin e të ardhurave gjeneruar nga industria nxjerrëse dhe fondet e përcaktuara për programet specifike / rajonet gjeografike ose transfertat midis Shtetit dhe pushtetit vendor;
- Studimet e kryera mbi impaktin mjedisor dhe social kryer për sektorin;
- Informacion publik për alokimit të licensave, regjistrin e të licensuarve, pronarët përfitues, kushtet e kontratës etj.

Ne vumë re disa përmirësime në publikimin e informacionit në faqet e MEI, AKBN dhe Albpetrol, megjithatë të dhënat vijnë nga burime të ndryshme dhe përmirësime të mëtejshme janë ende të nevojshme për të siguruar një raportim të plotë dhe të qëndrueshëm mbi industrinë nxjerrëse.

Informacioni kontekstual i përfshirë në këtë raport i është referuar burimeve të ndryshme të shpërndara në të gjithë sektorin publik. Shpesh ky informacion nuk ishte publik. Disa analiza u kufizuan për shkak të mungesës së statistikave për këtë sektor dhe atje ku ishin të disponueshme, këto statistika përfshinin informacione për një sektor më të gjerë.

Rekomandime

Për të përmirësuar plotësinë dhe saktësinë, besueshmërinë dhe aksesin në informacionin kontekstual, ne rekomandojmë që Ministria e Energjisë dhe Industrisë të publikojë në mënyrë periodike (të paktën çdo vit) fakte mbi industrinë duke përfshirë: potencialin e industrisë dhe prodhimin aktual, kontributin në ekonomi, strategjinë e sektorit, ngjarje dhe fakte, rregullimin aktual dhe ndryshimet e ardhshme etj.

Informacion kontekstual mund të përfshijë informacione të tjera të dobishme për statistikat e sektorit të tilla si:

- Madhësia e prodhimit dhe detaje të cilësisë (graviteti i naftës, përqendrimi i mineraleve, etj),
- Investimet (numri i puseve dhe galerive të minierave nën administrim / zhvillim),
- Projektet për rehabilitimin mjedisor dhe kostot përkatëse,
- Fuqia punëtore e punësuar, paga mesatare dhe nënkontraktimi, shpenzimet sociale, etj.

Këto informacione mund të mblidhen e të përpunohen çdo vit dhe të shërbejnë si bazë për raportimin e statistikave dhe fakteve për industrinë. AKBN, si institucion i angazhuar gjerësisht në monitorimin e sektorit mund të kontribuojë në përpilimin e informacionit kontekstual nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga raportimet vjetore të shoqërive për çdo licensë në AKBN bazuar në treguesit e përcaktuar nga MSG për prodhimin, rezervat, shitjen, numrin e punonjësve, investimet në mjedis, pagesat sociale etj.

Ndër të tjera, përmes përdorimit të treguesve, AKBN mund të përmbledh fakte të bazuara në studimet vjetore të mjedisit duke theksuar rreziqet dhe trendet në nivel vendi, si dhe zona të veçanta ku përqendrohet veprimtaria e operatorëve në sektorin e nxjerrjes dhe të energjisë.

Në kuadër të përmirësimit të raportimit dhe statistikave në industrinë nxjerrëse, ne rekomandojmë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të shqyrtojë nëse do të zbatojë kërkesat e raportimit të ngjashme si në Direktivat e BE-së për Kontabilitetin dhe Transparencën[75].

75 EU Accounting Directive 2013/34/EU

7.3.2 Të dhënat për sasinë dhe vlerësimin e prodhimit

Përmes pyetjeve drejtuar AKBN-së, ne kuptuam se sasia e prodhimit dhe numri i punonjësve raportuar nga AKBN përftohet nga vetëdeklarimet e dorëzuara nga shoqëritë e licensuara në AKBN, si pjesë e raportimit vjetor. AKBN na informoi se nuk kryen procedura kontrolli për të marrë sigurisë mbi saktësinë e të dhënave të vetëdeklaruara për prodhimin, të ardhurat dhe rezervat.

Sipas të dhënave të AKBN-së, vetëm 70% e licensave gjithësej kanë raportuar prodhimin e tyre në vitin 2013. Ky raport u rrit në 85% në vitin 2014. Për më tepër, AKBN nuk mund të japë detaje për cilësinë (perqendrimin) e mineraleve të prodhimuara gjatë viteve 2011 dhe 2014. Në mungesë të një informacioni të tillë, prodhimi minerar nuk mund të vlerësohej me reference të çmimeve ndërkombëtare për mineralet.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që AKBN të kryej matje të prodhimit minerar të nxjerrë dhe ta krahasojë atë me vetëdeklarimet e shoqërive. Gjithashtu, vetëdeklarimet dhe krahasimet të përfshijnë të dhëna për cilësinë e mineraleve (nivelin e përqëndrimit) dhe vlerat e transaksioneve në tregun vendas dhe tregjet e eksportit. Çmimet e transaksioneve në vend mund të krahasohen me çmimet në tregjet ndërkombëtare të mineraleve.

7.3.3 Publikimi i të ardhurave totale që merr Shteti nga industria nxjerrëse

Ne nuk mund të merrnim një raport të plotë të të ardhurave të Qeverisë nga sektori nxjerrës për vitin 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Ne kuptojmë që të ardhurat dhe shpenzimet e Qeverisë janë regjistruar në sistemin e administrimit të parasë: Sistemi i Thesarit. Ky sistem mund të japë informacion të përditësuar për të ardhurat e gjeneruara nga çdo taksë. Megjithatë, nuk mund të identifikojë dhe të regjistrojë veçmas të ardhurat në total dhe sipas taksave gjeneruar nga industria nxjerrëse apo të ardhurat gjeneruar nga secili taksapagues më vete (përmendur gjithashtu në piken 7.2.1).

Mungesa e këtij informacioni, kufizon analizën e madhësisë relative të pagesave sipas llojit, trendin e pagesave në krahasim me prodhimin, madhësnë relative të pagesave nga taksapaguesit individual, etj.

Rekomandime

Sistemi qëndror i Thesarit mbledh informacion për çdo pagesë kryer nga taksapaguesit individual, pavarësisht institucioneve që mbledhin këto të taksa ose sektorit ekonomik ku vepron taksapaguesi. Siç është rekomanduar në 7.2.1, nëpërmjet bashkëpunimit me ekipin e raportimit të Qeverisë, MSG mund të marrë të dhëna të plota për të ardhurat gjeneruar nga sektori nxjerrës dhe i hidro-energjisë. Kjo mund të arrihet duke mbajtur një regjistër të përditësuar të licensave në sektor me të dhëna të sakta për numrin e licensës dhe numrin e identifikimit tatimor. Sistemi i informacionit të Qeverisë mund të përdorë të dhënat nga ky regjistër për të prodhuar raportet.

Nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, ne rekomandojmë vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë taksa në sektor si tatimet, doganat, dhe NJQV-të, të cilat përfaqësojnë njëkohësisht agjentë të rëndësishëm tatimorë.

Përveç përmbushjes së kerkesave të standardit EITI, informacioni i përditësuar nga sistemi i raportimit të Qeverisë do të përmirësojë analizat statistikore në sektor dhe do të mund të krahasohet me informacione të tjera si niveli i prodhimit, struktura e industrisë, numri i licensave, etj.

7.3.4 Rezervat

Ne kuptojmë se Qeveria nuk ka ndërmarrë studime mbi rezervat gjeologjike për naftën dhe mineralet e tjera në 25 vitet e fundit. Në këtë rast sugjerojmë që MEI të publikojë rezultatet e studimeve dhe hartat gjeologjike të viteve 80 dhe 90. Gjithsesi, saktësia e tyre është e kufizuar për shkak të avancimit teknologjik për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe mineraleve të tjera, si dhe mungesës së të dhënave zyrtare e të sakta për prodhimin nxjerrë në të gjithë vendin që nga koha e këtyre studimeve të fundit gjeologjike.

Rekomandime

Ne e kuptojmë se vlerësimi i rezervave kombëtare mund të kërkojë shumë vite dhe përbën një kosto të rëndë në Buxhetin e Shtetit. Megjithatë, rezervat janë të rëndësishme për të siguruar informacion kontekstual për vlerën e përgjithshme të pasurisë kombëtare në përputhje me kërkesat e kapitullit 3 të standardit EITI. Ne rekomandojmë që MEI të vlerësojë përfitimet përkundrejt kostove për vlerësimin e rezervave në të gjithë vendin dhe të caktojë prioritetet për zonat me interes të lartë. Gjithashtu, informacioni koherent për rezervat e provuara dhe të mundshme kombinuar me kontroll efektiv të aktiviteteve të kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe mineraleve në vend, mund të ndihmojë në planifikimin efektiv të prodhimit dhe atë fiskal si dhe parandalimin e abuzimeve me burimet kombëtare.

7.3.5 Mbajtja e një regjistri të përditësuar publik të licensave dhe kocensioneve

MEI nuk mban një regjistër publik të përditësuar të të licensuarve dhe kocensioneve në sektorin minerar dhe kocensioneve të dhëna në sektorin hidro-energjitik. Në përputhje me kërkesën 3.9 të standardit EITI, AlbEITI prodhoi regjistrin e licensave minerare bazuar në të dhënat e çdo license. Një kopje e këtij regjistri është paraqitur në Shtojcën 7.

Gjithashtu, në vijim të kërkesës sonë, AKBN raportoi regjistrin e përditësuar të kocensioneve hidro-energjetike, për ta paraqitur në raport në përputhje me kërkesën 3.9 të standardit EITI dhe vendimit të MSG për përfshirjen e sektorit të hidro-energjisë në raportimin EITI.

Rekomandime

Vendet anëtare të EITI-t duhet të mbajnë një regjistër publik ose sistem kadastër me informacioin koherent dhe të plotë për çdo licensë dhënë shoqërive përfshirë:

- Mbajtësin e licensës;
- Koordinatat e zonës së licensës;
- Datën e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatjen e licensës; dhe
- Në rastin e liçensave të prodhimit, mineralin e prodhuar.

Regjistri i licensave apo kadastra do të përfshijë informacion për të gjitha licensat e mbajtura nga të gjitha subjektet, përfshirë edhe shoqëritë, individët apo grupet që nuk janë përzgjedhur për rakordim sipas standardit EITI, sepse pagesat tyre paraqiten nën pragun e materialitetit të përcaktuar.

Siç është shpjeguar edhe më herët në këtë kapitull, mbajtja e një regjistri të përditësuar publik do të kontribuojë në përmirësimin e raportimit të të ardhurave të qeverisë nga këto sektorë. Për më tepër, të dhëna të sakta mbi të licensuarit, numrat e identifikimit tatimor (NUIS), si dhe detajet e kontaktit, adresa, etj. do të lehtësojnë komunikimin me subjektet e përzgjedhura për të raportuar sipas EITI.

7.3.6 Transparenca mbi alokimin e licensave

Në përputhje me kërkesën e standardit EITI 3.10, vendet zbatuese duhet të japin informacion shpjegues lidhur me procesin e dhënies ose transferimin e licensave për **shoqëritë e përfshira në Raportin EITI.** Informacionet shpjeguese duhet të përfshijnë:

i. një përshkrim të proçesit për dhënien ose transferimit të licensës;
ii. kriteret teknike dhe financiare të përdorura;
iii. informacion në lidhje me përfituesit e licensës së transferuar ose dhënë, duke përfshirë anëtarët e konsorciumit nëse është e zbatueshme; dhe
iv. ç'do devijim i rëndësishëm nga procesi i zbatueshëm për dhënien ose transferimin e licensës.

Kur liçensat jepen përmes një procesi tenderimi **gjatë periudhës kontabël të mbuluar nga raporti EITI**, Shteti duhet të publikojë listën e aplikantëve dhe kriteret e tenderit.

Gjendja aktuale

Marrëveshjet e naftës dhe gazit

Përmes pyetjeve dhe komunikimit, kuptuam se pothuajse të gjitha marrëveshjet e naftës janë alokuar nëpërmjt negocimit të propozimeve të pakërkuara deri në gusht të vitit 2013. Informacioni mbi të licensuarit dhe operacionet e përbashkëta ishin publikuar në faqen e internetit të MEI-t.

Në përputhje me kërkesat EITI 3.10, ne kemi kërkuar por nuk kemi marrë informacione nga MEI mbi kriteret teknike dhe financiare të përdorura për alokimin e këtyre marrëveshjeve.

Licensat dhe kocensionet e minierave

Ne kemi marrë informacion mbi procedurat konkuruese të kryera për të alokuar licensat minerare në vitin 2013 dhe 2014, por nuk kemi marrë informacion për emrin e aplikantëve dhe informacion mbi kriteret teknike dhe financiare për vlerësimin e ofertëve ku dy ose më shumë aplikantë paraqesin propozimin njëkohësisht.

Licensat dhe kocensionet e hidro-energjisë

Në lidhje me kocensionet e hidro-energjisë jemi të vetëdijshëm se ligji lejon negociatat për propozimet e pakërkuara si dhe procedurat konkuruese. MEI nuk ka paraqitur në raport metodat dhe kriteret e përdorura gjatë vlerësimit të kocensioneve në sektorin hidro-energjetik për vitet 2013 dhe 2014.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që MEI publikojë në faqen e saj të internetit metodat për alokimin e licensave, kriteret e përdorura për vlerësimin dhe emrat aplikantëve jo-fitues. Ky publikim do të rrisë transparencën e proçesit dhe do të kontribuojë në përmirësimin e negociatave dhe në efektivitetin e procesit.

Përveç kësaj, Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje investuese me shumë vende (lista e plotë e traktateve në fuqi është dhënë në: http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/CountryBits/2çiiaInnerMenu). Këto marrëveshje imponojnë kërkesa strikte për transparencën e procesit të licensimit dhe procedurat e prokurimit. Në këto rrethana, mungesa e transparencës dhe proceset joefektive të licensimit mund ta ekspozojnë vendin kundrejt pretendimeve në arbitrazh ndërkombëtar.

7.4 Kuadri regullator për raportimin EITI

Ligji për hidrokarburet (ndryshuar në Mars 2015) dhe Ligji Minerar (ndryshuar në tetor 2014) i kërkojnë respektivisht të licensuarve në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe mineraleve të tjera të raportojnë informacionin në përputhje me standardin EITI. Gjithashtu, të dy ligjet kërkojnë raportim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Administrata Doganore Shqiptare, institucione të tjera publike në nivel qeverisje qëndrore dhe vendore të raportojnë të ardhurat e mbledhura nga këta dy sektorë.

Kërkesa për raportim nga ana e institucioneve qeveritare aktualisht është në konflikt me detyrimin e tyre ligjor për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë gjatë punës së tyre. Këto dispozita konfidencialiteti, të referuara në ligjet e aplikueshme për procedurat tatimore dhe doganore në Shqipëri[76], lejojnë akses në të dhënat vetëm me pëlqimin e shprehur nga shoqëritë e licensuara. Institucionet qeveritare mund të shkëmbejnë të dhëna sipas disa kushteve strikte konfidencialiteti.

Kuadri rregullator në fuqi nuk parashikon formën e raportimit të pagesave dhe informacionit kontekstual. Një model raportimi fillestar për sektorin minerar u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 233 datë 23 mars 2011. Për shkak se është hartuar dhe miratuar përpara hyrjes në fuqi të Standardit të ri EITI në vitin 2013, modeli nuk parashikon shumë kërkesa të reja si raportimi i të dhënave të detajuara për çdo shoqëri / licensë dhe procesi i verifikimit të të dhënave.

> Për të qënë në përputhje me klauzolat e konfidencialitetit, format e raportimit u përditësuan për të përfshirë dhënien e autorizimit nga i licensuari:
>
> a) për institucionet publike që mbledhin të ardhurat për të raportuar pagesat e marra të cilat klasifilohen si informacion konfidencial sipas ligjeve, rregulloreve dhe marrëveshjve në fuqi;
> b) për lejimin e publikimit të këtyre pagesave në sipas natyrës dhe të detajuara për çdo shoqëri / licensë në raportin EITI.

Megjithatë, për shkak të vonesave në procesin e raportimit nga të licensuarit dhe institucionet publike (paraqitur në kapitullin 4), kjo procedure nuk rezultoi efektive për qëllime të këtij raportimi, sepse deri në datën e këtij raporti ne arritëm të mblidhnim autorizim të firmosur nga më pak se 10 nga 148 të licensuar në të dy vitet.

Rekomandime

Në mënyrë që të forcojë kuadrin rregullator për raportimin e pagesave dhe për të kapërcyer pengesat e listuara më sipër, rekomandojmë që MSG të hartojë një rregullore plotësuese që adreson të gjitha aspektet si:

- Analiza paraprake për përcaktimin e materialitetit dhe pagesat e përfshira në raportimin;
- Koha dhe forma e raportimit nga të liçensuarit
- Koha dhe forma e raportimit nga ana e institucioneve publike që mbledhin pagesat
- Koha dhe forma e raportimit të informacionit kontekstual
- Niveli i procedurave për auditimin e çdo raportimi
- Format për zgjidhur aspektet e konfidencialitetit etj.

Rregullorja duhet të përcaktojë afatet për një porçes efektiv dhe të lejojë kohë të mjaftueshme që çdo shoqëri dhe institucion publik raportues të planifikojë dhe t'i përgjigjet kërkesave për raportimin EITI në afat.

Formularët e raportimit dhe instruksionet përkatëse duhet të përditësohen për ndryshime në qëllimin e punës dhe kërkesat për raportim, ndryshime në rregullore, si dhe fakte të reja që ndikojnë industrinë nxjerrëse (p.sh. taksa dhe përfitime të reja të zbatuara, investime të reja në industry etj.)

[76] Ligji Nr. 9920, datë 19 maj 2008 "Mbi proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar" dhe Ligji Nr. 8449, datë 27 janar 1999 "Për Kodin Doganor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".

Përzgjedhja e subjekteve raportuese duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara fillimit të punës për rakordimin e pagesave. Ne sugjerojmë, të kërkohet nga të gjithë të licensuarit (kur kjo është e mundur) të dorëzojnë raportimin në rrugë elektronike nëpërmjet faqes së internetit ose emailit. Puna rakorduese mund të kryhet për një përzgjedhje kryer sipas qëllimit të raportimit EITI dhe duke reflektuar ndryshimet në sektor.

Formularët e miratuar nga MSG mund të publikohen në faqen e internetit të ALBEITI-t, nga ku të licensuarit të kenë mundësi t'i shkarkojnë, t'i plotësojnë dhe t'i ngarkojnë përsëri nëpërmjet një portal-i të dedikuar, nëse sistemtet e EITI Shqipëri e mundësojnë këtë proces. Formularët përfundimtarë e të firmosur mund të dërgohen në vijim me email ose të ngarkohen në të njëjtin portal.

Raportimet e marra nga të licensuarit dhe jo të përzgjedhura për rakordim mund të paraqiten si deklarime të njëanshme në raport dhe të gjithë raportimet bashku të krahasohen me të statistika për prodhimin dhe arkëtimet totale të raportuar nga institucionet qeveritare etj..

Përcaktimi i afateve për dorëzimin e deklaratave dhe procesin e rakordimit

Afati për dorëzimin e raportimit duhet të planifikohet në kohë dhe të përfshihet në skedulin e raportimeve të të licensuarve. Si rrjedhojë, koha e nevojshme për mbledhjen e raportimit nga bizneset pritet të ulet dhe gjithashtu priten përmirësime në saktësinë e raportimit. Shoqëritë raportuese dhe institucionet qeveritare duhet të raportojnë në të njëjtin afat.

Fillimi i muajit maj të vitit pasues kalendarik mund të përcaktohet si afati i fundit për dorëzimin e formularëve të plotësuar dhe puna rakorduese të kryhet gjatë muajit maj dhe qershor.

Fjalor dhe shkurtime

ALBEITI	Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri, themeluar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Administrator	Shoqëri e pavarur e punësuar për të bërë rakordimin e pagesave të raportuara dhe të ardhurave nga të liçensuarit dhe qeveria
ADSH	Administrata Doganore Shqiptare
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncensioneve është një njësi e themeluar në kuadër të Ministrisë për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregetisë dhe Sipërmarrjes.
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EITI	Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrësë
EITI Albania	Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri, themeluar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri
EUR	Euro
FPP	Furnizuesit Publike me Pakicë
FPSH	Furnizuesi publik me shumicë
Grupim	Pagesat janë kombinuar në mënyrë që shifrat tregojnë totalin për qarkullimin e të ardhurave
GWh	Gigawat për orë e përdorur për matjen e sasive të mëdha të fuqisë, ku 1 GWh = 1,000 MWh.
HEC	Hidrocentrale
I Licensuar	Leje e dhënë nga MEI për të kryer aktivitetin e kërkimit dhe/ ose të prodhimit në territorin shqiptar
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPE	Impiante të Pavarur të Energjisë
IVE	Impiant i vogël energjie
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KESH Gen	KESH Gen është një strukturë brenda KESH i liçensuar për të prodhuar energji
Kocesionari	Shoqëri e dhenë me koncension
KTOE	Ekuivalenti i kilogram tonë nafte (toe) i perdorur për të matur njësinë e energjisë e përcaktuar si shuma e energjisë e lëshuar nga djegia e një tonë naftë bruto.
Kundërparti	Në raport Shteti është kundërparti e të licensuarit dhe i licensuari është kundërparti e Shtetit
KV	Kilovolt
KW	Kilowatt është përdorur si njësi për energjinë elektrike
KWh	Kilowatt për orë e përdorur për matjen e energjisë
Licensë	Liçensë e dhënë nga MEI për aktivitetin e kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit në territorin shqiptar
M^2	Meter katror
M^3	Metër kub
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MLEK	Milion Lek
MM	Ministria e Mjedisit
MSG	Grupi Ndërinstitucional i Punës
MW	Megawatt i përdorur si njësi i energjisë elektrike, ku 1 MW = 1,000 KW
MWh	Megawatt për orë i përdorur për të matur sasi të mëdha të energjisë, ku 1 MWh = 1,000 KWh.
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregetisë dhe Sipërmarrjes
Ndarja	Pagesat janë detajuar për llojit të të ardhurave dhe/ose për liçensë
NJQV	Njësi(të) e qeverisjes vendore
OSHEE	Operator i Sistemit të Shpërndarjes Energjisë Elektrike i cili zoterohet 100% nga Qeveria Shqiptare.
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit i cili zotërohet 100% nga Qeveria Shqiptare.
Petroleum	Term i përgjithshëm i cili nënkupton naftën dhe gazin
PPP	Partneritet Publik-Privat
Qeveria	Përdorur në këtë raport si një term i përgjithshëm i cili përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Administratën Doganore Shqiptare, Agjensinë Kombetare të Burimeve Natyrore Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, Njësite e Qeverisjes Vendore, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Albpetrol, kur nuk paraqiten veçmas.
Rakordim	Procesi i krahasimit të të dhënave të raportuara nga të Licensuarit dhe Qeveria, dhe shpjegimit të mospërputhjeve
SNRF	Standarded Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilisteve (IFAC).
TEC	Termocentral
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
USD	Dollar amerikan
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave

NJQV	Njësi(të) e qeverisjes vendore
OSHEE	Operator i Sistemit të Shpërndarjes Energjisë Elektrike i cili zoterohet 100% nga Qeveria Shqiptare.
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit i cili zotërohet 100% nga Qeveria Shqiptare.
Petroleum	Term i përgjithshëm i cili nënkupton naftën dhe gazin
PPP	Partneritet Publik-Privat
Qeveria	Përdorur në këtë raport si një term i përgjithshëm i cili përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Administraten Doganore Shqiptare, Agjensinë Kombetare të Burimeve Natyrore Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, Njësite e Qeverisjes Vendore, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Albpetrol, kur nuk paraqiten veçmas.
Rakordim	Proçesi i krahasimit të të dhënave të raportuara nga të Liçensuarit dhe Qeveria, dhe shpjegimit të mospërputhjeve
SNRF	Standarted Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilisteve (IFAC).
TEC	Termoçentral
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
USD	Dollar amerikan
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave

Shtojca 1.1 – Rakordimi i detajuar për sektorin e naftës dhe gazit në vitin 2013

Tabela 38 – Pagesat për çdo shoqëri

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Bankers Petroleum Albania Ltd.	10,459,985	9,092,037	-	1,403,702	35,754	-
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	1,179,109	1,215,391	(3,051)	(39,333)	-	-
Sherwood International Petroleum Ltd.	-	-	-	-	-	-
Transoil Group - Dega ne Shqipëri	567,613	403,110	-	164,590	720	(634)
Phoenix Petroleum	39,233	19,495	-	12,111	(2,442)	(5,185)
Petromanas Albania GmbH	310,236	45,579	(250,104)	18,454	3,901	-
San Leon Durresi B.V.	-	6,561	3,878	(2,683)	-	-
Total	**12,556,177**	**10,782,174**	**(249,277)**	**1,556,841**	**37,934**	**(5,819)**

Tabela 39 –Pagesat në naftë - ndarja e prodhimit të naftës

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit		Shuma sipas Arkëtuesit		Mospërputhja e zgjidhur Paguesi		Mospërputhja e zgjidhur Arkëtuesi		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
	ne ton	*in Lek '000*	*ne ton*	*in Lek '000*	*ne ton*	*in Lek '000*	*in ton*	*in Lek '000*	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	49,157	2,288,315	49,157	2,288,315	-	-	-	-	-	-	-
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	17,592	818,904	17,592	818,904	-	-	-	-	-	-	-
Sherwood International Petroleum Ltd.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transoil Group - Dega ne Shqipëri	8,660	403,151	8,660	403,110	-	-	-	-	(42)	-	-
Phoenix Petroleum	425	19,799	417	19,411	-	-	-	-	(388)	-	-
Petromanas Albania GmbH	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
San Leon Durresi B.V.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Total	**75,834**	**3,530,170**	**75,825**	**3,529,741**	**-**	**-**	**-**	**-**	**(429)**	**-**	**-**

Pjesa nga ndarja e prodhimit të naftës u pagua plotësisht në natyrë në sasinë e 75,825 ton në vitin 2013. Vlerat e paraqitura më sipër janë përftuar duke zbatuar çmimet mesatare të shitjes së Albpetrol në vitin 2013 prej 441 USD / ton. Shumat në USD u përkthyen në Lek me normën mesatare të këmbimit të USD në Lek sipas Bankës së Shqipërisë në vitin 2013, ku 1 USD ishte i barabartë me 105.7 Lek.

Tabela 40 - Renta nga shitjet e brendshme

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas Paguesi	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	14,393	14,393	-	-	-	-	
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	33,205	33,205	-	-	-	-	
Transoil Group Ltd	29,569	-	-	29,569	-	-	Shuma u raportua më vonë nga Tatimet
Phoenix Petroleum	3,553	-	-	1,500	(2,053)	-	Vetëm Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë raportoi rentë, Drejtoria e Fierit nuk raportoi rentë të arkëtuar në ndryshim nga subjekti.
Total	**80,720**	**47,598**	**-**	**31,069**	**(2,053)**	**-**	

Tabela 41 - Renta në eksport

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas Paguesi	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	6,482,290	6,482,290	-	-	-	-	
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	327,000	323,949	(3,051)	-	-	-	Të licensuarit raportuan parapagimet në llogari të Doganës
Transoil Group Ltd	29,569	-	-	29,569			
Total	**6,838,859**	**6,806,239**	**(3,051)**	**29,569**	**1**	**-**	

Tabela 42 - Penalitetet tatimore

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas Paguesi	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	-	71,919	-	(71,919)	-	-	Tatimet raportuan penalitete jo pjesë e rakordimit
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	-	39,333	-	(39,333)	-	-	Tatimet raportuan penalitete jo pjesë e rakordimit
Transoil Group Ltd	634	-	-	-		(634)	Tatimet nuk raportuan asnjë pagesë
Phoenix Petroleum	-	84	-	(84)		-	Tatimet raportuan penalitete jo pjesë e rakordimit
Petromanas Albania GmbH	43,256	-	(43,256)	-		-	Tatimet raportuan penalitete jo pjesë e rakordimit
Total	**43,890**	**111,336**	**(43,256)**	**(111,336)**	**-**	**(634)**	

Tabela 43 - Bonuset e nëshkrimit dhe trajnimit

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas Paguesi	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Arketuar nga Albpetrol							
Phoenix Petroleum	10,695	-	-	10,695	-	-	
Bonuset e nëshkrimit dhe trajnimit - Albpetrol	**10,695**	**-**	**-**	**10,695**	**-**	**(634)**	
Arketuar nga AKBN							
Petromanas Albania G.m.b.H	45,579	45,579	-	-	-	-	
San Leon Energy Plc.	-	4,039	3,878	(161)			Subjekti e konfirmoi shumën me dokumenta mbështetëse
Bonuset e nëshkrimit dhe trajnimit - AKBN	**45,579**	**49,618**	**3,878**	**(161)**	**-**	**(634)**	

Tabela 44 – TVSH

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Transoil Group Ltd	17,341	-	-	17,842	501	-	Shuma u raportua më vonë nga Tatimet
Phoenix Petroleum	5,185	-	-	-	-	(5,185)	Tatimet nuk raportuan asnjë pagesë
Total	**22,526**	**-**	**-**	**17,842**	**501**	**(5,819)**	

Tabela 45 – Pagesa të tjera ndaj Shtetit

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	1,540,209	142,111	-	1,433,853	35,755	-	
Transoil Group - Dega ne Shqipëri	87,350	-	-	87,611	261	-	
Petromanas Albania GmbH	14,553	-	-	18,454	3,901	-	
San Leon Durresi B.V.	-	2,522	-	(2,522)	-	-	
Total	**1,642,112**	**144,633**	**-**	**1,537,396**	**39,917**	**-**	

Tabela 46 – Pagesa të tjera ndaj Pushtetit Vendor

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	134,778	93,010	-	41,768	-	-	Diferenca vjen nga mosraportimi i Komunës Zharrë. Subjekti e mbështeti shumën me dokumentat e pagesës.
Petromanas Albania GmbH	206,847	-	(206,847)	-	-	-	Shumat e raportuara jo pjesë e rakordimit.
Total	**341,625**	**93,010**	**(206,847)**	**41,768**	**39,917**	**-**	

Shtojca 1.2 – Rakordimi i detajuar për sektorin e naftës dhe gazit në vitin 2014

Tabela 47 - Pagesat për çdo shoqëri

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit	Shuma sipas Arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Bankers Petroleum Albania Ltd.	12,573,703	4,690,348	(40,498)	7,865,393	22,536	-
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	800,728	671,320	(38,957)	117,322	26,871	-
Sherwood International Petroleum Ltd.	16,786	7,476	-	9,311	-	-
Transoil Group - Dega ne Shqipëri	306,706	203,831	-	81,268	(40)	(21,567)
Phoenix Petroleum	127,987	113,726	(1,000)	6,735	(5,359)	(1,167)
Petromanas Albania GmbH	647,016	14,089	(65)	632,878	16	-
San Leon Durresi B.V.	3,116	3,115	-	-	(1)	-
Total	**14,476,042**	**5,703,905**	**(80,520)**	**8,712,907**	**44,023**	**(22,734)**

Tabela 48 -Pagesat në naftë - ndarja e prodhimit të naftës

Shumat në mijë Lek

Të Licensuarit	Shuma sipas paguesit		Shuma sipas Arkëtuesit		Mospërputhja e zgjidhur Paguesi		Mospërputhja e zgjidhur Arkëtuesi		Mospërputhja e pazgjidhur		Komente
	ne ton	*in Lek '000*	*ne ton*	*in Lek '000*	*ne ton*	*in Lek '000*	*in ton*	*in Lek '000*	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti	
Bankers Petroleum Albania Ltd.	71,085	2,971,047	71,265	2,978,572	-	-	-	-	7,525	-	Përafrimi nga konvertimi i barelave në ton
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas Ltd.	15,262	637,888	15,263	637,907	-	-	-	-	19	-	
Sherwood International Petroleum Ltd.	179	7,476	179	7,476	-	-	-	-	-	-	
Transoil Group - Dega ne Shqipëri	4,877	203,831	4,877	203,831	-	-	-	-	-	-	
Phoenix Petroleum	2,723	113,830	2,721	113,726	-	-	-	-	(104)	-	
Petromanas Albania GmbH	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
San Leon Durresi B.V.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Total	**94,126**	**3,934,072**	**94,304**	**3,941,512**	**-**	**-**	**-**	**-**	**7,440**	**-**	

